



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PERGJITHSHME

## RAPORT I VEPRIMTARISË SË ASHK

VITI 2025



## AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS

### HYRJE

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) organizohet dhe funksionon si institucion publik me vetëfinancim, në varësi të Kryeministrit. Struktura organizative dhe organika e ASHK-së, në nivel qendror dhe vendor, janë miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 110, datë 16.07.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 147, datë 01.08.2024. Në përputhje me këtë strukturë organizative, ASHK-ja ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme, 20 Drejtorive Vendore dhe 3 Zyrave Vendore.

ASHK-ja është institucioni përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të pasurive të paluajtshme, ofrimin e shërbimeve kadastrale, si dhe koordinimin dhe përmylljen e proceseve kalimtare të pronësisë. Veprimtaria e saj mbështetet në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, i cili përcakton kuadrin ligjor për organizimin dhe funksionimin e regjimit kadastral shtetëror, regjistrimin e pasurive të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të drejtave reale mbi to, si dhe përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të regjistrit të pasurive të paluajtshme.

Gjithashtu, procedurat që lidhen me përfundimin e proceseve kalimtare administrative dhe ligjore të pronësisë, regjistrimin e titujve të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore dhe private, si edhe proceset e inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre, zbatohen në mbështetje të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është fokusuar në përmbushjen e objektivave strategjike dhe prioritetive institucionale, me synim rritjen e eficiencës administrative, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe avancimin e proceseve të modernizimit e digjitalizimit të sistemit kadastral. Në këtë kuadër, aktiviteti i institucionit është orientuar kryesisht në këto drejtime:

- Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve kadastrale, garantimin e ofrimit të tyre brenda afateve ligjore dhe rritjen e standardeve të transparencës, aksesueshmërisë dhe eficiencës në marrëdhëniet me qytetarët dhe subjektet përfituese;
- Vijimin e proceseve të legalizimit të ndërtimeve informale dhe trajtimin e çështjeve të pronësisë, në funksion të konsolidimit të të drejtave pronësore dhe përmylljes graduale të proceseve kalimtare të pronësisë;
- Intensifikimin e proceseve të modernizimit dhe digjitalizimit të sistemit kadastral, nëpërmjet përfundimit të skanimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, avancimit të procesit të digjitalizimit të kartelave të pasurive të paluajtshme dhe hartave kadastrale, përmirësimin të cilësisë së të dhënave të regjistrit kadastral, si dhe përmylljes së regjistrimit fillestar në zonat ende të papërfunduara;

- Hartimin dhe koordinimin e projektakteve në funksion të kalimit të së drejtës së pronësisë për parcelat ndërtimore, si dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me kompensimin e pronave, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Menaxhimin, përmirësimin dhe garantimin e sigurisë së sistemeve teknologjike dhe infrastrukturës elektronike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së shërbimeve digjitale;
- Përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe proceset kalimtare të pronësisë, në funksion të harmonizimit dhe unifikimit të praktikave administrative;
- Menaxhimin eficient të burimeve financiare dhe administrative, si dhe optimizimin e shpërndarjes së të ardhurave dhe kapaciteteve institucionale;
- Fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të institucionit, nëpërmjet plotësimit të nevojave për staf, shpërndarjes më efektive të burimeve njerëzore sipas ngarkesës funksionale, si dhe përmirësimit të kushteve të punës përmes rikonstruksionit të ambienteve të drejtorive dhe zyrave vendore, pajisjes së tyre me infrastrukturë bashkëkohore teknologjike dhe logjistike;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore, me fokus identifikimin e pasurive të paluajtshme shtetërore dhe përgatitjen e projektakteve për kalimin e tyre në përgjegjësi administrimi apo pronësi, sipas kuadrit ligjor përkatës;
- Ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të ASHK-së, nëpërmjet organizimit të programeve trajnuese dhe aktiviteteve të zhvillimit profesional;
- Përmirësimin e kuadrit rregullator dhe strategjik të institucionit, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike që lidhen me komunikimin institucional, integritetin, menaxhimin e riskut dhe udhërrëfyesin e proceseve të digjitalizimit, në kuadër të mbështetjes së Bashkimit Evropian dhe objektivave për rritjen e transparencës, integritetit dhe modernizimit institucional;
- Organizimin e tryezave të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet publike, organizatat partnere dhe aktorë të tjerë relevantë, me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e dialogut të hapur ndërinstitucional.

## **PASQYRA**

### **I. TË DHËNAT STATISTIKORE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE KADSTRALE DHE PROCESEVE KALIMTARE**

Metodologjia dhe burimet e të dhënave

Indikatorët

Statistika lidhur me shërbimet kadastrale dhe proceset kalimtare

### **II. MONITORIMI I TITUJVE TË PRONËSISË -PROCESET KALIMTARE**

Analizë sipas fushës së veprimtarisë dhe kompetencave

Problematika të konstatuara

### **III. MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN**

Objektivat kryesore

Aktivitet kryesore dhe rezultat e arritura

Rekomandime për vijimësinë

### **IV. AUDITIMI I BRENDSHËM**

Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Rekomandimet e propozuara

### **V. MONITORIMI I REGJISTRIMIT FILLESTAR DHE PROCESIT TË KOMPENSIMIT**

Evidenca e ecurisë së procesit të regjistrimit fillestar

Evidenca e ecurisë së procesit të hartimit të drafteve të VKM të kompensimit të pronarëve

Ecuria e procesit të analizës dhe vlerësimit të pasurive

### **VI. HARTIMI I LEGJISLACIONIT, KONTROLLI TEKNIKO-LIGJOR, ANTIKORRUPSIONI DHE ÇËSHTJET GJYQËSORE**

Aktet nëligjore dhe aktet e brendshme të miratuara dhe marrëveshjet e bashkëpunimit

Evidenca e monitorimit të veprimtarisë së DVASHK përmes kontrolleve sporadike dhe periodike

Evidencë e trajtimit të kërkesë ankesave

Evidencë e çështjeve gjyqësore

### **VII. BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR**

Të ardhurat

Shpenzimet

## **VIII. APELIMI DHE BASHKËQEVERISJA**

Evidencë nga sistemi i menaxhimit të ankesave nga Bashkëqeverisja

Analizë e tematikave të kërkesë/ankesave dhe evidencë e trajtimit të ankesave nga Apelimi

Problematika e konstatuara dhe rekomandime

## **IX. SHËRBIMET, INVESTIMET DHE BURIMET NJERËZORE**

Evidenca e procedurave të prokurimit

Evidenca e trajtimit të nevojave të institucionit në drejtim të infrastrukturës për përmirësimin e ambjenteve të ushtrimit të veprimtarisë (godinave) të disa drejtorive/zyrave

Evidenca e burimeve njerëzore

## **X. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I SISTEMEVE**

Analizë mbi procesin e krijimit dhe administrimit të përdoruesve, menaxhimi i komunikimeve dhe ndërveprimeve ndërinstitutionale, menaxhimi i riskut në sistem dhe suporti teknik

Objektiva për vitin 2025

## **XI. EVIDENCA E PROCESIT TË INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË PRONAVE SHTETËRORE**

Evidenca në lidhje me procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave shtetërore për institucionet qendrore dhe njësite e vetëqeverisjes vendore

## **XII. AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE DHE PLANI I RRYTJES PËR SHQIPËRINË**

Udhërrëfyesi për proceset e Digjitalizimit

Plani i Integritetit dhe plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Digjitalizimi i kartelave të pasurive të paluajtshme

Procesi i regjistrimit fillestar

Projekti i BE për të drejtën e pronësisë

## **1. TË DHËNA STATISTIKORE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE KADASTRALE DHE PROCESEVE KALIMTARE**

Veprimtaria e Drejtorisë së Projekteve dhe Statistikave mbështetet në grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga:

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve.
- Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së.
- Sistemi elektronik ALBSCAD, Skeda Digjitale dhe Moduli i Vendimeve të Legalizimit.

Të dhënat e mbledhura përpunohen në baza mujore dhe periodike, me qëllim hartimin e raporteve statistikore dhe analitike, të cilat shërbejnë si instrument për monitorimin, matjen dhe vlerësimin e performancës institucionale në ofrimin e shërbimeve kadastrale dhe realizimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

### **1. Metodologjia dhe Burimet e të Dhënave**

Analiza bazohet në të dhëna statistikore të gjeneruara nga:

- Sistemi elektronik ALBSCAD.
- Skeda Digjitale e aplikimeve.
- Raportimet mujore të Drejtorive/Zyrave vendore.
- Moduli elektronik i vendimeve të legalizimit.

Periudha e marrë në analizë përfshin vitet 2020–2025, ku viti 2020 është konsideruar si vit referues, për shkak të implementimit të ofrimit online të shërbimeve kadastrale nëpërmjet portalit e-Albania.

## **2. Analiza e treguesit**

### **2.1 Aplikimet për shërbimet kadastrale**

#### **Përshkrimi i indikatorit**

Vlerësimi i realizimit të treguesit të performancës për indikatorin “Shërbimet e Kadastrës” bazohet në të dhënat statistikore të gjeneruara nga databaza e aplikimeve në sistemin elektronik ALBSCAD të ASHK-së. Këto të dhëna administrohen, mirëmbahen dhe përpunohen nga struktura përgjegjëse për administrimin e sistemeve dhe menaxhimin e riskut, e cila garanton saktësinë, integritetin dhe vazhdimësinë e raportimit statistikor.

Si vit fillestar i analizës është konsideruar viti 2020, i cili përkon me implementimin e plotë të ofrimit online të aplikimeve për shërbimet kadastrale nëpërmjet portalit e-Albania.

## Vlera analitike


Indikatori në fjalë mat volumin total të aplikimeve të kryera nga qytetarët dhe subjektet përfituese për shërbimet kadastrale, duke shërbyer si një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së institucionit në ofrimin e shërbimeve.

Analiza dhe raportimi i këtij treguesi për periudhën 2020–2025 mundësojnë evidentimin e tendencave, dinamikës së kërkesave dhe ecurisë së ofrimit të shërbimeve kadastrale ndër vite, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për vlerësimin e eficiencës administrative dhe planifikimin e masave për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve.

Tabela Nr. 1

Viti	Nr. total aplikime
2020	295,146
2021	433,615
2022	475,260
2023	483,867
2024	449,702
2025	541,136

Grafiku Nr.1



## 2.2 Koha mesatare e dhënies së shërbimit.

### Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues mat kohën mesatare, në ditë kalendarike, të nevojshme për përfundimin e një shërbimi të ofruar nga sportelet e shërbimeve kadastrale. Koha e përpunimit llogaritet si diferenca ndërmjet

datës së aplikimit të paraqitur nga qytetari dhe datës së përfundimit të shërbimit, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës përkatëse.

Në përlogaritjen e këtij treguesi përfshihen të gjitha aplikimet e regjistruara gjatë vitit raportues, si aplikimet e përfunduara, ashtu edhe ato që rezultojnë ende në proces trajtimi brenda periudhës së analizuar. Për aplikimet që nuk kanë marrë përgjigje deri në fund të vitit kalendarik, si datë përfundimtare për efekt të analizës konsiderohet data 31 dhjetor e vitit përkatës.


## Vlera analitike

Ky indikator shërben si një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e eficiencës administrative dhe performancës së institucionit në ofrimin e shërbimeve kadastrale. Analiza e tij mundëson evidentimin e kohës mesatare të trajtimit të kërkesave, identifikimin e vonesave apo problematikave në proceset operacionale, si dhe orientimin e masave për përmirësimin e cilësisë dhe shpejtësisë së ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Tabela Nr. 2

Koha mesatare e dhënies së shërbimit						
Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Ditë kalendarike	24	23	21	14	22	13

Grafiku Nr. 2



## 2.3 Aplikimet me përgjigje.

### Përshkrimi i indiaktorit

Ky indikator mat numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale për të cilat Drejtoritë Vendore të ASHK-së kanë dhënë përgjigje brenda vitit kalendarik përkatës. Në këtë kategori përfshihen të gjitha aplikimet e përmbyllura me një vendimmarrje administrative, pavarësisht llojit të shërbimit të kërkuar apo kohës së nevojshme për trajtimin e tyre.

Në përlogaritjen e këtij treguesi nuk përfshihen aplikimet që rezultojnë ende në proces shqyrtimi

dhe që nuk janë përmbyllur deri në fund të vitit referues.

### Vlera analitike


Ky tregues shërben për vlerësimin e eficiencës operacionale të sistemit të ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe të kapaciteteve administrative të institucionit për trajtimin dhe përmbylljen e kërkesave të qytetarëve. Analiza e këtij treguesi është i rëndësishëm për:

- Vlerësimin e nivelit të përpunimit të aplikimeve në raport me volumin e kërkesave të paraqitura;
- Matjen e kapacitetit institucional për dhënien e përgjigjeve administrative në kohë;
- Identifikimin e problematikave, mbingarkesave apo vonesave në procesin e trajtimit të aplikimeve;
- Monitorimin e performancës së Drejtorive Vendore në përmbushjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve.


Tabela Nr. 3

Viti	Me përgjigje	Aplikime me përgjigje në %
2020	291,587	98.8%
2021	428,852	98.9%
2022	473,303	99.59%
2023	480,410	99.23%
2024	437,365	97.26%
2025	535,979	99.04%

Grafiku Nr.3



**Grafiku Nr. 4**



## **2.4 Aplikime pa përgjigje.**

### **Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues pasqyron numrin e aplikimeve të paraqitura nga qytetarët për shërbime kadastrale, të cilat nuk janë përmbyllur me dhënien e një përgjigjeje administrative apo ofrimin e shërbimit përkatës brenda vitit kalendarik referues. Indikatori paraqitet si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje ndaj numrit total të aplikimeve të regjistruara gjatë së njëjtës periudhë raportuese.

Në këtë kategori përfshihen të gjitha aplikimet që rezultojnë ende në proces shqyrtimi ose trajtimi deri në përfundim të vitit kalendarik.


### **Vlera analitike**

Ky tregues përbën një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e eficiencës administrative dhe të kapaciteteve institucionale në përmbushjen në kohë të kërkesave të qytetarëve. Analiza e tij mundëson evidentimin e nivelit të aplikimeve të papërfunduara, identifikimin e vonesave dhe problematikave në proceset operationale, si dhe orientimin e masave për përmirësimin e menaxhimit të fluksit të aplikimeve dhe rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve kadastrale.


**Tabela Nr. 4**

Viti	Aplikime pa përgjigje	Aplikime pa përgjigje në %
2020	3,559	1.2%
2021	4,763	1.1%
2022	1,957	0.4%
2023	3,457	0.8%
2024	12,337	2.7%
2025	5,157	1.0%

Grafiku Nr. 5



Grafiku Nr.6



## 2.5 Aplikimet nëpërmjet portalit qeveritar E-Albania.

### Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues mat dhe analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera nga qytetarët nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania. Indikatori pasqyron nivelin e përdorimit të platformave digjitale në aksesimin e shërbimeve publike dhe shërben si një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e progresit të procesit të shërbimeve të ofruara nga ASHK.

Nëpërmjet këtij treguesi monitorohet ecuria e kalimit të shërbimeve nga format tradicionale në ofrimin elektronik, si dhe niveli i ndërveprimit të qytetarëve me sistemet digjitale të institucionit.


### Vlera analitike

Ky indikator mundëson vlerësimin e shkallës së përdorimit të shërbimeve online, si dhe analizimin e tendencave të sjelljes së përdoruesve në raport me aksesimin elektronik të shërbimeve kadastrale. Gjithashtu, ai shërben për identifikimin e nevojave për përmirësimin e funksionaliteteve të platformave digjitale, rritjen e aksesueshmërisë së shërbimeve dhe përmirësimin e përvojës së qytetarëve në marrjen e shërbimeve online.


Tabela Nr. 5

Viti	Aplikime e-Albania	Aplikime në e-Albania në %
2020	154,338	52.3%
2021	189,558	43.7%
2022	176,622	37.6%
2023	160,902	33.3%
2024	124,649	27.7%
2025	160,223	29.6%

Grafiku Nr.7



Grafiku Nr.8



## 2.6 Aplikime nëpërmjet sistemit të Dhomës Kombëtare të Noterisë NISA.

### Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues mat dhe analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të realizuara nëpërmjet sistemit elektronik NISA, platformë e përdorur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe zyrat noteriale në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet transmetimi elektronik, i sigurt dhe në kohë reale i aplikimeve dhe të dhënave kadastrale ndërmjet noterëve dhe ASHK-së.

Indikatori pasqyron nivelin e përdorimit të sistemeve të integruara elektronike në procesin e ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe shkallën e ndërveprimit institucional ndërmjet ASHK-së dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.


### Vlera analitike

Ky tregues shërben për vlerësimin e eficiencës së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe nivelit të integritetit të sistemeve elektronike në proceset administrative që lidhen me regjistrimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, ai kontribuon në evidentimin e ndikimit të digjitalizimit në rritjen e transparencës, garantimin e sigurisë juridike, reduktimin e kohës së procedurave administrative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe profesionistët e fushës ligjore.


Tabela Nr. 6

Viti	Aplikime nga sistemi NISA	Aplikime nga sistemi NISA në %
2021	236,310	54.5%
2022	296,012	62.3%
2023	320,742	66.3%
2024	320,551	71.3%
2025	375,806	69.4%

Grafiku Nr.9



Grafiku Nr.10



## 2.7 Aplikime nëpërmjet modulit “ASHK për Institucione”.

### Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera nëpërmjet modulit “ASHK për Institucione”, një platformë elektronike e dedikuar për përdorim nga institucionet publike në cilësinë e palëve të interesuara.

Moduli është implementuar në dhjetor 2020, me qëllim lehtësimin dhe formalizimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe institucioneve shtetërore, në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit, si dhe në funksion të mbështetjes së nevojave institucionale dhe operacionale të këtyre subjekteve.

### Vlera analitike

Ky sistem funksionon paralelisht me platformat standarde të shërbimeve kadastrale dhe ofron një sërë përfitimesh në drejtim të rritjes së eficiencës dhe cilësisë së shërbimit, duke përfshirë:


- Përsheptimin e aksesit të institucioneve publike në informacionin zyrtar kadastral;
- Thjeshtimin e procesit të ndërveprimit institucional, përmes mundësisë së kryerjes së aplikimeve dhe marrjes së përgjigjeve në mënyrë elektronike dhe të drejtpërdrejtë;
- Lehtësimin dhe automatizimin e procesit të faturimit, nëpërmjet gjenerimit automatik të dokumentacionit financiar për shërbimet e ofruara;
- Optimizimin e ngarkesës së sistemit qendror, duke diferencuar flukset institucionale nga ato të qytetarëve, çka kontribuon në përmirësimin e kohës së përgjigjes dhe rritjen e eficiencës së

përgjithshme të sistemit.


Tabela Nr. 7

Viti	Aplikime nga sistemi ASHK për Institucione	Aplikime nga sistemi ASHK për Institucione në %
2021	7,747	1.78%
2022	2,626	0.55%
2023	2,223	0.45%
2024	4,502	1%
2025	5,107	0.94%

Grafiku Nr.11



Grafiku Nr.12



### 3. Procedura Administrative e Legalizimit

#### 3.1 Legalizimi i Objekteteve Informale


## Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues mat numrin e objekteve të legalizuara nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së gjatë periudhës kohore 2020–2025.

Tabela Nr. 8

PERIUDHA	Leje/Vendime për legalizimin/moslegalizimin e objekteve pa leje sipas viteve
2006 - 2009	1,583
2010	1,821
2011	4,006
2012	5,769
2013	8,571
2014	15,294
2015	24,748
2016	48,351
2017	26,451
2018	30,151
2019	12,018
2020	20,991
2021	25,088
2022	18,872
2023	10,132
2024	11,167
2025	26,101

Grafiku Nr.13



Procesi i legalizimit të ndërtimeve informale përfaqëson një proces kompleks dhe afatgjatë, i kushtëzuar nga numri i lartë i aplikimeve të paraqitura nga qytetarët ndër vite, duke filluar që nga

viti 2005, si dhe nga natyra e ndërlikuar tekniko-ligjore e këtij procesi. Në këtë kontekst, legalizimi përbën gjithashtu një komponent thelbësor në përmbylljen e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, i cili, në përputhje me Ligjin nr. 20/2020, parashikohet të përfundojë brenda vitit 2028.

### **Vlera analitike**

Gjatë periudhës 2006–2025, Drejtoritë Vendore të ASHK-së kanë kryer verifikimin teknik dhe ligjor të aplikimeve për legalizim, duke përfunduar me:

- **291,114** vendime përfundimtare, dhe
- **6,082** aplikime të skualifikuara, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore.

Këto të dhëna janë objekt përditësimi dhe ndryshimi në vijimësi, për disa arsye kryesore:

- ✓ Ekziston ende një numër i konsiderueshëm objektësh informale që përmbushin kriteret ligjore për legalizim, por për të cilat nuk është paraqitur aplikim nga subjektet përkatëse;
- ✓ Në raste të ndryshme janë evidentuar aplikime të përsëritura për të njëjtin objekt, të paraqitura nga subjekte të ndryshme ose nga i njëjti subjekt në periudha të ndryshme, çka ka sjellë krijimin e dublimeve dhe rritje të ngarkesës administrative në procesin e trajtimit.

Në këtë kuptim, treguesi reflekton jo vetëm ecurinë e procesit të legalizimit, por edhe dinamikën reale të regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave mbi ndërtime informale në nivel vendi.

### **3.2 Përjashtimi nga legalizimi i ndërtimeve pa leje.**

#### **Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues mat numrin e vendimeve për përjashtim nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje. Ai pasqyron rastet në të cilat, pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe ligjor, konstatohet se objektet përkatëse nuk përmbushin kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për legalizim dhe, për rrjedhojë, nuk kualifikohen për t'u përfshirë në këtë proces.

### **Vlera analitike**


Ky tregues reflekton nivelin e përputhshmërisë së aplikimeve me kërkesat ligjore dhe standardet tekniko-administrative të procesit të legalizimit. Ai shërben si një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese, si dhe për matjen e shkallës së qartësisë dhe saktësisë së informimit publik mbi kriteret e përfshirjes në procesin e legalizimit.

Tabela Nr. 9

<b>Viti</b>	<b>Vendime Moslegalizimi</b>
<b>2020</b>	94
<b>2021</b>	159
<b>2022</b>	410

<b>2023</b>	187
<b>2024</b>	70
<b>2025</b>	610

Grafiku Nr.14



## EVIDENCË MBI ECURINË E PROCESIT TË LEGALIZIMEVE, PËR VITIN 2025


Tabela Nr. 10

NR.	VENDIME PËRFUNDIMTARE				VENDIME TË NDËRMJETME	
	DREJTORIA VENDORE	NR. I VENDIMEVE TË LEGALIZIMIT	NR. I VENDIMEVE TË MOSLEGALIZIMIT	NR. I URDHRAVE TË MOSPËRFSH IRJES NË PROCESIN E MOSLEGALIZIMIT	NR. I URDHRAVE TË PEZULLIMIT TË PROCESIT TË MOSLEGALIZIMIT - NENI 29	NR. I URDHRAVE TË PEZULLIMIT TË PROCESIT TË MOSLEGALIZIMIT - PROCESE GJYQËSORE ETJ...
1	BERAT	1033	42	0	68	0
2	DIBËR	226	0	318	99	335
3	DURRËS-KAVAJE-KRUJE	3022	2	10	0	0
4	ELBASAN	1821	23	3	0	0
5	FIER	1095	7	0	26	0


6	GJIROKASTËR	430	135	38	155	22
7	KAMËZ VORË	1722	0	1	131	30
9	KORÇË- KOLONJË- DEVOLL	654	116	147	0	237
12	KUKËS	307	77	207	190	109
13	LEZHË	874	0	0	0	0
14	LUSHNJE	1419	0	0	0	33
15	POGRADEC	641	151	0	0	594
16	SARANDË	642	4	46	2	60
17	SHKODËR	1740	16	2	1	1
19	TIRANA VERI	2367	26	23	197	0
20	TIRANA JUG	1610	2	171	110	0
21	TIRANA RURALE 1	1821	2	30	22	2
22	TIRANA RURALE 2	1823	4	43	39	0
23	VLORË	897	3	8	0	0
24	ZONAT E STIMULUARA	298	0	2	12	145
	<b>TOTAL</b>	<b>24442</b>	<b>610</b>	<b>1049</b>	<b>1052</b>	<b>1568</b>

Vendime Pozitive	Vendime Negative	Vendime te Ndermjetme
24442	1659	2620
<b>TOTAL(Vendime Perfundimtare)</b>		
<b>26101</b>		

Grafiku Nr. 15



Grafiku Nr. 16



Grafiku Nr. 17





Tabela Nr. 11

MUAJI	Vendimet e Legalizimit/Moslegalizimit Viti 2025 në muaj
JANAR	2097
SHKURT	1808
MARS	1811
PRILL	1839

<b>MAJ</b>	1699
<b>QERSHOR</b>	2020
<b>KORRIK</b>	1980
<b>GUSHT</b>	1862
<b>SHTATOR</b>	2388
<b>TETOR</b>	2513
<b>NENTOR</b>	3000
<b>DHJETOR</b>	3084
<b>TOTAL</b>	<b>26101</b>

Grafiku Nr. 18




Përsa i përket numrit progresiv të vendimeve për legazim/moslegalizim të objekteve pa leje është si më poshtë:

Tabela Nr. 12

<b>VITI</b>	<b>Nr. Progresiv i lejeve/vendimeve për legalizimin/moslegalizimin e objekteve pa leje sipas viteve</b>
<b>2006 - 2009</b>	1,583
<b>2010</b>	3,404
<b>2011</b>	7,410
<b>2012</b>	13,179
<b>2013</b>	21,750
<b>2014</b>	37,044
<b>2015</b>	61,792
<b>2016</b>	110,143
<b>2017</b>	136,594
<b>2018</b>	166,745
<b>2019</b>	178,763
<b>2020</b>	199,754
<b>2021</b>	224,842

2022	243,714
2023	253,846
2024	265,013
2025	291,114

Grafiku Nr. 19



### 3.3 Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.

#### Përshkrimi i indikatorit

Procesi i formalizimit të objekteve të ndërtuara para vitit 1991 ka për qëllim pajisjen me dokumente të rregullta pronësie të banesave dhe objekteve të banimit të ndërtuara para këtij viti, të cilat nuk figurojnë të regjistruara në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme. Ky proces përfshin ndërtesa të realizuara në periudha të ndryshme historike, të cilat kanë mbetur pa titull të formalizuar pronësie apo dokumentacion të plotë ligjor.

#### Kuadri ligjor dhe institucional

Ky proces është iniciuar në vitin 2012 dhe është zhvilluar në disa faza institucionale. Fillimisht, zbatimi i tij është kryer nga njësitë e qeverisjes vendore, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM)

nr. 608/2012, “Për përcaktimin e procedurës për formalizimin e objekteve të ndërtuara pa dokumente pronësie”. Më pas, me VKM nr. 442/2018, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të kompetencave për formalizimin e objekteve pa dokumente pronësie”, përgjegjësitë për zbatimin e këtij procesi iu transferuan ish-ALUIZNI-t.

Aktualisht, procesi i formalizimit realizohet nga ASHK, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të VKM nr. 827, datë 30.09.2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie, tokat funksionale dhe oborret në përdorim”.

### Vlera analitike

Ky proces synon garantimin e sigurisë juridike të pronësisë për një numër të konsiderueshëm objektivsh banimi të ndërtuara para vitit 1991, duke kontribuar në formalizimin e pronësisë, përmirësimin e cilësisë dhe saktësisë së regjistrave kadastralë, si dhe në forcimin e stabilitetit dhe transparencës së tregut të pasurive të paluajtshme.

### Tabela lidhur me treguesit “Vendimet e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore për objektet e ndërtuara para vitit 1991”

Tabela Nr. 13

<b>OBJEKTET E NDËRTUARA PËRPARA VITIT 1991 NË ZBATIM TË VKM NR. 827/2020 JANAR-DHJETOR 2025</b>	
<b>DREJTORITË</b>	<b>JANAR-DHJETOR</b>
BERAT	99
DIBËR	197
DURRËS-KAVAJË-KRUJË	79
ELBASAN	23
FIER	157
GJIROKASTËR	140
KAMËZ VORË	13
KORÇË	138
KUKËS	54
LEZHË	103
LUSHNJE	29
POGRADEC	75
SARANDË	107
SHKODËR	110
TIRANA VERI	59
TIRANA JUG	24
TIRANA RURALE 1	63
TIRANA RURALE 2	31
VLORË	245
<b>TOTALI</b>	<b>1,746</b>

Grafiku Nr. 20





Tabela Nr. 14

VITI	Nr. i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim
2019	249
2020	1,521
2021	2,211
2022	1,699
2023	1,098
2024	2,489
2025	1,746

Grafiku Nr. 21




Për vitin 2025 numri i vendimeve për miratimin edokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie të ndërtuara para datës 10.08.1991, trojet e tyre funksionale dhe oborret në përdorim është 1,746. Të dhënat sipas muajve janë sipas tabelës dhe grafikut të mëposhtme.

Tabela Nr. 15

<b>MUAJI</b>	<b>Nr. i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim</b>
JANAR	125
SHKURT	100
MARS	193
PRILL	234
MAJ	177
QERSHOR	129
KORRIK	120
GUSHT	116
SHTATOR	162
TETOR	140
NËNTOR	103
DHJETOR	147
<b>TOTALI</b>	<b>1,746</b>

Grafiku Nr. 22




Të dhënat progresive për periudhën 2019 - 2025 në lidhje me këtë proces janë si mëposhtë vijon:

**Tabela Nr. 16**

<b>VITI</b>	<b>Nr. progresiv i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim</b>
<b>2019</b>	249
<b>2020</b>	1,770
<b>2021</b>	3,981
<b>2022</b>	5,680
<b>2023</b>	6,778
<b>2024</b>	9,264
<b>2025</b>	11,010

**Grafiku Nr. 23**



## II. MONITORIMI I TITUJVE TË PRONËSISË -PROCESET KALIMTARE

### **Regjistrimi i Akteve të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.**

Procesi i regjistrimit të tokës bujqësore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, është kompetencë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila vepron si institucioni publik përgjegjës për administrimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni.

Problematikat e hasura gjatë procesit të regjistrimit të AMTP-ve evidentohen nga ASHK rast pas rasti, gjatë trajtimit të kërkesave për regjistrimin e tyre. Ky proces përfshin një shqyrtim të detajuar të kriterëve të ligjshmërisë së subjektit kërkues, si dhe të llojit të tokës për të siguruar se të dhënat dhe dokumentacioni që paraqiten janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi. Kryesisht, problematika më e shpeshtë e evidentuar gjatë procesit të regjistrimit të AMTP-ve nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, lidhet me mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit arkivor që i përket procesit të ndarjes së tokës bujqësore, i cili duhet të sigurohet nga institucionet përkatëse: DAMT, NJVV dhe Prefekti i Qarkut, në përputhje me nenin 68 të këtij ligji.


Administrimi i këtij dokumentacioni në formën e një kopjeje të njësuar me origjinalin është thelbësor për realizimin e regjistrimit të AMTP-ve, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe kriteret e përcaktuara në VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve dhe sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtesë shtetërore dhe pronat shërbyese”.

Ecuria e këtij procesi ndër vite paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela Nr. 17

VITI	Regjistrimi i Titujve mbi Tokën Bujqësore
2019	8,311
2020	18,576
2021	22,400
2022	18,296
2023	8,820
2024	1,627
2025	26,769
<b>TOTAL</b>	<b>104,799</b>

Grafiku nr. 24




### Kalimi i tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi pa shpërblim.

Tabela Nr. 18

VITI	Nr. i vendimeve për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi
2022	15
2023	6
2024	41
2025	245

Grafiku Nr. 28




**Numri i kërkesave të trajtuara për tokën bujqësore nga përdorimi në pronësi pa shpërblim.**

**Tabela Nr. 19**

Viti	Nr. i kërkesave të trajtuara
2023	4
2024	40
2025	2454

**Grafiku Nr. 29**



### III. MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

**MISIONI:** Drejtoria për Median dhe Marrëdhënien me Publikun ka si mision të garantojë një komunikim institucional transparent, të qëndrueshëm dhe me ndikim të lartë publik — duke ndërtuar ura besimi midis ASHK-së dhe qytetarëve, mediave dhe aktorëve institucionalë, nëpërmjet informacionit të saktë, të strukturuar dhe të aksesueshëm.

#### Objektivat Kryesore

Veprimtaria e Drejtorisë gjatë vitit 2025 u mbështet mbi tre objektiva strategjike:

- Fuqizimi i imazhit publik të institucionit nëpërmjet prezencës aktive në media dhe platforma digjitale;
- Ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të qëndrueshme me publikun e gjerë, mediat dhe aktorët institucional;
- Krijimi i urave të besimit me qytetarët përmes një komunikimi të qartë, të saktë dhe koherent, në funksion të shërbimit publik.

#### Aktivitetet Kryesore dhe Rezultatet e Arritura

##### 1. Hartimi dhe Miratimi i Strategjisë së Komunikimit

Një ndër arritjet më të rëndësishme të vitit 2025 është hartimi i Strategjisë së Komunikimit Institucional. Ky dokument themelor u hartua në bashkëpunim me Këshillin e Europës, në kuadër të projektit "Përmirësimi i Mbrojtjes së të Drejtës së Pronës dhe Lehtësimi i Ekzekutimeve të Vendimeve të GJEDNJ në Shqipëri".

Strategjia e Komunikimit përfaqëson një plan gjithëpërfshirës dhe afatmesëm për forcimin e komunikimit të ASHK-së, i artikuluar mbi tri shtylla kryesore:

- Standardizimi i përmbajtjes dhe tonit institucional të komunikimit;
- Fuqizimi i kanaleve digjitale dhe të rrjeteve sociale si mjete kryesore të informimit;
- Ndërtimi i një rrjeti të brendshëm komunikimi ndërinstytucional, me grupe të dedikuara pune.

Në bashkëpunim me Këshillin e Europës, dokumenti u prezantua për diskutim publik në një tryezë konsultimi me palë të interesuara, duke siguruar konsensus të gjerë institucional rreth vizionit dhe prioritetëve të komunikimit të ASHK-së.

## **2. Komunikimi Digjital dhe Rrjetet Sociale**

Gjatë vitit 2025, Drejtoria i kushtoi vëmendje të veçantë rritjes së transparencës institucionale nëpërmjet komunikimit digjital. Dy aksione kryesore shënuan ecurinë e kësaj fushe:

### **Faqja Zyrtare e Internetit**

Gjatë vitit është përditësuar faqja zyrtare [www.ashk.gov.al](http://www.ashk.gov.al), me theks të veçantë tek hapësira "Programi i Transparencës", në përputhje të plotë me udhëzimet e Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke garantuar akses të plotë dhe të vazhdueshëm të qytetarëve.

### **Rrjetet Sociale (Facebook & Instagram)**

Në profilet zyrtare të institucionit gjatë vitit 2025, janë realizuar dhe publikuar mbi 200 postime informuese, të strukturuar sipas fushave kryesore të veprimtarisë institucionale:

- Shërbimet kadastrale dhe procedurat e aplikimit;
- Vendimet e marra nga ASHK dhe kuadri ligjor e rregullator;
- Procesi i regjistrimit fillestar — informacion mbi procesin dhe ecurinë;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave për kompensimin e ish-pronarëve dhe përfituesve të parcelës ndërtimore;
- Promovimi i aktiviteteve institucionale dhe bashkëpunimeve strategjike;
- Të dhëna statistikore mbi tregues të rëndësishëm të veprimtarisë së Agjencisë.

## **3. Performanca e Përmbajtjes Digjitale**

Postimet në rrjetet sociale kanë pasur një impakt të qëndrueshëm dhe në rritje gjatë vitit 2025, duke dëshmuar interes të lartë të audiencës për informacionin zyrtar në fushën kadastrale. Të dhënat akumuluese të vitit tregojnë:

<b>3.4 M</b> Shikime totale në rrjetet sociale	<b>~50 mijë</b> Ndërveprime nga audiencia	<b>150+ mijë</b> Vizita në profilin zyrtar
---	--	---

Këto të dhëna tregojnë jo vetëm shtrirjen e gjerë të përmbajtjes institucionale, por edhe rëndësinë që qytetarët i kushtojnë informacionit të saktë dhe zyrtar në fushën e shërbimeve kadastrale — duke konfirmuar rolin e komunikimit digjital si shtyllë e transparencës publike të ASHK-së.

#### 4. Forcimi i Komunikimit me Publikun Nëpërmjet Kanaleve të Tjera

Me mbështetjen e Këshillit të Europës, gjatë vitit 2025 u organizuan trajnime periodike për stafin e grupit ad hoc të komunikimit — strukturë e dedikuar për trajtimin dhe menaxhimin e kërkesave për informacion nga qytetarët.

Ky grup siguron informim dhe ndërveprim aktiv me publikun nëpërmjet dy kanaleve kryesore:

- E-maili institucional i dedikuar: [pronaime@ashk.gov.al](mailto:pronaime@ashk.gov.al) — për kërkesa me shkrim dhe korrespondencë formale;
- Numri i gjelbër 0800 88 11 — linjë telefonike falas, e aksesueshme nga çdo qytetar i interesuar për shërbimet kadastrale.

Trajnimet kanë synuar ngritjen e kapaciteteve të stafit në komunikimin institucional, menaxhimin e ankesave dhe ofrimin e përgjigjes cilësore në kohë reale ndaj qytetarëve.

#### Rekomandime për Vijimësinë

Bazuar në analizën e veprimtarisë dhe sfidave të identifikuara gjatë vitit 2025, Drejtoria për Median dhe Marrëdhënien me Publikun rekomandon vijimin e investimeve në tre drejtime prioritare:

#	Rekomandimi
1	<b>Rikonceptimi i Faqes Zyrtare në Internet</b> Ridizajnimi i plotë i <a href="http://www.ashk.gov.al">www.ashk.gov.al</a> me fokus te aksesin e qytetarit, lehtësia e navigimit dhe pasurimi me informacion praktik mbi shërbimet — në funksion të një eksperience dixhitale moderne dhe gjithëpërfshirëse.
2	<b>Përmirësimi i Informacionit të shërbimeve kadastrale në Portalin e-Albania</b> Rishikimi dhe pasurimi i udhëzimeve dhe informacionit shoqërues në ndërfaqet e aplikimeve të shërbimeve që ASHK ofron nëpërmjet portalit kombëtar e-Albania, për

	të reduktuar barrierat dhe pyetjet e shpeshta të qytetarëve.
<b>3</b>	<b>Modernizimi i Numrit të Gjellbër 0800 88 11</b> Ngritja e një centrali telefonik të dedikuar që mundëson pritje në linjë, regjistrimin e telefonatave dhe analizën e kërkesave — me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe eksperiencës së qytetarëve.

Drejtorja për Median dhe Marrëdhënien me Publikun mbetet e angazhuar për të konsoliduar rolin e ASHK-së si institucion transparent, bashkëkohor dhe të orientuar drejt qytetarit — duke i shërbyer reformës kadastrale dhe integritimit europian të Shqipërisë me komunikim institucional cilësor dhe me ndikim të lartë publik.

#### **IV. AUDITIMI I BRENDSHËM**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në ASHK e mbështet veprimtarinë e saj në ligjin nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr.134 datë 17.10.2025 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, mbi bazën e të cilave ka realizuar Programin Vjetor të Auditimit, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1750 datë 11.10.2024 “Për miratimin e Programit Strategjik 2025-2027 dhe Programit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025”.

Në zbatim të Programit Vjetor për vitin 2025 janë realizuar angazhime të Auditimit të Brendshëm në 6 subjekte.

Në realizimin e Planit Vjetor 2025, risku është vlerësuar sipas fushave të sistemeve përkatëse dhe konkretisht:

- Risku nga mos tarifimi i saktë i shërbimeve të kryera;
- Risku që lidhet me pagesat on-line për shërbimet në ASHK;
- Risku i derdhjes së të ardhurave në të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë;
- Risku nga kryerja e shërbimeve pa arkëtimin e vlerave përkatëse;
- Risku i xhirimit të plotë të vlerës së mbledhur të të ardhurave të ASHK-së, nga Posta Shqiptare;
- Risku nga llogaritja e pasaktë e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pasurisë së paluajtshme;
- Risku nga mos evidentimi i saktë i aktiveve;
- Risku i sistemit të veprimeve si pasojë e derdhjeve në llogari të gabuara;
- Risku i pagesave të anuluar brenda ditës (shërbime, tatime, taksa etj), dhe I kalimit të tyre

- si pagesa të rregullta në sektorët e përpunimit të kërkesave;
- Riske të tjera të ngjashme.

Në subjektet e audituara, programet e auditimit u përqëndruan në sistemet e përputhshmërisë dhe të performances, të konsideruara si sisteme me risk të lartë.

Risku i personelit, pavarësisht masave të ndërmarra përmes trajnimeve të punonjësve të rinj në drejtim të aftësisë të tyre tekniko-profesional, vijon të mbetet aktiv në fusha të tilla si: tarifimi i shërbimeve, arkëtimet online, administrimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, rakordimi i të ardhurave, llogaritja dhe arkëtimi i tatimit, si dhe respektimi i afateve të ofrimit të shërbimeve.

### **Gjetjet kryesore sipas sistemeve.**

Për vitin 2025 nga auditimet e kryera në gjashtë subjekte, kanë rezultuar gjetje me dëm ekonomik në shumën **54222 mijë lekë**, nga të cilat:

○ Tatim mbi kalimin e të drejtës të pronësisë .....	<b>16156 mijë lekë.</b>
○ Tarifa, shërbime, penaltete .....	<b>26846 “ “</b>
○ Detyrimet për parcelën ndërtimore .....	<b>11220 mijë lekë.</b>

Gjetjet sipas fushave me sistemin e kombinuar rezultojnë si më poshtë:

- Shfuqizim i lejeve të legalizimit në dy subjekte;
- Në tre subjekte nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna;
- Zbatim jo korrekt i tarifave të shërbimeve në katër subjekte;
- Shkelje dhe mangësi në llogaritjen e tatimit në dy subjekte;
- Mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit në katër subjekte;
- U konstatuan shërbime të ofruara për institucione të pa-arkëtuara, në gjashtë subjekte;
- Parregullsi lidhur me dokumentacionin tekniko-ligjor të regjistruar në arkivë, në gjashtë subjekte;
- Tejkallim i afateve në ofrimin e shërbimit në gjashtë subjekte;
- Mungesa e inventarit të brendshëm në dosjet e referencave, në tre subjekte;
- Moskryerja e markimit me vulë numratore të referencave, në tre subjekte;
- Pasqyra e llogaritjes së tatimit nga kalimi i pronësisë nuk është pjesë e referencës së regjistrimit në çdo rast, në katër subjekte;
- Në kartelat e pasurive të paluajtshme, rivlerësimi i përdorur nuk fshihet në çdo rast, në dy subjekte;
- U evidentuan raste kur dalja e Vendimit të Legalizimit nuk shoqërohej me njoftimin e detyrimit për parcelën, në gjashtë subjekte;
- U konstatuan mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjet e përfunduara të

legalizimit, në gjashtë subjekte;

- Në gjashtë subjekte u konstatuan raste të shkeljes së afateve ligjore për emetimin e vendimeve të legalizimit;
- Urdhri i Titullarit për nxjerrjen nga arkiva dhe punimin e dosjes së legalizimit nuk ishte pjesë e dokumentacionit në çdo rast, për gjashtë subjekte;
- U evidentua se Posta Shqiptare nuk kryen në fund të çdo dite xhirimin e të ardhurave të ASHK-së, në llogarinë përkatëse në Bankën e Nivelit të Dytë, në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e përbashkët, në tre subjekte.

### **Rekomandimet e propozuara.**

- Në dy drejtori vendore u rekomandua shfuqizimi, në tre raste, i vendimeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me kërkesat ligjore;
- Në tre subjekte u rekomandua që Menaxhimit të analizojë dhe të përcaktojë përgjegjësitë konkrete për rekomandimet e pranuar, por të pa zbatuara, të lëna nga auditimi i mëparshëm, pasi risku i moszbatimit të tyre mbetet përgjegjësi e Menaxhimit;
- Në gjashtë subjekte të audituara u rekomandua analizimi i rezultateve të testeve mbi zbatimin e afateve të shërbimeve, duke përcaktuar kontrolle shtesë për përmirësimin e performances;
- Në katër subjekte u rekomandua që dokumentimi i procedurave të prokurimit të kryhet në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi;
- Në tre subjekte u rekomandua që dosjet e referencave në arkivë të pajisen me inventar, duke bërë të mundur dokumentimin rast pas rasti të mungesave, dublimeve etj;
- Në pesë subjekte u rekomandua që Libri i Referencave të prokurohet në formatin e miratuar, i lidhur për çdo zonë kadastrale, në zbatim të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumentacionit ligjor në ZVRPP”. Gjithashtu, librat ekzistues të arkivohen me procesverbal;
- Në gjashtë subjekte u rekomandua ndjekja e arkëtimit për shërbimet e ofruara institucioneve;
- Në tre subjekte u rekomandua që regjistrimi i vendimeve të kelegalizimit të kryhet vetëm mbi bazën e aktit origjinal;
- U rekomandua vendoja e një sistemi kontrolli për përcjelljen dhe administrimin Vendimeve nga Sektori i Legalizimeve dhe Proceseve Kalimtare në Sektorin e Shërbimeve të Kadastrës për regjistrim;
- Në tre subjekte u rekomandua vijimi i markimit të referencave të regjistrimit me vulën e kuqe numratore, në zbatim të kërkesave të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumentacionit ligjor në ZVRPP”;
- Në katër subjekte u rekomandua që pasqyra e llogaritjes së tatimit të jetë pjesë e

- referencës së regjistrimit të kalimit të pronësisë në çdo rast;
- Në dy subjekte u rekomandua që rivlerësimi i përdorur i pasurisë të mos mbartet në kartelën e re të saj, pasi akti përkatës është shfuqizuar;
  - Në gjashtë subjekte u rekomandua që në rastet e ndërtimeve informale mbi parcelën ndërtimore “shtet”, qytetari të njoftohet edhe për detyrimin e parcelës ndërtimore me emetimin e vendimit të legalizimit;
  - Në gjashtë subjekte u rekomandua që dokumentacioni tekniko-ligjor në dosjet e përfunduara të legalizimit të jetë i plotë;
  - Në gjashtë subjekte u rekomandua respektimi i afatit ligjor 60-ditor nga evidentimi në terren deri në daljen e vendimit të legalizimit;
  - Në katër subjekte u rekomandua që, në vijim, lidhja dhe inventarizimi i referencave të kryhet nga specialisti përgjegjës për regjistrimin e tyre;
  - Në dy subjekte u rekomandua që, në çdo rast, mallrat e furnizuara të merren në dorëzim me komision me qëllim konfirmimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe plotësisë së tyre;
  - Në një subjekt u rekomandua që Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, të kryejë çdo ditë rakordimi i të ardhurave, duke krahasuar ekstraktin e bankës me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Multifunksional për arkëtimet;
  - Në tre raste u rekomandua që Posta Shqiptare, në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes së përbashkët, të kryejë në fund të çdo dite xhirimin e të ardhurave në llogarinë e ASHK-së në bankën e nivelit të dytë;
  - Për diferencat e konstatuara në zbatimin e tarifave në katër subjekte, u rekomandua arkëtimi i tyre në masën 100 % në favor të të ardhurave të ASHK-së;
  - Për diferencat e konstatuara në llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë në dy subjekte të audituara, u rekomandua arkëtimi i tyre 100% në favor të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve;
  - Në gjashtë subjekte u rekomandua ndjekja e arkëtimin për shërbimet me paspagesë të ofruara institucioneve.

## V. MONITORIMI I REGJISTRIMIT FILLESTAR DHE PROCESIT TË KOMPENSIMIT

Drejtoria e Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar ka në përbërje të saj 3 sektorë sa vijon:

- **Spektori i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit**
- **Spektori i Kompensimit dhe Hartografisë**
- **Spektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive**

### **SEKTORI I KOMPENSIMIT DHE HARTOGRAFISË**

Sektori i Kompensimit dhe Hartografisë (GIS) gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025 ka vijuar funksionimin në përputhje me strukturën e re organizative, duke u konsoliduar si një njësi me rol të rëndësishëm në administrimin, përpunimin dhe analizimin e informacionit gjeohapësinor, si dhe në mbështetjen teknike dhe hartografike të proceseve të ndryshme institucionale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Sektori përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë, të cilët gjatë vitit 2025 kanë realizuar një volum të konsiderueshëm pune, duke kontribuar si në proceset operacionale të përditshme, ashtu edhe në realizimin e objektivave strategjike të institucionit.

Gjatë vitit 2025, një ndër prioritetet kryesore të sektorit ka qenë përpunimi dhe administrimi i informacionit gjeohapësinor në funksion të rritjes së transparencës, interoperabilitetit të të dhënave dhe mbështetjes së proceseve të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme. Në këtë kuadër, sektori ka realizuar përpunimin e informacionit gjeohapësinor të administruar në sistemin ALBSCAD për temat “Parcelat Kadastrale” dhe “Ndërtesat Kadastrale”, në zbatim të VKM nr.321, datë 27.04.2016, duke përpunuar në total 683,106 parcela dhe 632,487 ndërtesa, në vijim të bashkëpunimit institucional ndërmjet ASHK dhe ASIG për publikimin dhe unifikimin e të dhënave gjeohapësinore në nivel kombëtar.

Paralelisht me këtë proces, sektori ka kryer përpunimin dhe transformimin në sistemin KRGJSH të zonave kadastrale, parcelave dhe ndërtesave të regjistrimit fillestar që nuk ndodheshin të administruara në sistemin ALBSCAD, duke plotësuar mungesat ekzistuese dhe duke siguruar integritet më të plotë të informacionit gjeohapësinor të administruar nga institucionet shtetërore.

Në funksion të mbështetjes së politikave fiskale dhe proceseve të administrimit territorial, sektori ka realizuar përpunimin e hartave për përcaktimin e çmimeve mesatare referuese të banesave për 61 bashki të vendit, për kontratat e shitblerjeve të viteve 2022–2023 dhe 2024. Gjithashtu janë kryer verifikime të hartave në përputhje me standardin kadastral për projekt-VKM dhe e-akte të ndryshme, duke garantuar korrektësinë teknike dhe përputhshmërinë me standardet e administrimit kadastral.

Një rol i rëndësishëm i sektorit gjatë vitit 2025 ka qenë edhe mbështetja teknike dhe hartografike për institucione të tjera shtetërore dhe për procese me rëndësi kombëtare. Në këtë kuadër janë realizuar nxjerrja dhe përpunimi i zonave kadastrale për lejimin e kultivimit të cannabis për qëllime industriale, përgatitja e informacionit mbi sipërfaqet dhe numrin e pasurive pyje/kullota sipas bashkive, si dhe përgatitja e statistikave dhe informacionit të detajuar mbi sipërfaqet dhe numrin e pasurive sipas llojit të pasurisë për çdo zonë fiskale në Bashkinë Tiranë.

Në aspektin teknik dhe ndërinstitutional, sektori ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me sektorin Tekniko-Ligjor për trajtimin e çështjeve hartografike, si dhe me Drejtorinë e Pronave Shtetërore për konvertimin e hartave nga formati DwG në sistemin KRGJSH. Gjithashtu janë krijuar materiale të ndryshme hartografike për identifikimin e pronarëve shtetërorë dhe privatë, në funksion të proceseve të administrimit dhe verifikimit të pronësisë.

Një volum i konsiderueshëm pune është realizuar edhe në drejtim të trajtimit të dokumentacionit dhe korrespondencës institucionale. Gjatë vitit 2025, sektori ka trajtuar 486 shkresa dhe kthim-përgjigje mbi problematika të ndryshme që lidhen me hartografinë dhe kompensimin. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe trajtuar 540 dokumentacione tekniko-ligjore të ardhura nga drejtoritë vendore, të lidhura me kompensimin financiar të pronarëve të ligjshëm, pasuritë e të cilëve janë zënë nga parcelat e ndërtimeve të legalizuara.

Në kuadër të procesit të kompensimit financiar të pronarëve, sektori ka hartuar gjithsej 2 projekt-vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat janë miratuar gjatë periudhës raportuese. Këto VKM lidhen me kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme të prekura nga ndërtimet e legalizuara. Në total, përmes këtyre vendimeve janë trajtuar 952 pasuri për kompensim, me 4,747 trashëgimtarë përfitues, duke përfshirë një sipërfaqe totale kompensimi prej 223,504.6 m<sup>2</sup> dhe një vlerë totale kompensimi prej 2,201,738,902.9 lekë.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Sektori i Kompensimit dhe Hartografisë (GIS) ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e administrimit të informacionit gjeohapësinor, mbështetjen e proceseve të regjistrimit dhe kompensimit, si dhe në rritjen e bashkëpunimit institucional dhe ndërveprimit të sistemeve të informacionit. Aktiviteti i sektorit ka kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së të dhënave kadastrale, rritjen e transparencës dhe mbështetjen e reformave të digjitalizimit dhe modernizimit të administrimit të pronës në Republikën e Shqipërisë.

## **SEKTORI I REGJISTRIMIT FILLESTAR DHE PËRMIRËSIMIT**

Sektori i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025 ka vijuar ushtrimin e funksioneve të tij në përputhje me objektivat strategjike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke luajtur një rol kyç në ndjekjen, monitorimin dhe avancimin e proceseve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si një element kryesor i përmbushjeve të angazhimeve të agjencisë kundrejt detyrimeve të BE dhe Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Sektori përbëhet nga 6+1 pozicione organike, ku gjatë vitit raportues dy punonjës kanë qenë me leje lindje, ndërsa një pozicion ka rezultuar vakant. Pavarësisht këtyre kufizimeve në burime njerëzore, sektori ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune dhe ka vijuar realizimin e detyrave funksionale dhe objektivave institucionale.

Veprimtaria e sektorit është fokusuar në hartimin dhe zbatimin e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të institucionit, me synim përfundimin e procesit të Regjistrimit Fillestar, si dhe realizimin e proceseve të Përmirësimit të Regjistrimit Fillestar, si në mënyrë sistematike ashtu edhe sporadike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Në këtë kuadër, sektori ka ushtruar

funksiione monitoruese, kontrolluese, koordinuese dhe orientuese për strukturat operuese të ASHK-së dhe operatorët ekonomikë të angazhuar në këto procese.

Një ndër drejtimet kryesore të punës gjatë vitit 2025 ka qenë monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së produkteve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit. Në funksion të garantimit të standardeve teknike dhe ligjore të proceseve të regjistrimit, sektori ka hartuar gjithsej 45 raporte kontrolli për produktet digjitale të Regjistrimit Fillestar – Faza I, 18 raporte kontrolli për produktet digjitale të Regjistrimit Fillestar – Faza II, si dhe 47 raporte kontrolli për produktet digjitale të Përmirësimit të Regjistrimit. Nëpërmjet këtyre kontrolleve janë evidentuar problematikat teknike dhe procedurale, janë dhënë orientime konkrete për përmirësimin e produkteve dhe është ndjekur zbatimi i standardeve të miratuara nga Agjencia.

Paralelisht me procesin e kontrollit teknik, sektori ka vijuar monitorimin e ecurisë së proceseve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit në terren, nëpërmjet korrespondencës institucionale, analizave periodike dhe kontrolleve tematike në strukturat operuese të ASHK-së, duke siguruar koordinim të vazhdueshëm me drejtoritë vendore dhe subjektet zbatuese. Gjithashtu, sektori ka mbajtur dhe përditësuar informacionin mbi ecurinë e proceseve të regjistrimit për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke garantuar raportim të vazhdueshëm për nevojat e institucionit dhe strukturave drejtuese.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional dhe avancimit të proceseve të regjistrimit, sektori ka ndjekur procedurat dhe ka përgatitur dokumentacionin për miratim nga Këshilli Drejtues i ASHK-së për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor. Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë përgatitur dhe ndjekur procedurat për lidhjen e 3 marrëveshjeve bashkëpunimi me Bashkinë Shijak, Bashkinë Bulqizë dhe Bashkinë Selenicë, me qëllim kryerjen e procedurave të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit në zonat përkatëse.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i aktivitetit të sektorit ka qenë trajtimi i çështjeve teknike dhe hartografike që lidhen me proceset e regjistrimit. Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar 127 kërkesa dhe shkresa për problematika hartografike, duke ofruar zgjidhje teknike dhe ligjore në bashkëpunim me strukturat e tjera të institucionit. Këto procese kanë ndihmuar në unifikimin e praktikave teknike dhe në zgjidhjen e problematikave të hasura.

Në zbatim të Urdhrit nr.208, datë 21.01.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm, sektori ka ndjekur procedurat për hartimin e specifikimeve teknike për kryerjen e procedurave të Regjistrimit Fillestar për 106 zona kadastrale. Ky proces ka përbërë një hap të rëndësishëm në vijimin e objektivave strategjike të institucionit për arritjen e objektivit sipas kërkesave të BE dhe piketave të ndërmjetme për përfundimin e regjistrimit fillestar brenda Qershor 2026 për të paktën 95% të totalit të zonave kadastrale në Republikën e Shqipërisë, zgjerimin dhe përsheptimin e procesit të regjistrimit fillestar në zonat ende të papërfunduara.

Gjithashtu, sektori ka ndjekur dhe asistuar operatorët ekonomikë në zbatimin e kontratave të shërbimit për kryerjen e procedurave të Regjistrimit Fillestar, të lidhura gjatë vitit 2025 në kuadër të 7 loteve të prokuruar nga institucioni. Në këtë drejtim është ofruar asistencë teknike dhe institucionale për ndjekjen e fazave të punës, respektimin e afateve kontraktuale dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara për produktet e regjistrimit.

Përsa i përket ecuresë konkrete të procesit të Regjistrimit Fillestar gjatë vitit 2025, rezulton se procesi ka nisur në 151 zona kadastrale në rang vendi. Nga këto, për 66 zona kadastrale ka përfunduar Faza I e procesit, ndërsa 32 zona kadastrale kanë kaluar ose ndodhen në procesin e afishimit publik dhe kontrollit të cilësisë. Gjithashtu, për 24 zona kadastrale ka përfunduar Faza II e Regjistrimit Fillestar. Këto rezultate reflektojnë vijimin gradual të procesit dhe angazhimin institucional për përmbushjen e objektivave të reformës së regjistrimit fillestar në Republikën e Shqipërisë.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Sektori i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit ka kontribuar në forcimin e proceseve të monitorimit, kontrollit të cilësisë dhe koordinimit institucional për proceset e regjistrimit, duke mbështetur drejtpërdrejt realizimin e objektivave strategjike të ASHK-së për përfundimin e regjistrimit fillestar dhe modernizimin e administrimit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

Më poshtë gjeni në formë tabelare zonat kadastrale ku ka vijuar procesi gjatë vitit 2025 dhe fazat e tyre.

NR.	NR.ZK	EMRI.ZK	PROCES FAZA I	PËRFUNDUAR FAZA I	PËRFUNDUAR AFISHIMI PUBLIK	PËRFUNDUAR FAZA II
1	2072	KANDER				
2	2153	KISHAVEC				
3	2603	MARKAT				
4	3241	RRUSHKULL				
5	3715	VASHAJ				
6	3560	TAMARË				
7	3815	VORFË				
8	1430	CUKË				
9	3549	SUROPULL				
10	2272	KRESHOVË				
11	2711	MOKRICË				
12	1249	BOROCKË				
13	1968	HOTOVË				

14	2239	KOSOVË-GOSNISHT				
15	3131	RABAN				
16	1647	FSHATI I RI				
17	3008	PODGORAN FUSHË				
18	1088	BALLË				
19	1539	DRENOVË				
20	2384	LAPULEC				
21	2788	NGRACIE				
22	3789	VISOKË				
23	2350	KUTË				
24	1555	DRIZAR				
25	2802	NINESH				
26	2706	MLIZË				
27	3007	PODGORAN MAL				
28	1361	CAUSHAJ				
29	1177	BICAJ				
30	2471	LISNAJË				
31	2892	PAULESH				
32	2238	KOSOVË E VOGËL				
33	3622	TRANOSHISHT				
34	1074	BAJKAJ				
35	2654	MENGEL				
36	1481	DHËRMI BLL.3				
37	2518	LUKOVË BLL.4				
38	2806	NIVICË BLL.2				
39	2955	PICAR				
40	3858	XHYHERIN				
41	3064	PSAR				
42	3366	SHETEL				
43	3311	SHAHINAJ				
44	1345	BZHETË				

45	1346	BZHETË-MAKAJ				
46	2199	KOKPAPAJ				
47	2258	KOZHJE				
48	2487	LOHE E POSHTME				
49	2668	MESHQERË				
50	3170	REPISHT				
51	3697	VAJUSH				
52	3837	VUC-KURTAJ				
53	1448	DARRAGJAT				
54	2564	MALI GJYMTIT				
55	2904	PENTAR				
56	1289	BRUCAJ				
57	1769	GJURAJ				
58	2979	PLAN				
59	3853	XHAN				
60	1000	ABAT				
61	1714	GIMAJ				
62	1264	BRASHTË				
63	2792	NICAJ SHOSHE				
64	2859	PALAJ				
65	2400	LEKAJ				
66	2791	NICAJ SHALË				
67	3842	VUKANAJ				
68	2777	NENMAVRIQ				
69	2894	PECAJ				
70	2775	NDREJAJ				
71	2492	LOTAJ				
72	2907	PEPSUMAJ				
73	3307	SERME				
74	3772	VILE				
75	3607	TOPLAN				
76	2551	MALAGJIKAJVALL				

77	3571	TELUME			
78	2860	PALAJ GUSHTE			
79	3988	OROSH			
80	1304	BUKMIRE			
81	2773	NDERSHENE			
82	2534	LURTH			
83	3672	UKBIBAJ			
84	1259	BRADOSHNICË			
85	1993	JAHO-SALIHI			
86	2146	KERRNAJ			
87	2251	KOVAC			
88	2761	MYHEJAN			
89	2875	PAPAJ			
90	3986	RAGAM-LUGAJ			
91	1862	GRI E RE			
92	1456	DEGE			
93	2407	LEKURTAJ			
94	3288	SELIMAJ			
95	1223	BLLADE			
96	2602	MARKAJ			
97	1283	BRISE			
98	1432	CURRAJ I POSHTEM			
99	2403	LEKBIBAJ			
100	3588	TETAJ			
101	2864	PALCE			
102	3253	SALCE			
103	1761	GJONPEPAJ			
104	2911	PEPAJ			
105	1278	BRENOGE			
106	2463	LIQENI KUQ			
107	2950	PEROLLAJ			
108	2983	PLANI PATES			

109	3911	ZGJEC				
110	2674	METALIAJ				
111	2910	PERAJ				
112	3085	QARR				
113	1349	CAHAN				
114	3012	POGAJ				
115	1599	FAJZE				
116	3634	TREGTAN				
117	2731	MUJAJ				
118	3873	ZAHRISHT				
119	2431	LETAJ				
120	2152	KISHAJ				
121	3974	VLAHEN				
122	1683	GAJREP				
123	3821	VRANISHT				
124	2797	NIKOLIQ				
125	1788	GOLAJ				
126	1743	GJINOVEC				
127	2501	LUBALESH				
128	4002	CERENEC I EPERM				
129	1662	FUSHE E VOGËL				
130	2290	KRYEMADH				
131	3080	QAFË MURRË				
132	1111	BARDHAJ REC				
133	1889	GURE REC				
134	1973	HURDHE REC				
135	2774	NDERSHENE				
136	1011	ALIAJ				
137	3406	SHPAT				
138	1350	CAJE				
139	3482	SOHODOLL I MADH				
140	3483	SOHODOLL I VOGEL				

141	3004	POCEST			
142	3851	XHAFERAJ			
143	1338	BUZEMADHE			
144	1118	BARKANESH			
145	1474	DERSTIL			
146	2432	LETAN			
147	1899	GURI I ZI			
148	2355	LABINOT FUSHË			
149	1785	GODOLESH			
150	3748	VERMOSH			
151	2417	LEPUSHË			

## SEKTORI I ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË PASURIVE

Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive në periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka funksionuar sipas strukturës përkatëse me përbërje një përgjegjës dhe 3 specialist.

Gjatë vitit 2025 kanë punuar me kohë të plotë vetëm 2 antarë të këtij sektori, pasi një specialiste ka qenë me leje barrë lindje gjatë 10 muajve të parë, si dhe një specialist tjetër, për nevojat e Drejtorisë së Përgjithëshme, ka vijuar gjatë gjithë periudhës të jetë i ngarkuar me detyrën e monitoruesit, audituesit për vlerësimin e përgjigjeve të drejtorive vendore në lidhje me trajtimin e aplikimeve të qytetarëve për marrjen e shërbimeve kadastrale.

Puna e Sektorit të Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka qenë e fokusuar në aktivitetet e mëposhtme:

- A.** Përgatitja e projektaktit “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”;
- B.** Përgatitja e hartës së vlerës së tokës;
- C.** Trajtimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme institucionale në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.

### **A. Përgatitja e projektaktit mbi metodologjinë e përgatitjes së hartës së vlerës së tokës.**

Bazuar në përcaktimet ligjore të pikës k të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka vijuar punën për trajtimin e komenteve dhe rekomandimeve të dërguara nga Kryeministria me shkresën e saj nr.696/10 prot., datë 31.10.2024, administruar në Drejtorinë e Përgjithëshme të ASHK-së me nr.3177/2 prot., datë 04.11.2024, për ripunimin e

projektaktit në përputhje me praktikat me të mira europiane, duke përcaktuar metoda, rregulla e kriteret për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës për një shpërblim të drejtë të pronës.

Në vijim të kësaj shkrese kemi informuar Kryeministrinë, se për arsye kohe është çmuar e nevojshme që ky projektakt të kalojë dhe përfshihet në Programin Analitik të Projektakteve për vitin 2025.

Projektakti është ripunuar nga Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive, sipas orientimeve të Kryeministrisë dhe në muajin Mars është përcjellë për vlerësim tek titullarët. Bashkë me projektaktin është përcjell edhe opinionin jonë mbi nevojën e një konsulence nga një ekspert i jashtëm, i fushës së vlerësimit të pasurive të paluajtshme, për vlerësimin e tij, duke dhënë orientimet përkatëse për ndonjë përmirësim të mundshëm para se të vijohet me procedurën e miratimit të tij.

Gjatë muajit Nëntor, Dhjetor 2025 është mbajtur një korespondencë me një ekspert të huaj, të cilit i janë vënë në dispozicion drafti i projektaktit, si dhe informacione të tjera të kërkuara prej tij.

Duke qenë se, nuk u arrit të kishim një opinion nga eksperti i huaj brenda vitit 2025, si dhe një qëndrim vlerësues të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së në lidhje me këtë draft të projektaktit është kërkuar që ai të kalojë për planifikim në PPAP 2026.

## **B. Përgatitja e hartës së vlerës së tokës.**

Gjatë vitit 2025, Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka punuar me nën-aktivitetet e ndryshme për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës, si më poshtë:

1. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë.
2. Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë dhe organizimi i tyre për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.
3. Përlogaritja e vlerës së pasurisë.

### **1. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë.**

Në bazë të *Vendimit të KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”*, të dhënat mbi transaksionet e kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë që do të përdoren për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës, janë të dhënat zyrtare të administruara nga zyrat dhe drejtoritë vendore të ASHK-së sipas informacionit të regjistrit kadastral.

Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive pas kërkimeve të kryera në sistemin informatik të pasurive të paluajtshme ka mundur të gjenerojë gjatë vitit 2025 të dhënat për **8,564 traksaksione** gjithsej për kontrata shitje mbi pasuritë e llojit tokë, nga të cilat **2,226 rekorde** i përkasin periudhës *01 Nëntor 2024 deri më 31 Dhjetor 2024* dhe **6,338 rekorde** i përkasin periudhës *01 Janar 2025 deri më 31 Tetor 2025*.

## **2. Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë dhe organizimi i tyre për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.**

Një nga proceset më të rëndësishme gjatë përgatitjes së hartës së vlerës së tokës është përpunimi i të dhënave të administruara dhe organizimi i tyre.

Të dhënat e grumbulluara përmbajnë informacione për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme ku janë kryer transaksione të kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes. Fillimisht kemi veçuar të dhënat digjitale për pasuritë e paluajtshme të llojit tokë bujqësore, tokë truall, tokë pyjore dhe tokë kullosore në programin informatik excel, duke i organizuar dhe grupuar ato sipas zonave kadastrale ku gjendet pozicioni gjeografik i pasurisë së paluajtshme përkatëse. Më pas, kemi eliminuar të dhënat me probleme, sa i përket gabimeve që lidhen me, numrin e pasurisë, vlerën e pasurisë, llojin e pasurisë, dublimet, etj.

Gjatë përpunimit të të dhënave janë zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””.

Nga **8,564 rekorde** të dhënash gjithsej, kanë rezultuar:

- **1,813 rekorde tokë truall;**
- **6,518 rekorde tokë bujqësore;**
- **130 rekorde tokë pyjore;**
- **103 rekorde tokë kullosore.**

## **3. Përlllogaritja e vlerës së pasurisë.**

Përlllogaritja e vlerës së pasurisë kryhet duke zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””, si dhe Vendimi i KM nr. 1034, datë 16.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 658, datë 26.09.2012

“Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”.


Përlllogaritja e vlerës së pasurisë kryhet për çdo zonë kadastrale ku janë administruar të dhëna mbi transaksionet me pasuritë e paluajtshme. Për zonat kadastrale ku të dhënat janë në mungesë është ruajtur vlera e përcaktuar sipas hartës së vlerës së miratuar nga Këshilli i Ministrave në vendimin paraardhës.


Gjatë përlllogaritjeve kryhet dhe verifikimi i saktësisë së rezultatit sipas aneksit 1/1 të metodologjisë së miratuar me VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2025 është punuar për përlllogaritjen e nivelit të vlerës për ZK ku ka patur të dhëna për transaksionet e kalimit të pronësisë me kontrata shitje. Në përlllogaritje janë përfshirë të gjitha të dhënat e administruara nga sektori për periudhën Janar 2017 deri në Nëntor 2025. Numri i të dhënave (rekordeve) për këtë periudhë ka qenë **33,582 rekorde** të dhënash për pasuritë e llojit tokë.

#### NUMRI I VLERAVE TË ADMINISTRUARA SIPAS VITEVE

NR	LLOJI	VITI									GJITHSE J
		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	
1	TRUALL	323	348	204	230	489	1,596	1,225	1,970	1,202	7,587
2	ARE	2,587	2,047	1,452	609	2,546	3,781	3,197	4,053	5,000	25,272
3	PYLL	19	19	23	3	33	69	31	86	67	350
4	KULLOTË	26	7	24	1	33	71	82	60	69	373
SHUMA		2955	2421	1703	843	3101	5,517	4,535	6,169	6,338	33,582





Bazuar në të dhënat e administruara është kryer përlllogaritja e nivelit të vlerës së pasurive të paluajtshme për llojet tokë truall, tokë arë, tokë pyll dhe tokë kullotë.

Konkretisht, më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur numrin e ZK-ve ku kemi patur të dhëna për kontratat e shitjes dhe në sa prej tyre ka qenë e mundur që të përlllogaritej një nivel vlere i pasurisë së paluajtshme për vitin 2025 sipas llojit përkatës.

Gjithashtu, jepet dhe numri i zonave kadastrale sipase tendencës së nivelit të vlerës së përlllogaritur për vitin 2025 krahasuar me nivelin e vlerës së pasurive në hartën e vlerës së tokës në fuqi, të miratuar në vitin 2016.

NR.	LLOJI	NUMRI I ZONAVE KADASTRALE					
		GJITHSEJ	KA VLERA	PËRLLOGARITUR NIV. VLERË	NIV. VLER. PËRLLOGARITUR PË 2025 KRAHASUAR ME NIV. VLER. 2016		
					ULUR	I NJËJTË	RRITUR
1	TRUALL	3,058	403	256	20	20	216
2	ARË	3,058	1,333	1,019	178	359	482
3	PYLL	3,058	62	30	5	1	24
4	KULLOTË	3,058	75	31	0	10	21

Në vijim, gjatë vitit 2026, po punohet për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës sipas nivelit të vlerave të përlllogaritura.

### C. Trajtimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme për informacione në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.

Gjatë vitit 2025 Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka punuar edhe në lidhje me trajtimin e korrespondencës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme, kryesisht ato që kanë të bëjnë me të dhënat mbi transaksionet e kontratave të shitjes apo vlerës së pasurive të paluajtshme.

Kështu, në zbatim të pikës 2 të Udhëzimit nr. 1, datë 17.03.2023 “Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e çmimit mesatar të shitjes së banesave në treg”, është punuar për të evaduar të gjithë korrespondencën e Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive rajonale të Entit Kombëtar të Banesave me Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë vendore të ASHK-së në lidhje me dhënien e informacionit mbi të dhënat e kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme të llojit apartament, njësi, garazhde, bodrume, etj. për një periudhë nga Tetor 2024 deri në Tetor 2025. Eshtë dhënë informacion për rreth **19,430 kontrata shitje**.

Gjithashtu, është punuar për përgatitjen e informacioneve të ndryshme mbi numrin e transaksioneve të kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe numrin e shërbimeve për transaksionin e rivlerësimit për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2025 për trajtimin e kërkesave të shoqatës NAREA.

Është punuar për dhënien e ndihmës së kërkuar nga Sektori i Çështjeve Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme, në lidhje me aktet e ekspertimit të përgatitura nga ekspert privat mbi vlerësimin e pasurive të paluajtshme që janë objekt kompensimi në çështje të ndryshme gjyqësore, konkretisht në 2 çështje.

Janë trajtuar, korespondencat e ndryshme të ardhura nga individë dhe institucione në lidhje me informacione mbi hartën e vlerës në fuqi.

## **VI. HARTIMI I LEGJISLACIONIT, KONTOROLLI TEKNIKO-LIGJOR, ANTIKORRUPSIONI DHE ÇËSHTJET GJYQËSORE**

**Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor ka në përbërje të saj 4 sektorë:**

1. Sektori i Hartimit të Legjislacionit
2. Sektori i Kontrollit Tekniko-Ligjor
3. Sektori i Antikorrupsionit
4. Sektori i Çështjeve Gjyqësore

Më poshtë jepet analiza e secilit sektor për vitin 2025, për veprimtarinë e tyre sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të ushtruara prej tyre në zbatim të Rregullores së Brendshme të ASHK-së.

## 1. SEKTORI I HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT

Sektori i Hartimit të Legjislacionit në strukturë përbëhet nga 4 punonjës, 1 përgjegjës dhe 3 specialist. Në funksion të detyrave të ngarkuara nga Rregullorja e Brendshme e ASHK-së, **Sektori i Hartimit të Legjislacionit**, ka hartuar mbi 99.5 % të akteve nënligjore (projektvendime të Këshillit të Ministrave), në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Referuar fushës së saj të veprimtarisë për vitin 2025 nga Sektori i Hartimit të Legjislacionit janë përmbyshur funksionet administrative në drejtimet sa vijon:

- **Hartimi i akteve nënligjore për vitin 2025**

Akte nënligjore në zbatim të Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” të hartuara dhe miratuara në vitin 2025 dhe akte të brendshme janë sa vijon:

Nr.	Aktet nënligjore të miratuara për vitin 2025
1	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave nr.462, datë 31.07.2025</b> ”Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar”
2	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave nr.695, datë 26.11.2025</b> “Për disa ndryshime në vendimin nr. 5, datë 11.1.2023, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e vlerës së tarifave dhe pagesave, masës së penalteteve, si dhe të mënyrës së llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave të arkëtuara nga proceset kalimtare të pronësisë”.
3	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave nr.696, datë 26.11.2025</b> “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.
4	<b>Udhëzimin i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 30.12.2025</b> “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 17.7.2024, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes, porosisë dhe të premtimshitjes”
5	<b>Udhëzim i DP nr.682, datë 30.05.2025</b> “Për miratimin e modelit të kërkesës për shërbime kadastrale dhe procedurat standarde të veprimeve me regjistrin elektronik të kërkesave”.
6	<b>Urdhër i DP nr.1264, datë 22.12.2025</b> “Për miratimin e modelit të formularëve standart të aprovimit të produkteve digjitale të regjistrimit fillestar”

7	<b>Urdhër i DP nr.1162, datë 05.11.2026</b> “Për zbatimin e masave administrative në zbatim të nenit 64 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”
---	---

- **Akte të brendshme të miratuara për ASHK për vitin 2025**
  - 1.**Plani i integritetit të ASHK-së** miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1219, datë 25.11.2025;
  - 2.**Udhërfyesi për Digjitalizimin të ASHK-së 2025-2028**, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.710, datë 09.06.2025;
  - 3.**Strategjia e Komunikimit për ASHK-në.**
  
- **Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet/entet publike të realizuara në vitin 2025**
  - 1.**Marrëveshjet midis ASHK-së dhe 61 Bashkive** në kuadër të përmbylljes së procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zbatim të VKM nr.435, date 26.06.2024 “Për një shtesë në Vendimin nr.867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”;
  - 2.**Marrëveshje bashkëpunimi midis ASHK dhe Bankës Credins** nr.7539 prot, datë 26.05.2026 “Për pranimin, administrimin dhe raportimin e pagesave në bono privatizimi”
  - 3.**Marrëveshje bashkëpunimi midis ASHK dhe Shoqatës së Gjeodetëve (SHGJSH)** nr.2039, datë 31.01.2025;
  - 4.**Marrëveshje bashkëpunimi midis ASHK, Dhomës së Noterisë dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit** nr. 7307 prot., datë 19.05.2025
  - 5.**Marrëveshje bashkëpunimi midis ASHK dhe AZHT** nr.9708 prot., datë 18.07.2025;
  
- Sektori i Hartimit të Legjislacionit ka dhënë mendim **për 73 projektakte** të përcjella për mendim në ASHK nga institucione të tjera për vitin 2025.
  
- **Shkresa unifikuese/orientuese në vitin 2025**
  - 1.Shkresa nr.6332/1 prot., datë 10.11.2025 “Mbi mënyren e veprimit në rastin e korrigjimit të gabimeve”;
  - 2.Shkresë nr.11904 prot., datë 26.09.2025 “Në vëmendje në lidhje me kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme që paraqiten për regjistrim nga noterët në regjistrin kadastral”;
  - 3.Shkresë nr.2992/1 prot., datë 03.04.2025 “Për veprim mbi konstatimet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit”.
  
- **Trajnimet në ASHK për vitin 2025**

ASHK gjatë vitit 2025 me qëllim rritjen e nivelit profesional të punojësve të drejtorive vendore të ASHK-së, performancës së tyre, kapaciteteve të burimeve njerëzore,

përnirësimin të cilësisë në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative, rritjes së performancës, Drejtoria e Përgjithshme ka zhvilluar trajnime mujore për drejtoritë vendore të ASHK-së sipas programit dhe kalendarit vjetor të miratuar, sipas akteve të mëposhtme:

**1.Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm nr.3268, datë 31.12.2024** “Për miratimin e Programit dhe Kalendarit Vjetor të Trajnimit të ASHK-së për vitin 2025”;

**2.Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm nr.3269, datë 31.12.2024** “Për miratimin e listës së trajnerëve të brendshëm të ASHK-së për zhvillimin e programit vjetor të trajnimit për vitin 2025”, i ndryshuar me Urdhrin nr.680, datë 29.05.2025.

Tematikat që janë trajtuar nëpërmjet trajnimeve të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme për vitin 2025 janë sa vijon:

- Rregullat dhe procedurat e lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore në zbatim të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe VKM nr.1182/2020.Procedura për kalimin e sipërfaqes shtetërore shtesë dhe pronës shërbyese në përputhje me parashikimet e nenit 10 të ligjit nr.20/2020 dhe Udhëzimit nr.2307, datë 01.11.2023 “Për miratimin e modeleve të akteve për kalimin e pronësisë të sipërfaqeve shtetërore shtesë si dhe të pronës shërbyese”, etj. Shkurt-Mars 2025, DVASHK.
- Trajnimi i punonjësve të ASHK-së mbi sigurinë kibernetike në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas profilit të punës, si dhe përnirësimet në sistemin ALBSCAD. Prill-Maj 2025, DVASHK.
- Konfirmimi mbi aktet administrative të lëshuara nga Drejtoria Vendore (vendime bazuar në VKM nr. 827/2020 dhe vendime legalizimi).Procedura e shqyrtimit administrativ, në referim të Kodit të Procedurave Administrative. Teknika legjislative e hartimit të vendimmarrjes administrative.Zbatueshmëria e vendimit administrativ. Qershor-Korrik 2025, DVASHK.
- Zbatimi i procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, afate për përgatitjen dhe përcjelljen e propozimeve për miratimin e masës dhe vlerës së kompensimit financiar të pronarëve joposedues. Mënyra e llogaritjes dhe shitjes së parcelës ndërtimore. Shtator 2025, DVASHK.
- Procedurat dhe rregullat për verifikimin e elementeve të akteve noteriale,vendimeve gjyqësore, akteve administrative dhe akteve të përmbauesve gjyqësor në funksion të regjistrimit të tyre në regjistrin kadastral në përputhje me parashikimet e ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, VKM nr.639, datë 16.10.2024 dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të ligjit. Tetor 2025, DVASHK.
- Rregullat dhe procedurat e kalimit të pronësisë, afatet dhe mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit, zbritjet që përfitohen si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluar. Dhjetor 2025, DVASHK.

- **Korrespondencë shkresore për vitin 2025** me institucione apo DVASHK për problematika lidhur me pasuritë e paluajtshme, apo subjektet **në total 980 shkresa**.

## 2. SEKTORI I KONTROLLIT TEKNIKO-LIGJOR

Sektori i Kontrollit Tekniko-Ligjor përbëhet nga Përgjegjësi dhe 8 specialistë (jurist, inxhinier). Në funksion të detyrave të ngarkuara nga Rregullorja e Brendshme e ASHK-së, Sektori i Kontrollit Tekniko-Ligjor për vitin 2025 ka kryer veprimtarinë e mëposhtme:

- Eshtë miratuar plani i veprimit për kryerjen e kontroleve periodike në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 527, datë 08.04.2025 *“Për miratimin e planveprimit të kryerjes së kontroleve në drejtoritë/zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2025”*.

Në mbështetje të Kreut X nenet 77 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, pikës dh, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, si dhe në zbatim të urdhrin nr. 527, datë 08.04.2025, gjatë vitit 2025 nga Sektori i Kontrollit Tekniko – Ligjor është vijuar me paraqitjen pranë Drejtorisë/Zyrës Vendore përkatëse, ku është verifikuar i gjithë dokumentacioni i administruar në drejtori/zyrë në lidhje me objektin e kontrollit. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit tekniko – ligjor, si dhe observacioneve të paraqitura, është vijuar me hartimin e akteve për vlerësim e miratim pranë Drejtoreshës së Përgjithshme, mbi masat organizative, administrative dhe disiplinore të propozuara, e cila i përcillet Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve për zbatim.

Në total gjatë vitit 2025 nga ana e Sektorit të Kontrollit Tekniko Ligjor janë kryer:

- **35** akte kontrolli ku janë dhënë :
  - **187** masa organizative
  - **158** masa disiplinore
  - **24** masa administrative/gjoha
  - **4** kallëzime penale, më konkretisht
    - **3** kallëzime penale më datë 18.03.2025 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
    - **1** kallëzim më datë 07.07.2025 në SPAK – Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Ndërkohë, paralelisht me zbatimin e planveprimit të vitit 2025 nga SKTL janë trajtuar: 36 memo/raporte/observacione të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, ku është proceduar me hetime administrative në DVASHK Berat, Sarandë, Gjirokastrë, Vlorë, Fier, Korçë, Pogradec, Shkodër, Lezhë, Tiranë Veri, Tiranë Jug, referuar propozimeve në raporte. Lidhur me propozimet për fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësit/specialistët

përgjegjës rezulton se disa prej tyre të konstatuar përgjegjës për veprime dhe/ose mosveprime në aktet e sipërcituara janë larguar nga ASHK. Ndërkohë janë propozuar masat e tjera disiplinore për specialistë e tjerë përgjegjës të cilët vijojnë ende të jenë pjesë e strukturave të ASHK-së (duke filluar nga “tërheqje vëmendje”, “vërejtje”, “vërejtje me shkrim” deri në “vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”).

Vlerësojmë se hetimet administrative dhe procedura e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në lidhje me çështjet dhe propozimet e tyre për ecurinë disiplinore përbëjnë dublim të punës së kryer dhe një zgjatje afati vendimmarrjeje, duke rënë ndesh me parimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sanksionuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”.

- Gjithashtu, paralelisht është vijuar me shqyrtimin/trajtimin e ankesave të qytetarëve, Memo për verifikim të përcjella nga Drejtori dhe Sektorë të ndryshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, lidhur me kërkesë/ankesa të subjekteve të administruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së lidhur me mos zbatimin/respektimin e afateve në trajtimin e kërkesave/aplikimeve të paraqitura për shërbime kadastrale, për problematika të ndryshme për të cilat nuk ka një përgjigje/qëndrim shterues nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-ve.
- Më tej, vlen të përmendet se referuar urdhërit nr. 781, datë 29.04.2024 janë ushtruar kontrole në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës lidhur me zbatimin e VKM nr. 827, datë 30.9.2020 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim”. Aktet e kontrollit dhe masat organizative lidhur me verifikimet e kryera janë përfunduar në vitin 2025, nga ku rezultojnë të jenë dhënë 56 masa organizative dhe 55 masa disiplinore.

### 3. SEKTORI I ANTIKORRUPSIONIT

Sektori i Antikorrupsionit, referuar strukturës së miratuar, përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe 4 specialistë. Aktualisht, sektori funksionon me 3 specialistë. Në funksion të detyrave të ngarkuara nga Rregullorja e Brendshme e ASHK-së, Sektori i Antikorrupsionit ka trajtuar kërkesa/ ankesa me objekte si vijon:

- o Për regjistrim të titujve të pronësisë;
- o Për pajisje me dokumenta pronësie;
- o Për marrjen kopje të vërtetuar të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme;
- o Për vendosje apo heqje kufizimesh të përkohshme, në kartelat e pasurive;

- o Për regjistrim vendim gjykate të formës së prerë;
- o Për korrigjim gabimesh në certifikatë, kartelë dhe hartë;
- o Për regjistrim akti të dëshmisë së trashëgimisë;
- o Për regjistrimin e akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëvetë truallit apo me subjekte të treta;
- o Për regjistrime të kontratave (kontratës së shitjes, dhurimit, hipotekës, etj.);
- o Për aplikimin e kalimit nga regjistrat hipotekorë në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.

• **Të dhëna lidhur me ankesat:**

Në Sektorin e Antikorrupsionit, gjatë vitit 2025 janë deleguar 2393 praktika për shqyrtim/ trajtim administrativ, nga të cilat 2248 janë trajtuar.

<b>ANKESA 2025</b>		
<b>Drejtoria /zyra</b>	<b>Deleguar</b>	<b>Trajtuar</b>
BERAT	118	110
BULQIZË	1	1
DURRËS-KAVAJË-KRUJË	284	270
DURRËS-KAVAJË-KRUJË/ZONAT E STIMULUARA	1	1
ELBASAN	78	74
FIER	123	121
GJIROKASTËR	85	77
KAMËZ-VORË	68	64
KAMËZ-VORË / TIRANË RURALE 2	1	1
KORÇË-DEVOLL-KOLONJË	97	89
KUKËS	26	24
KURBIN	1	1
LEZHË	66	57
LUSHNJË	35	32
MALËSI E MADHE	1	1

MAT	4	1
POGRADEC	21	21
QKD	1	1
SARANDE	94	84
SHKODER	130	125
TIRANE JUG	155	150
TIRANE RURALE 1	148	144
TIRANE RURALE 1/TIRANE JUG	1	1
TIRANE RURALE 1/TIRANE RURALE 2	1	1
TIRANE RURALE 1/TIRANE VERI	1	1
TIRANE RURALE 2	119	114
TIRANE RURALE 2/TIRANE JUG	1	1
TIRANE VERI	332	315
TIRANE VERI/TIRANE JUG	2	2
TROPOJE	3	3
VLORE	344	319
ZONAT E STIMULUARA	3	3
TE TJERA	48	39
<b>Total</b>	<b>2393</b>	<b>2248</b>

- **Plani i Integritetit i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 2025-2027.**

Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor, përmes Sektorit të Antikorrupsionit, gjatë vitit 2025 udhëhoqi procesin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit në ASHK, si dhe për hartimin e Planit të Integritetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në përfundim të një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ, Plani i Integritetit i ASHK-së është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1219, datë 25.11.2025, është publikuar në faqen zyrtare të ASHK-së<sup>1</sup> dhe është masë e miratuar nga BE, si masë e përcaktuar në Agjendën e Reformave në kuadër të integritetit të

<sup>1</sup> link: <https://www.ashk.gov.al/plani-i-integritetit-per-agjencine-shteterore-te-kadastres-2/>

Shqipërisë në Bashkimin Europian. Plani i Integritetit, përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, në kuadër të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe është konceptuar si një instrument konkret, që përfshin masa të matshme dhe përgjegjësi të qarta institucionale, me synimin për të përmirësuar mënyrën e funksionimit të përditshëm të institucionit. Në thelb të tij qëndrojnë katër shtylla kryesore: forcimi i kontrollit të brendshëm përmes mekanizmave efektivë kundër korrupsionit, konfliktit të interesit; rritja e përgjegjshmërisë institucionale duke përcaktuar qartë rolet dhe detyrimet e çdo punonjësi; rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve; si dhe garantimi i transparencës përmes informimit të hapur dhe komunikimit proaktiv me publikun.

Përmes këtij plani, ASHK synon të forcojë mekanizmat e brendshëm të kontrollit dhe parandalimit të praktikave të cenueshme nga korrupsioni, konflikti i interesit dhe ndikimi i papërshtatshëm në proceset vendimmarrëse, të përmirësojë transparencën institucionale dhe llogaridhënien ndaj publikut, të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve për përgjegjësitë që mbartin dhe të nxisë një kulturë etike dhe profesionale të orientuar drejt shërbimit publik, të sigurojë që çdo qytetar të trajtohet me barazi, drejtësi dhe respekt, duke u garantuar qasje të pakushtëzuar në shërbimet publike dhe duke minimizuar çdo formë arbitrariteti apo diskriminimi në proceset administrative, si dhe të rikthejë dhe të konsolidojë besimin e publikut ndaj institucionit, si një strukturë publike funksionale, transparente dhe efikase.

Zbatimi i Planit të Integritetit dhe i Planit përkatës të Veprimit parashikohet të realizohet gjatë periudhës trevjeçare 2025–2027, në përputhje me një qasje të strukturuar, të bazuar në prioritetet të përcaktuara qartë dhe afate kohore të monitorueshme.

Masat e parashikuara në Planin e Veprimit janë aktualisht në fazë zbatimi, në përputhje me afatet dhe përgjegjësitë e përcaktuara.

Një rol thelbësor për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit, ka Koordinatorin e Integritetit, i cili siguron drejtimin teknik të procesit të zbatimit nëpërmjet një Plani pune sipas hapave të planifikimit, organizimit, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe përmirësimit, lidhur me masat sipas prioritetit, afatit dhe njësisë përgjegjëse.

#### 4. SEKTORI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Sektori i Çështjeve Gjyqësore, referuar strukturës së miratuar, përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe 3 specialistë.

- Për vitin 2025, nga raportimet e kryera nga drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK, rezulton se:  
Numri i përgjithshëm i çështjeve të përfunduara me vendim të formës së prerë, **është 617 çështje**  
Numri i çështjeve të fituara është, **449 çështje**  
Numri i çështjeve të humbura, **168 çështje**.

Në kuadër të raportit për analizën vjetore të ASHK për vitin 2025, indikatori që raportohet nga Sektori i Çështjeve Gjyqësore ka të bëjë me trendin e gjyqeve të fituara në raport me gjyqet e zhvilluara.

- Sektori i Çështjeve Gjyqësore ka trajtuar **42 kërkesa** për informacion të përcjella nga Gjykata, Prokuroria, Avokatura e Shtetit etj, lidhur në dhënien e informacionit mbi statusin juridik të pasurive objekt gjykimi, kërkesa për regjistrimin e akteve (kërkesëpadi, vendime gjyqësore civile, administrative apo penale, vendime ekzekutimi të përmbaruesve gjyqësor shtetëror apo privatë etj), të trajtuara sipas drejtorive vendore të ASHK-së:

Emërtimi i drejtorisë	Numri i kërkesave për informacion
DV ASHK Jug	5
DV ASHK Veri	10
DV ASHK Rurale 1	7
DV ASHK Rurale 2	2
DV ASHK Kamëz-Vorë	2
DV ASHK Durrës-Kavajë-Krujë	3
DV ASHK Elbasan	1
DV ASHK Vlorë	3
DV ASHK Shkodër	5
DV ASHK Sarandë	2
Të gjitha drejtorive vendore	3
<b>Total</b>	<b>43</b>

- Në kuadër të mbrojtjes së interesave juridike dhe pasurore të shtetit gjatë vitit 2025, me qëllim **përfaqësimin në gjykatë**, ka vijuar bashkëpunimi me Avokaturën e Shtetit (zyrat vendore) nëpërmjet **shkëmbimit të informacionit dhe dokumentacionit** me DV ASHK-të përkatëse, **gjithsej 10 raste**. Avokatura e Shtetit ka përcjellë për njohje dhe ekzekutim **12 vendime gjyqësore**, të cilat janë përcjellë pranë drejtorive vendore në kompetencën territoriale të të cilave kanë qënë pasuritë objekt gjykimi.
- Janë trajtuar kërkesë/ankesa të palëve të treta të cilët për nevoja të ecurisë së procesit gjyqësor kanë kërkuar sipas rastit, përfaqësimin sistematik të ASHK-së në procesin gjyqësor, dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar nga gjykata i vlefshëm për gjykimin sa më të drejtë të çështjes apo kanë kundërshtuar ankimin ndaj vendimit të shkallës së parë duke kërkuar që ASHK të heqë dorë nga ankimi, **gjithsej 10 kërkesa**. Më poshtë, janë të detajuara kërkesë/ankesat e palëve të treta të përcjella dhe të trajtuara sipas drejtorive vendore të ASHK-së:

--	--

<b>Emërtimi i drejtorisë</b>	<b>Numri i kërkesë/ankesave</b>
DV ASHK Fier	2
DV ASHK Gjirokastrë	1
DV ASHK Dibër	1
DV ASHK Sarandë	2
DV ASHK Durrës-Kavajë-Krujë	2
Për disa drejtori vendore	1
<b>Total</b>	<b>10</b>

## **VII. BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR**

### **PEMA E PROGRAMIT TË ASHK PËR VITIN 2025**

### Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nëpërmjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim përmirësimin e sistemeve të ASHK-së, përditesimin e të dhënave dixhitale të kartelës dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme si dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ASHK ka për mision të zbatojë politikat sektoriale në fushën e legalizimit të ndërtimeve pa leje si dhe procesit të regjistrimit fillestar në Republikën e Shqipërisë. ASHK, do të vazhdojë të kryejë detyrat dhe të ushtrojë përgjegjësitë e përcaktuara në përputhje me Ligjin Nr.111/2018, "Për kadastrën", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. ASHK ka për qëllim gjithashtu të kryejë inventarizimin dhe regjistrimin e pronave shtetërore.


### OBJEKTIVAT

**OBJEKTIVI 1:** Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme dhe skanimi i dokumentacionit tekniko-ligjor. Rregjistrim Fillestar me të ardhurat e ASHK-së dhe me Financim nga Buxheti i Shtetit .

**OBJEKTIVI 2:** Legalizimi i ndërtimeve informale, Objekteve të ndërtuara para vitit 1991, Oborreve në përdorim, AMTP-ve, Inventarizimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore.

**OBJEKTIVI 3:** Menaxhimi, përmirësimi dhe sigurimi i sistemeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

**OBJEKTIVI 4:** Rindërtimi i infrastrukturës së ASHK-së, rikonstruksion ndërtesash, kompletimit të Drejtorive të ASHK-së me pajisje kompjuterike dhe orendi të domosdoshme.



## BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2025

Në 000/ lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti Janar - Dhjetor 2025	
	Të Ardhura	Shpenzime
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndertimore+Të tjera	4,534,460	
Fonde të transferuara nga buxheti i shtetit	1,577,329	
Shpenzime Personeli		2,837,843
Shpenzime Operative		612,167
Shpenzime Kapitale		387,007
Fondi Rezervë		104,700
Fonde të transferuara nga buxheti i shtetit për shpenzime		1,577,329
<b>Total Buxheti ASHK</b>	<b>4,534,460</b>	<b>3,941,718</b>
<b>Total transferta nga buxheti i shtetit</b>	<b>1,577,329</b>	
<b>Të ardhura të pashpërndara ASHK</b>		<b>592,742</b>

## 1. Planifikimi buxhetor i ASHK-së

Në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) ka hartuar Programin Buxhetor për vitin 2025 për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 22 Drejtoritë e saj të varësisë.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 05.02.2025 “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2025”, si dhe shkresën nr. 2564/1 prot., datë 17.02.2025, “Dërgohet detajimi i buxhetit për vitin 2025”, Drejtoria e Financës ka realizuar detajimin e fondeve buxhetore dhe shpërndarjen e limiteve mujore për të gjitha Drejtoritë e varësisë.

Ky proces është shoqëruar gjithashtu me përcaktimin dhe shpërndarjen e numrit të punonjësve të miratuar për institucionin, si në strukturë (1,178 punonjës) ashtu edhe me kontratë (480 punonjës). Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë e varësisë së ASHK-së kanë nisur vitin buxhetor 2025 me fonde dhe numër punonjësish të miratuar, në përputhje me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 12, datë 20.12.2024, si dhe me VKM-në për buxhetin e vitit 2025, duke respektuar plotësisht procedurat dhe afatet ligjore në fuqi.

## 2. Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të ASHK-së

Drejtoria e Financës, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ka forcuar mekanizmat e kontrollit financiar, duke siguruar një menaxhim dhe monitorim të vazhdueshëm të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së.

Monitorimi është kryer mbi baza mujore dhe në mënyrë progresive për periudhën Janar–Dhjetor 2025, me qëllim rritjen e efikasitetit në administrimin e fondeve dhe minimizimin e risqeve në proceset financiare. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, janë përgatitur rregullisht evidencat mujore të monitorimit, të cilat pasqyrojnë realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të gjeneruara nga shërbimet e regjistrimit dhe proceset e legalizimit.

Për periudhën Janar–Dhjetor 2025, fondet janë administruar dhe menaxhuar, duke përfshirë këto kategori kryesore të të ardhurave:

- të ardhurat nga shërbimet kadastrale dhe të tjera,
- të ardhurat nga proceset kalimtare,
- të ardhurat nga tarifat e proceseve kalimtare.

Ky proces ka kontribuar në rritjen e transparencës, përmirësimin e disiplinës financiare dhe garantimin e përdorimit efektiv të fondeve publike.

### **3. Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të financuara nga buxheti i shtetit**

**Në përmbushje të Objektivit nr. 1** të programit buxhetor për vitin 2025, që lidhet me digjitalizimin e të dhënave kadastrale dhe regjistrimin fillestar, si dhe për garantimin e vijimësisë së projektit të digjitalizimit, është siguruar financim i dedikuar nga Buxheti i Shtetit.

Në mbështetje të VKM nr. 747, datë 09.12.2021, për projektin “Dixhitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme”, fondi prej 652,000,000 lekë i akorduar nga qeveria shqiptare u përdor deri në muajin qershor 2024. Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 7, datë 27.06.2024, u miratua vijimësia e projektit deri në dhjetor 2025, ndërsa për këtë periudhë u siguroa financim shtesë nga të ardhurat e ASHK-së në vlerën 142,910,346 lekë.

Në vijim, me Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 ‘Për buxhetin e vitit 2024’, të ndryshuar”, Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së **iu transferua një fond prej 1,577,400,000 lekë**, me qëllim financimin e projekteve “Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme” dhe “Regjistrimi fillestar i zonave kadastrale”.

Nga ky fond, shuma prej 600,622,492 lekë iu transferua QKD-së për vijimësinë e zbatimit të projektit, ndërsa fondi prej 142,910,346 lekë u administrua nga Drejtoria e Përgjithshme, duke përfshirë edhe financimin e realizuar për QKD-në gjatë periudhës korrik–dhjetor 2024. Brenda muajit dhjetor 2025 përfundoi procesi i skanimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe deri në fund të muajit qershor 2026 po punohet për përfundimin e digjitalizimit të kartelave të pasurive të paluajtshme.

Fondi i mbetur në fund të vitit 2025, në vlerën 833,796,000 lekë, është planifikuar të përdoret për përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme deri në qershor 2026, në kuadër të një prej objektivave kryesore të ASHK-së. Gjatë vitit 2025, nga ky fond janë angazhuar rreth 430,000,000 lekë nëpërmjet procedurave të prokurimit për realizimin e regjistrimit fillestar në

106 zona kadastrale, ndërsa pjesa e mbetur, rreth 400,000,000 lekë, parashikohet të përdoret gjatë vitit 2026.

Në tërësi, menaxhimi i fondeve ka qenë i orientuar drejt përdorimit eficient dhe të kontrolluar të burimeve financiare, duke garantuar vijimësinë e projekteve strategjike dhe arritjen graduale të objektivave të përcaktuara.

Financimi i projektit të digjitalizimit të të dhënave kadastrale dhe regjistrimit fillestar, është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e brendshme të institucionit, duke siguruar progres të qëndrueshëm ndër vite.

Përmbledhja analitike e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit për Projektin e digjitalizimit dhe regjistrimit fillestar:

	<i>Në lekë</i>
Grand qeveritar për projektin e digjitalizimit QKD 2022	652,000,000
Shpenzime paga, sig, operative viti 2022	92,303,061
Blerje pajisje dhe orendi viti 2022	42,538,199
<b>Gjendja në fund te vitit 2022</b>	<b>517,158,740</b>
Shpenzime paga, sig, operative viti 2023	227,147,499
Blerje pajisje dhe orendi viti 2023	4,161,000
<b>Gjendja në fund të vitit 2023</b>	<b>285,850,240</b>
Financim nga ASHK gjatë vitit 2024	142,910,346
Shpenzime paga, sig, operative viti 2024	413,125,745
Blerje pajisje dhe orendi viti 2024	5,694,000
<b>Gjendja në fund të vitit 2024</b>	<b>9,940,841</b>
Grand qeveritar për projektin e digjitalizimit dhe regjistrimit fillestar viti 2025	1,577,328,838
Kthim borxhi te ASHK VITI 2025	142,910,344
Fond për Projektin e regjistrimit Fillestar për 106 ZK	833,796,000
Shpenzime paga, sig, operative viti 2025 për projektin e skanimit dhe digjitalizimit QKD	424,174,022
<b>Gjendja në fund të vitit 2025 në QKD për përfundimin e digjitalizimit</b>	<b>186,389,313</b>

**Në përmbushje të Objektivit nr. 2** të programit buxhetor për vitin 2025, që lidhet me legalizimin e ndërtimeve informale, si dhe në zbatim të VKM nr. 435, datë 26.06.2024, “Për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave ‘Për procedurat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore”, ASHK ka intensifikuar bashkëpunimin ndërinstitucional për përshpejtimin e këtij procesi.

Në këtë kuadër, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa njësi të qeverisjes vendore, me qëllim mbështetjen e procesit përmes punësimit të stafit me kontratë, të angazhuar në trajtimin me prioritet dhe përfundimin e procedurave të legalizimit në zonat me zhvillim urban prioritar, si dhe në zonat informale me një numër të konsiderueshëm ndërtimesh pa leje.

Për realizimin e këtij objekti, është siguruar financim nga Bashkitë Durrës, Vlorë, Selenicë dhe Vau i Dejës, duke kontribuar drejtpërdrejt në përshpejtimin dhe përfundimin e procesit të legalizimit në këto territore.

Përmbledhje analitike e përdorimit të fondeve të Bashkisë për procesin e legalizimit të ndërtimeve informale:

*Në lekë*

EMËRTIMI	Numri i punonjësve	Transferuar Fonde 2024	Shpenzime 2024	Gjendje Dhjetor 2024	Transferuar Fonde 2025	Shpenzime 2025	Gjendje Dhjetor 2025
Bashkinë Vlorë	6	1,940,954	289,802	1,651,152	8,472,863	9,802,679	321,336
Bashkinë Selenicë	2	843,003	-	843,003	175,880	1,011,780	7,103
Bashkinë Durrës	15				21,300,000	19,956,645	1,343,355
Bashkinë Vau Dejës	2				2,454,912	638,684	1,816,228
				<b>2,494,155</b>	<b>32,403,655</b>	<b>31,409,788</b>	<b>3,488,022</b>

#### A. TË ARDHURAT E ASHK-së VITI 2025

##### Plani dhe fakti i të ardhurave të ASHK-së për vitin 2025

	Nr	Emërtimi	Buxheti Janar-Dhjetor 2025	Fakti 2025
<b>I</b>		<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>2,780,000,000</b>	<b>4,235,692,400</b>

1	Të ardhura nga shërbimet	2,230,000,000	3,560,625,376
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	350,000,000	421,976,460
3	Të ardhura të tjera	200,000,000	253,090,564

Të ardhurat totale të realizuara nga ASHK për periudhën Janar – Dhjetor 2025 arritën në vlerën 4,235,692,400 lekë, kundrejt një plani prej 2,780,000,000 lekë, duke regjistruar një nivel realizimi prej 152%. Kjo përfaqëson një tejkalim të planit me 1,455,692,400 lekë.

Në krahasim me vitin 2024, ku të ardhurat rezultuan në 3,142,592,108 lekë, gjatë vitit 2025 evidentohet një rritje prej 1,093,100,283 lekë, ose 135% e nivelit të vitit paraardhës.

Sipas zërave kryesorë, performanca paraqitet si më poshtë:

- Të ardhurat nga regjistrimi (tarifa shërbimi kadastral, kamatvonesa, 3% takse kalim pronësie, etj) u realizuan në masën 160%, me një vlerë faktike prej 3,560,625,366 lekë kundrejt planit prej 2,230,000,000 lekë.
- Të ardhurat nga legalizimi (parcelë ndërtimore 30%, tarifa shërbimi, penalitete, etj) u realizuan në nivelin 123%, me një vlerë prej 675,067,024 lekë kundrejt planit prej 550,000,000 lekë.

Në përbërje të përgjithshme të të ardhurave:

- Të ardhurat nga shërbimet zënë peshën kryesore, me 3,560,625,376 lekë të realizuara.
- Të ardhurat nga transferimi i parcelave ndërtimore arritën në 421,976,460 lekë.
- Të ardhurat e tjera u realizuan në vlerën 253,090,564 lekë.

Në tërësi, performanca financiare e vitit 2025 karakterizohet nga tejkalim i ndjeshëm i objektivave të planifikuara, si dhe një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar një ecuri pozitive në mbledhjen e të ardhurave dhe efikasitet më të lartë operacionale.

Ndërsa krahasuar me vitin 2024 të ardhurat të detajuara në muaj jane si më poshtë:

Të ardhurat e realizuara për periudhën Janar - Dhjetor 2024/ 2025 të paraqitura në mënyrë tabelare dhe grafike rezultojnë si më poshtë:


### **A.1 TË ARDHURAT NË TOTAL SIPAS MUAJVE JANAR - DHJETOR 2024/2025**

Në krahasim me vitin 2024, të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025 paraqesin një rritje të ndjeshme në pothuajse të gjithë muajt e vitit. Të dhënat mujore për periudhën Janar – Dhjetor 2024 dhe 2025, të paraqitura në mënyrë tabelare dhe grafike, evidentojnë qartë këtë tendencë pozitive.

Në total, të ardhurat janë rritur nga **3,142,592,108 lekë** në vitin 2024 në **4,235,692,390 lekë** në vitin 2025, duke shënuar një rritje prej **1,093,100,282 lekë**, ose rreth **35%** më shumë krahasuar me vitin paraardhës.

*Në /lekë*

Nr	Periudha	2024	2025
1	JANAR	224,908,172	285,490,717
2	SHKURT	172,970,744	279,518,927
3	MARS	250,450,750	357,839,613
4	PRILL	256,971,647	331,063,985
5	MAJ	378,437,738	279,813,731
6	QERSHOR	208,766,796	312,428,177
7	KORRIK	249,589,700	309,456,419
8	GUSHT	247,269,791	349,961,240
9	SHTATOR	249,955,984	401,377,578
10	TETOR	323,214,963	505,242,669
11	NËNTOR	256,175,016	386,222,068
12	DHJETOR	323,880,807	437,277,266
	<b>TOTAL</b>	<b>3,142,592,108</b>	<b>4,235,692,390</b>



Në krahasim me vitin 2024, të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025 paraqesin një rritje të ndjeshme dhe të qëndrueshme në pothuajse të gjithë muajt e vitit. Të dhënat mujore për periudhën Janar–Dhjetor evidentojnë qartë një trend pozitiv, i cili nuk kufizohet në periudha të caktuara, por shtrihet në mënyrë të njëtrajtshme gjatë gjithë vitit.

Analiza mujore konfirmon se kjo rritje nuk është rezultat i faktorëve të përkohshëm apo sezonalë, por reflekton një përmirësim të qëndrueshëm të performancës financiare. Edhe pse gjatë vitit 2025 janë miratuar ndryshime në tarifave të shërbimeve kadastrale në Vendimin nr.389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Drejtues nr.7, datë 27.08.2025 për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.15, datë 30.09.2020 të Këshillit Drejtues “Për miratimin e listës të shërbimeve kadastrale që mund të ofrohen në mënyrë të pëshpejtuar, tarifave të diferencuara dhe afateve të trajtimit”, kjo tregon se rritja e të ardhurave nuk lidhet vetëm me efektin e rritjes së tarifave, por edhe me faktorë të tjerë si rritja e volumit të shërbimeve, përmirësimi i eficiencës operacionale dhe rritja e kërkesës. Në tërësi, ecuria mujore dëshmon për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të konsoliduar financiar gjatë vitit 2025.

## A.2 TË ARDHURAT NË TOTAL SIPAS DREJTORIVE VENDORE PËR VITET 2024-2025

Analiza e të ardhurave sipas Drejtorive për periudhën 2024–2025 evidenton një performancë përgjithësisht pozitive në shumicën e strukturave, duke reflektuar rritje të konsiderueshme dhe përmirësim të efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave.

Në nivel total, të ardhurat janë rritur me rreth 35%, duke kaluar nga 3,142,592,685 lekë në vitin 2024 në 4,235,692,391 lekë në vitin 2025. Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga performanca e përmirësuar në shumicën e Drejtorive Vendore, si më poshtë:

TË ARDHURAT JANAR-DHJETOR 2024- 2025 PËR AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS SIPAS PÛRKATËSISË (REGJISTRIM+LEGALIZIM)							
NR	EMËRTIMI	Shërbime Kadastrale		Krahasimi	Proceset Kalimtare		Krahasimi
		Viti 2024	Viti 2025	në % 2025/2024	Viti 2024	Viti 2025	në % 2025/2024
1	DREJT PERGJ	57,269,983.78	33,798,273.07	59%	6,082,880	45,000	1%
2	TIRANA VERI	334,498,236.81	420,987,796.13	126%	70,401,134	53,962,701	77%
3	TIRANA JUG	274,844,418.21	320,076,032.79	116%	40,156,680	63,219,567	157%
4	TIRANA RURALE 1	184,516,746.28	267,165,957.73	145%	7,380,367	30,942,949	419%
5	TIRANA RURALE 2	150,148,262.45	204,603,518.04	136%	10,206,729	25,044,531	245%
6	DURRËS	379,047,469.00	520,392,257.00	137%	49,537,788	100,207,293	202%
7	ELBASAN	119,976,980.51	168,789,973.34	141%	17,913,767	21,180,241	118%
8	VLORË	197,958,697.72	269,667,287.11	136%	53,722,534	87,433,147	163%
9	KAMËZ -VORË	122,501,279.30	189,315,575.83	155%	40,925,457	53,334,512	130%
10	SHKODËR	91,092,294.85	140,392,028.08	154%	11,146,367	29,239,571	262%
11	FIER	105,972,840.00	152,135,471.00	144%	20,073,620	17,324,087	86%
12	KORÇË	91,408,913.77	123,156,659.70	135%	7,207,929	12,444,750	173%
13	LEZHË	106,319,773.44	189,092,971.18	178%	18,793,560	49,746,462	265%
14	BERAT	71,026,796.07	114,800,777.71	162%	4,929,010	17,489,444	355%

15	GJIROKASTËR	50,617,759.09	59,369,811.69	117%	15,944,486	11,719,243	74%
16	LUSHNJE	51,577,906.60	117,155,427.48	227%	5,207,055	9,096,146	175%
17	POGRADEC	42,521,595.43	63,195,525.09	149%	4,524,045	11,563,749	256%
18	SARANDË	106,738,256.91	128,146,953.94	120%	17,337,021	53,339,622	308%
19	DIBËR	28,230,695.85	49,395,729.00	175%	2,824,232	5,312,888	188%
20	KUKËS	22,520,719.18	28,781,216.44	128%	6,718,290	4,287,709	64%
21	ZONAT E STIMULUARA	514,777.14	206,124.00	40%	142,255,330	18,133,412	13%
	<b>TOTALI</b>	<b>2,589,304,402</b>	<b>3,560,625,366</b>		<b>553,288,282</b>	<b>675,067,024</b>	

### Të ardhurat në total Janar - Dhjetor 2024/2025 sipas Drejtorive

Nr	EMËRTIMI	Të Ardhura 2024	Të Ardhura 2025	Krahasimi në % 2025/2024
1	DREJTORIA PËRGJITHSHME	63,352,864	33,843,273	53%
2	TIRANA VERI	404,899,371	474,950,497	117%
3	TIRANA JUG	315,001,098	383,295,600	122%
4	TIRANA RURALE 1	191,897,113	298,108,907	155%
5	TIRANA RURALE 2	160,354,991	229,648,049	143%
6	DURRËS-KAVAJË-KRUJË	428,585,257	620,599,550	145%
7	ELBASAN	137,890,748	189,970,214	138%
8	VLORE	251,681,232	357,100,434	142%
9	KAMËZ -VORË	163,426,736	242,650,088	148%
10	SHKODËR	102,238,662	169,631,599	166%
11	FIER	126,046,460	169,459,558	134%
12	KORÇË	98,616,843	135,601,410	138%
13	LEZHË	125,113,334	238,839,434	191%
14	BERAT	75,955,806	132,290,222	174%
15	GJIROKASTËR	66,562,245	71,089,054	107%
16	LUSHNJE	56,784,962	126,251,573	222%
17	POGRADEC	47,045,641	74,759,274	159%
18	SARANDË	124,075,278	181,486,576	146%
19	DIBËR	31,054,928	54,708,617	176%
20	KUKËS	29,239,009	33,068,925	113%
21	ZONAT E STIMULUARA	142,770,107	18,339,536	13%

	<b>TOTALI</b>	<b>3,142,592,685</b>	<b>4,235,692,391</b>	<b>135%</b>
--	---------------	----------------------	----------------------	-------------

Ndër Drejtoritë me rritjen më të lartë relative dallohen:

- Lushnje, me një rritje prej 222%, duke shënuar performancën më të lartë në rang kombëtar,
- Lezhë, me 191%,
- Dibër, me 176%,
- Berat, me 174%.
- Shkodër, me 166%.

Një grup i dytë drejtorish me rritje të konsiderushme përfshin:

- Tiranë Rurale 1, me 155%,
- Pogradec me 159%,
- Kamëz–Vorë me 148%
- Durrës–Kavajë–Krujë me 145%,
- Sarandë me 146%,
- Vlorë 142%,
- Tiranë Rurale 2 me 143%.

Këto Drejtori kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen totale, duke reflektuar stabilitet dhe zgjerim të qëndrueshëm.

Ndërkohë, Drejtoritë kryesore urbane të Tiranës, paraqesin rritje të moderuar, por me peshë të madhe absolute në totalin e të ardhurave, duke mbetur kontribuesit kryesorë në nivel kombëtar.

- Tiranë Veri me 117% dhe
- Tiranë Jug me 122%.

Nga ana tjetër, disa Drejtori paraqesin rritje më të kufizuara:

- Gjirokastrë (107%) dhe
- Kukës (113%).

Veçanërisht, Drejtoria Zonat e Stimuluara paraqet një rënie të ndjeshme të të ardhurave me vitet e mëparshme për shkak të mos hapjes së fshatrave të rinj turistik.

Në përfundim, performanca e vitit 2025 karakterizohet nga një rritje e gjerë dhe e shpërndarë në shumicën e Drejtorive, duke reflektuar përmirësim të administrimit dhe rritje të aktivitetit ekonomik, pavarësisht disa përjashtimeve që kërkojnë vëmendje të veçantë.

## Të ardhura me paspagim

Për periudhën Maj 2020 - Dhjetor 2025 shërbime të ofruara nga ASHK për institucionet me paspagim sipas pikës 9 te vkm 389,date 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale” i ndryshuar,rezultojne si më poshtë:

Në lekë

NR	VLERA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA 2020-2025	ARKETIMET NGA INSTITUCIONET 2020-2025	DETYRIMI I INSTITUCIONEVE në fund të vitit 2025
1	265,526,790	154,406,598	111,120,192

Nga vlera e shërbimeve të ofruara institucioneve publike me paspagim ka një detyrim të palikujdur në vlerën 111,120,192 lekë ku pjesën më të madhe e zë KPK me nje vlerë të pa likujduar prej 49,959,900 leke ose 45 % të detyrimit total. Në total detyrimi i papaguar është 111.120.192 leke ose në raport me vlerën e shërbimeve të ofruara prej miratimit të VKM-së është 41.8 % dhe vlera e arkëtuar është në masën 52%.

Drejtoritë Vendore u kanë dërguar në mënyrë të vazhdueshme shkresa institucioneve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve, megjithatë, deri më tani, këto detyrime nuk janë likujduar nga një pjesë e konsiderueshme e tyre, si Gjykatat, Prokuroritë, Avokati i Shtetit, etj.

## Numri i shërbimeve nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme për periudhën Janar- Dhjetor 2025

Njësia aktuale e matjes së nivelit të punës në sistemin e regjistrimit është “shërbimi”. Në këtë kontekst një “shërbim” është çdo transaksion që ndodh në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kur kërkohet një kopje e kartelës, një kërkesë për lëshimin e certifikatës, një kërkesë për regjistrimin e një dokumenti apo kërkesa për shërbime të tjera, ndër 76 shërbimet e ndryshme që ofron ASHK. Për periudhën Janar – Dhjetor 2025 numri i shërbimeve është **1,527,330** dhe është realizuar 127% krahasuar me planin, ose 327,330 shërbime më shume dhe 119 % krahasuar me vitin 2024. Në mënyrë tabelare paraqitet si më poshtë:

Numri i shërbimeve të arkëtuara në ASHK , Janar - Dhjetor 2025		
	Plani	Fakti
<b>Totali</b>	<b>1,200,000</b>	<b>1,527,330</b>

Numri i shërbimeve të arkëtuara në ASHK , Janar - Dhjetor 2024/2025	
Fakti 2024	Fakti 2025

<b>Totali</b>	<b>1,274,933</b>	<b>1,527,330</b>
---------------	------------------	------------------

## B. SHPENZIMET E ASHK-së VITI 2025

Në mbështetje të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, Urdhërit nr.147, datë 1.08.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës “, si dhe në zbatim të Udhëzimeve “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, njësitë shpenzuese të Institucionit tonë (DP dhe DV) vazhdojnë veprimtarinë e tyre në bazë të të ardhurave të realizuara ku kryejnë shpenzimet për paga sigurime shoqerore, mallra, shërbime dhe investime sipas buxhetit të disponueshëm të planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2025

**Shpenzimet e ASHK-se** për çdo njësi shpenzuese janë ekzekutuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.82, datë 05.02.2025 “ Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2025” shkresës me nr.2564/1 prot., datë 17.02.2025 “Dërgohet detajimi i buxhetit për vitin 2025” nga ana e Drejtorisë së Financës, ku është kryer detajimi i fondeve buxhetore (Nga të ardhurat e veta dhe financimeve nga buxheti i shtetit) dhe detajimi i limiteve mujore për Drejtoritë e varësisë të ASHK-s, Urdhërit nr.147, datë 1.08.2024 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës , si dhe ndryshimeve në nivelin e pagave, etj.

**Realizimi i shpenzimeve në total për paga , sigurime , fond të veçantë, shpenzime operative dhe investime dhe shpenzimet për Bashkitë rezulton si më poshtë për periudhën Janar-Dhjetor 2025**

N r	Zërat e shpenzimeve	Plan	Fakt	Realizim i në %
1	Paga punonjës në strukturë	1,771,751,301	1,511,802,736	85%
2	Sig. shoq/shënd. punonjës strukturë	294,839,015	254,681,635	86%
3	Paga punonjës me kontratë	584,975,000	487,531,719	83%
4	Sig. shoq / shënd. punonjës me kontratë	97,691,000	81,126,765	83%
5	Fondi veçantë	88,587,565	28,139,549	32%
6	Shpenzime Operative	612,167,000	469,147,723	77%
7	Investime të Trupëzuara	291,882,000	72,165,315	25%
8	Investime të Patrupëzuara	95,125,795	74,028,046	78%
9	Shpenzime për Bashkitë	34,897,810	31,409,788	90%
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>3,871,916,486</b>	<b>3,010,033,276</b>	<b>78%</b>

**Shpenzimet për paga dhe sigurime** janë realizuar në masën 85%. Në realizimin e shpenzimeve për paga në masën 85% ka ndikuar mosplotësimi i të gjithë organikës për Drejtoritë e ASHK-së. **Shpenzimet operative** janë shpërndarë për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 22 Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për periudhën Janar- Dhjetor 2025 duke u mbështetur në limitin buxhetor të planifikuar dhe nevojat që kanë këto Drejtori.

Shpenzime operative të përmbledhura

ART	EMËRTIMI	PLAN	FAKT
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	75,312,060	31,400,718
602.1	Materiale dhe shërbime speciale	4,840,000	3,342,406
602.2	Shërbime nga të tretë	291,460,800	254,384,259
602.3	Shpenzime transporti	20,781,000	4,891,106
602.4	Shpenzime udhëtimi	21,356,600	8,893,708
602.5	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	22,325,000	11,808,538
602.6	Shpenzime për qeramarrje	57,448,000	40,515,693
602.7	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	94,438,000	90,557,755
602.9	Shpenzime të tjera operative	24,205,601	23,353,540
	<b>TOTALI</b>	<b>612,167,060</b>	<b>469,147,723</b>

Në realizimin faktik të shpenzimeve operative gati 20 % të shpenzimeve operative e zë likuidimi i vendimeve gjyqësore të cilat mbahen direkt në llogaritë rrjedhëse të ASHK-së nga ana e përmblyesve gjyqësor. Gjatë vitit 2025 janë ekzekutuar vendime për dëmshpërblim pagash dhe shpenzime përmblyesore në llogaritë rrjedhëse të Drejtorisë së Përgjithshme në shumën 46,058,135 lekë. Është ekzekutuar në llogaritë e DV ASHK Kamëz-Vorë shuma 40,043,721 lekë sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr.1626, datë 27.03.2015, ndryshuar me Vendimin e apeli nr.2712, datë 16.12.2015, me palë kreditore Nazmie Brati. Gjithashtu janë ekzekutuar në llogaritë rrjedhëse të Drejtorive Vendore të ASHK-së shuma 4,455,899 lekë shpenzime përmblyesore për ekzekutimin e Vendimeve të ndryshme të Gjykatës.

Shpenzimet për të tretët që zë gati 55% të shpenzimeve operative përfshijnë shpenzime për energji, ujë, internet-intranet, ruajtje objekti, etj.

Pjesën tjetër prej 25% të shpenzimeve operative e zënë shpenzime për marrje zyrash me qira, materiale zyre, dieta, mirëmbajtje.etj.

**Shpenzime për investime të trupëzuara dhe të patrupëzuara** kanë qenë të përqëndruara në drejtim të rikonstruksionit për godinën e “Jordan Misja” Tiranë, DVASHK Vlorë dhe Kukës, si

dhe të informatizimit të sistemit të kadastrës në drejtim të mirëmbajtjeve për përmirësimin e sitemit të ASHK-se dhe përmirësimin të infrastrukturës rrjetit fizik të DP dhe DV.

**Fonde te planifikuara dhe të realizuara për investime të trupëzuara për vitin 2025**

*Në 000 Lekë*

NR	EMËRTIMI	Plan 231	Realizimi	Mosrealizim
1	Godina " Jordan Misja" kati 5+6+5% Garanci	135,322	43,757	91,565
2	Godina Vlorë ish ADISA	15,316	1,686	13,630
3	Drejtoria Vendore Kukës+5% Garanci +Kolaudim dhe Mbikqyrje	8,840	4,576	4,264
4	Drejtoria Vendore Gjirokastrë	32,404		32,404
5	Orendi	30,000		30,000
6	Blerje paisje ,server, kompjuter, printer, fotokopje	70,000	22,146	47,854
	<b>Totali</b>	<b>291,882</b>	<b>72,165</b>	<b>219,717</b>

**Fonde te planifikuara dhe të realizuara për investime të patrupëzuara për vitin 2025**

*Në 000/ lekë*

NR	EMËRTIMI	Plan 230	Realizimi	Mosrealizim
1	Përmirësim i infrastrukturës qendrore të ASHK, i rrjetit të brendshëm të ASHK dhe i rrjetit fizik të drejtorive vendore. (Mirëmbajtje)	39,512	23,048	16,464
2	Mirëmbajtje sipas kont.Përmirësimi i sistemit te ASHK	55,614	50,980	4,634
	<b>Totali</b>	<b>95,126</b>	<b>74,028</b>	<b>21,098</b>

Referuar shpenzimeve për investime të trupezuara (231) janë realizuar 24 % e tyre dhe shpenzime për investime të patrupëzuara ( 230 ) janë realizuar 78% e tyre.

Gjatë vitit 2025 përfundoi rikonstruksioni për godinën e “Jordan Misja” Tiranë, DVASHK Vlorë dhe Kukës. Kanë mbetur detyrim garancitë 5% të punimeve, të cilat do të likujdhohen gjatë vitit 2026 e në vazhdim. Kontrata për mirëmbajtjen e Sistemit të ASHK-së përfundon më datë 06.02.2026.

**TOTALI I SHPENZIMEVE DHE INVESTIMEVE SIPAS DREJTORIVE VENDORE JANAR-DHJETOR 2024 – 2025:**

NR	EMËRTIMI	Shpenzime 2024		Realizimi ne %	Shpenzime 2025		Realizimi ne %
		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1	DREJTORIA E PËRGJITHSHME	2,002,673,220	1,027,649,412	51%	1,032,681,494	653,269,447	63%
2	TIRANA VERI	145,151,124	141,647,827	98%	162,400,000	138,087,448	85%
3	TIRANA JUG	159,414,196	150,086,434	94%	162,596,000	140,988,864	87%
4	TIRANA RURALE 1	132,005,458	120,831,326	92%	140,986,000	118,075,467	84%
5	TIRANA RURALE 2	145,834,938	141,817,415	97%	152,433,000	138,225,594	91%
6	DURRËS	290,255,627	244,634,088	84%	299,342,000	236,878,430	79%
7	ELBASAN	172,566,913	165,758,534	96%	179,334,001	157,822,741	88%
8	VLOREË	139,128,298	123,212,061	89%	156,031,898	145,010,133	93%
9	KAMËZ -VORË	132,382,811	123,765,185	93%	165,227,833	152,937,724	93%
10	SHKODER	129,574,203	108,679,801	84%	154,091,912	111,408,749	72%
11	FIER	140,815,817	127,382,351	90%	155,013,000	118,148,188	76%
12	KORÇË	104,846,831	94,512,476	90%	113,612,000	87,472,770	77%
13	LEZHË	126,323,389	122,135,830	97%	132,134,000	108,534,181	82%
14	BERAT	93,923,989	81,855,784	87%	91,459,000	79,115,899	87%
15	GJIROKASTËR	85,863,088	75,854,988	88%	89,975,000	72,449,131	81%
16	LUSHNJE	76,137,864	68,018,104	89%	84,394,000	68,056,445	81%
17	POGRADEC	57,624,346	55,682,135	97%	57,779,000	52,610,204	91%
18	SARANDË	78,472,827	77,941,976	99%	97,841,000	80,809,231	83%
19	DIBËR	57,731,735	55,529,890	96%	68,874,000	57,405,440	83%

20	KUKËS	52,910,180	52,397,445	99%	64,045,000	54,436,226	85%
21	ZONAT E STIMULUARA	54,107,960	46,490,208	86%	53,031,000	43,298,943	82%
22	DREJTORIA E PRONËS SHTETËRORE	15,850,000	10,341,980	65%	72,403,000	47,325,796	65%
23	QENDRA E KADASTRËS DIGJITALE	151,366,100	149,781,663	99%	186,232,333	147,666,227	79%
	<b>TOTALI</b>	<b>4,544,960,910</b>	<b>3,366,006,914</b>	<b>74%</b>	<b>3,871,916,472</b>	<b>3,010,033,274</b>	<b>78%</b>

Analiza e shpenzimeve për periudhën Janar–Dhjetor 2024/2025 tregon ecurinë e realizimit të fondeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Vendore të ASHK-së, në funksion të përmbushjes së aktivitetit administrativ, operacional dhe investues të institucionit.

Në vitin 2025, shpenzimet totale të planifikuara rezultojnë në vlerën **3,871,916,472 lekë**, ndërsa realizimi faktik arriti në **3,010,033,274 lekë**, ose **78%** e planit vjetor. Krahasuar me vitin 2024, ku realizimi total ishte **74%**, konstatohet një përmirësim i nivelit të realizimit të buxhetit me rreth 4%.

Ulja e planit buxhetor në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 lidhet kryesisht me faktin se gjatë vitit 2024 janë planifikuar fonde më të larta investimesh, të cilat përfshinin:

- rikonstrukcionin e godinës “Jordan Misja”,
- rikonstrukcionin e DV ASHK Vlorë,
- rikonstrukcionin e DV ASHK Kukës,
- investime në infrastrukturë dhe pajisje teknologjike sipas kontratave shumëvjeçare të lidhura.

Përfundimi i pjesës më të madhe të këtyre investimeve gjatë vitit 2024 ka sjellë reduktim të planifikimit të fondeve investuese dhe si rrjedhojë ulje të totalit të planit buxhetor.

Në tërësi, gjatë vitit 2025 ASHK ka ruajtur stabilitet në menaxhimin financiar dhe ka përmirësuar nivelin e realizimit të buxhetit krahasuar me vitin paraardhës. Fondet janë orientuar kryesisht drejt:

- funksionimit normal të strukturave,
- përfundimit të investimeve infrastrukturore,
- mirëmbajtjes dhe përmirësimit të sistemeve teknologjike,
- përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe kontraktore.

Megjithëse disa Drejtori Vendore paraqesin nivele më të ulëta realizimi, në tërësi administrimi i fondeve buxhetore konsiderohet në përputhje me objektivat dhe prioritetet institucionale të vitit 2025.

## Konkluzione

1. ASHK ka realizuar në mënyrë të qëndrueshme shpenzimet për paga, sigurime.
2. Shpenzimet operative janë rritur ndjeshëm nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe detyrimeve përmbartimore.
3. Investimet infrastrukturore dhe teknologjike kanë vijuar sipas planifikimit buxhetor.
4. Krahasuar me vitin 2024, evidentohet përmirësim në realizimin total të buxhetit dhe në menaxhimin e shpenzimeve në gjithë sistemin e ASHK-së.

**C. ANALIZA E TË ARDHURAVE TË PAPËRDORURA** pas mbulimit të shpenzimeve dhe investimeve për vitet 2024–2025, sipas të dhënave si më poshtë:

NR	DREJTORITË VENDORE TË ASHK-së	E ardhur e papërdorur viti 2024	E ardhur e papërdorur viti 2025	Krahasimi 2025/2024
1	DREJT PERGJ	-964,296,548	-476,515,828	487,780,720
2	TIRANA VERI	263,251,544	336,863,050	73,611,506
3	TIRANA JUG	164,914,664	242,306,736	77,392,073
4	TIRANA RURALE 1	71,065,787	180,033,440	108,967,653
5	TIRANA RURALE 2	18,537,576	91,422,460	72,884,884
6	DURRËS	183,951,171	405,021,120	221,069,949
7	ELBASAN	-27,867,788	32,147,473	60,015,261
8	VLORË	128,469,171	220,739,044	92,269,873
9	KAMËZ -VORË	39,661,551	89,712,364	50,050,813
10	SHKODËR	-6,441,139	60,677,762	67,118,901
11	FIER	-1,335,891	51,311,371	52,647,262
12	KORÇË	4,104,367	48,128,640	44,024,273
13	LEZHË	2,977,504	130,305,254	127,327,750
14	BERAT	-5,899,979	53,174,322	59,074,301
15	GJIROKASTËR	-9,292,744	-1,360,077	7,932,667
16	LUSHNJE	-11,233,143	58,195,129	69,428,273
17	POGRADEC	-8,636,494	22,149,072	30,785,566
18	SARANDË	46,133,302	100,677,345	54,544,043
19	DIBËR	-24,474,962	-2,696,822	21,778,140
20	KUKËS	-23,158,436	-21,367,301	1,791,135
21	ZONAT E STIMULUARA	96,279,898	-24,959,408	-121,239,306
22	QENDRA DIGJITALE	-149,781,663	-147,666,228	2,115,435
23	PRONAT SHTETËRORE	-10,341,980	-47,325,796	-36,983,816
	<b>TOTALI</b>	<b>-223,414,233</b>	<b>1,400,973,123</b>	

Analiza e treguesit të të ardhurave të papërdorura për Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Vendore të ASHK-së evidenton qartë përmirësimin e situatës financiare gjatë vitit 2025, si rezultat

i rritjes së të ardhurave të realizuara, kontrollit më të mirë të shpenzimeve operative, si dhe uljes së investimeve të mëdha infrastrukturore krahasuar me 2024.

Një pjesë e konsiderueshme e Drejtorive kanë kaluar nga rezultat negativ në vitin 2024 në balancë pozitive në vitin 2025 si Elbasan, Shkodër, Fier, Berat, Lushnje, Pogradec.

Disa Drejtori vijojnë të paraqesin rezultat negativ edhe në vitin 2025, konkretisht Gjirokastër, Dibër, Kukës, Zonat e Stimuluara.

## REALIZIMI I BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2025

	Nr	Emërtimi	Buxheti Janar-Dhjetor 2025	Realizimi 2025
<b>I</b>		<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>6,111,789,000</b>	<b>7,698,281,294</b>
	1	Të ardhura nga shërbimet	2,230,000,000	3,560,625,376
	2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	350,000,000	421,976,460
	3	Të ardhura të tjera	200,000,000	253,090,564
	4	Fonde të trashëgura nga viti 2024	1,754,460,000	1,858,921,641
	5	Fonde nga Bashkia Durrës, Vlorë		26,338,615
I-1		Fonde të akordura nga buxheti i shtetit	1,577,329,000	1,577,328,638
<b>II</b>		<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>5,519,048,000</b>	<b>3,434,206,937</b>
	<b>1</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>2,837,844,000</b>	<b>2,394,692,192</b>
	1	Paga sipas organikës së miratuar (1178 punonjës)	1,771,751,000	1,511,802,736
	2	Sigurimet Shoqerore për punonjësit në organikë	294,839,000	254,681,635
	3	Paga punonjës me kontratë (480 punonjes)	584,975,500	487,531,719
	4	Sigurime Shoqërore punonjës me kontratë	97,691,500	81,126,765
	5	Shpenzime Fonde nga Bashkia Durrës, Vlorë, Selenicë, Vau i Dejës		31,409,788
	6	Fondi i veçantë	88,588,000	28,139,549

	<b>2</b>	<b>Shpenzime operative</b>	<b>612,167,000</b>	<b>469,147,723</b>
		Shpenzime për mallra dhe shërbime + QKD	612,167,000	469,147,723
	<b>3</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,964,337,000</b>	<b>570,367,022</b>
	<b>a</b>	<b>Investime kapitale të patrupëzuara</b>	<b>1,672,455,000</b>	<b>498,202,022</b>
	1	Shpenzime për investime të patrupëzura	95,126,000	74,028,000
	2	Regjistrim fillestar për 106 zk	833,796,000	0
	3	Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme	743,533,000	424,174,022
	<b>b</b>	<b>Investime kapitale të trupëzuara</b>	<b>291,882,000</b>	<b>72,165,000</b>
	1	Rikonstruksione (Drejtoritë Vendore të ASHK së Tiranë + Vlorë,etj)	191,882,000	50,019,000
	2	Blerje pajisje elektronike	70,000,000	22,146,000
	3	Orendi	30,000,000	
	<b>5</b>	<b>Fondi rezerve</b>	<b>104,700,000</b>	
		Fondi rezerve	104,700,000	0
<b>III</b>		<b>Të Ardhura (-) Shpenzime ( fonde të papërdorura)</b>	<b>592,741,000</b>	<b>4,264,074,357</b>
		Fondi i Regjistrimit Fillestar për 106 zk i papërdorur		-833,796,000
		E ardhur e papërdorur në fund të vitit 2025 Projekti QKD		-186,389,313
		E ardhur e papërdorur 2016-2024		-1,858,921,641
		Gjendja e QKD 31.12.2024 nga borxhi i marr nga ASHK		9,940,843
		Garanci 5% rikonstruksion i transferuar në Vlorë dhe Kukës		-10,492,347
		<b>E ardhur e papërdorur në fund të vitit 2025</b>	<b>592,741,000</b>	<b>1,384,415,899</b>

**E ardhur e papërdorur në ASHK gjatë vitit 2025 është 1,384,415,899 lekë. Në TOTAL e ardhura e papërdorur që trashëgohet për vitin 2026 është 3,243,337,440 lekë.**

**D. TË ARDHURAT JASHTË SISTEMIT TË ASHK-së QË DERDHEN NË BUXHETIN E SHTETIT DHE AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE**

1. Të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e shtetit si **agjent tatimor** për tatim kalimi i së drejtës së pronësisë (15%) :

*Në lekë*

Nr	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2025
1	Tatimi mbi te ardhurat nga kalimi i pronësisë 15%	<b>7,494,157,624</b>

2. Të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e pushtetit vendor si **agjent tatimor** për taksë kalimi i së drejtës së pronësisë (97%) :

*Në lekë*

Nr	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2025
1	Taksë kalim pronësie 97 %	726,328,628

3. Të ardhurat që ASHK vjel nga legalizimi për ATP (përkatësisht në masën 70% të parcelës ndërtimore dhe 50% të parcelës të Zonave Turistike)

Nr	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2025
1	Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat turistike për ATP-në	949,680,424
	Nga kjo: Transferuar në ATP	938,370,955

4. Të ardhura të likujduara për proceset e legalizimit në Bono Privatizimi

Nr	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2025
1	Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat turistike për ATP-në, në bono privatizimi	1,579.976,496

**PËRFUNDIM**

**Problematikat e evidentuara dhe të konstatuara gjatë vitit 2025:**

**1. Gjatë vitit 2025**, janë evidentuar problematika në procesin e rakordimit dhe kuadrimit të të ardhurave të gjeneruara nga sistemi i ASHK-së me të dhënat bankare dhe evidencat financiare. Këto problematika lidhen kryesisht me:

- Mos rakordime periodike ndërmjet sistemit të arkëtimeve dhe lëvizjeve bankare,
- vonesa në reflektimin e pagesave në sistem,
- mospërputhje të pagesave dhe identifikimit të transaksioneve,
- vështirësi në gjenerimin e raporteve financiare në kohë reale.

**2. Gjatë vitit 2025,** detyrimet e prapambetura nga institucionet publike për shërbimet me paspagesë, kanë një vlerë 111,120,192 lekë. Pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve i përket institucioneve si gjykatat, prokuroritë dhe institucione të tjera publike. Kjo situatë ndikon në rritjen e detyrimeve të mbartura ndër vite si dhe në uljen e të ardhurave të ASHK-së.

**3. Gjatë vitit 2025,** janë ekzekutuar vendime gjyqësore dhe shpenzime përmbartimore në vlera të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e të ardhurave të ASHK-së.

### **Rekomandimet dhe vijimësia e Planit të Punës për vitin 2026:**

**1.** Përmirësimi i sistemit financiar të ASHK-s duke forcuar bashkëpunimin me Drejtorinë e IT dhe kompaninë që realizon mirëmbajtjen e sistemit të ASHK-së për përmirësimin e moduleve financiare dhe eliminimin e problematikave të rakordimit të të ardhurave.

**2.** Të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar dhe të përmirësohet monitorimi periodik i realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.** Forcimi i mbledhjes së detyrimeve të prapambetura nga institucionet me paspagim.

**4.** Të vijojë investimi në infrastrukturën teknologjike dhe sigurinë e sistemeve të informacionit.

**5.** Të përfundojë procesi i digjitalizimit të kartelave të pasurive të paluajtshme brenda afateve të planifikuara.

**6.** Të vijojë procesi i regjistrimit fillestar për zonat kadastrale të planifikuara.

**7.** Të vijojë procesi i legalizimit në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.

**8.** Të përmirësohet organizimi i proceseve të punës për rritjen e eficiencës operacionale.

## **VIII. APELIMI DHE BASHKËQEVERISJA**

Drejtoria e Apelimit dhe e Bashkëqeverisjes, ushtron funksione për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të paraqitura nga subjektet (qytetarë dhe institucione), lidhur me veprimet ose mosveprimet e ASHK-së, duke vepruar nëpërmjet dy linjave kryesore të ndërveprimit: mekanizmit

të apelimit administrativ nga Sektori i Apelimit dhe platformës së bashkëqeverisjes nga Sektori i Bashkëqeverisjes.

Sektori i Apelimit shqyrton dhe trajton kërkesat dhe ankesat që plotësojnë kushtet që cilësohen si ankime administrative sipas parashikimeve të nenit 130 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me vendimet, veprimet, mosveprimet e drejtorive vendore të ASHK, duke ushtruar kontrollin administrativ të akteve, veprimeve dhe mosveprimeve të drejtorive vendore në zbatim të detyrimeve dhe objektivit të veprimtarisë të përcaktuara në ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

### ➤ **KORESPODENCA E ADMINISTRUAR**

Në bazë të të dhënave që administron Sektori i Apelimit, gjatë vitit 2025, janë administruar **1075** shkresa:

867 kërkesë/ ankesa nga subjektet (qytetarë, avokatw/përfaqësues ligjorë, noter, banka, etj)  
208 janë shkresa vënie në dijeni/ njoftime.

#### **Tematika e kërkesave/ ankesave.**

Përmbajtja tematike e kërkesave dhe ankesave të paraqitura për trajtim përfshin:

- 415 raste me objekt procesin e legalizimit,
- 66 raste me objekt kalim pronësie VKM nr. 827/2020;
- 386 raste që kanë të bëjnë me regjistrimin e titujve të pronësisë, si (akte administrative, vendime gjyqësore, akte noteriale, etj.

### **TRAJTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESW/ANKESAVE**

Nga totali i shkresave të administruara janë përpunuar dhe trajtuar **942 raste**, në formatet e mëposhtme:

#### **1. Shqyrtim administrativ dhe vendimmarrje:**

- 23 raste janë shqyrtuar në mënyrë të plotë në aspektin e ankimit administrativ.  
Nga të cilat 20 raste janë me vendim **rrëzim/ refuzim** të ankimit dhe 3 raste janë **mospranim i ankimit**.

#### **2. Veprime të tjera procedurale:**

- 181 raste: kthim përgjigje shteruese për subjektet, me udhëzime dhe orientim të qartë ligjor.
- 266 raste: delegim për kompetencë në drejtorinë vendore përkatëse, me udhëzim dhe orientim të qartë ligjor për zgjidhjen e ankimit;

- 171 raste: kërkesë për informacion/dokumentacion të nevojshëm për shqyrtimin administrativ;
- 94 raste: kthim ankimi për plotësim të ankesës nga subjekti;
- 14 raste: tërheqje vëmendje për mosveprim ose vonesa në përgjigje nga drejtoritë vendore.

### 3. Shkresa të tjera të administruara:

- Shkresa të arkivuara për shkak të trajtimit të përfunduar nga drejtoritë vendore nëpërmjet aplikimeve të subjekteve;
- Shkresa për dijeni në lidhje me vendimmarrjet dhe njoftim;
- Shkresa të trajtuara në vitin pasardhës (Janar – Shkurt 2026)

## SHPËRNDARJA E ANKESAVE SIPAS DREJTORIVE VENDORE

Tabela e mëposhtme paraqet ndarjen e ankesave sipas drejtorive vendore të ASHK.

Drejtoria vendore	Nr. ankesave
Tiranë Jug	66
Tiranë Veri	98
Vlorë	128
Sarandë	82
Berat	28
Shkodër	36
Durrës	67
Korçë	40
Fier	26
Kamëz - Vorë	42
Gjirokastër	45
Tirana Rurale 1	49
Tirana Rurale 2	31
Elbasan	15
Lushnje	16
Kukës	28
Lezhë	25
Pogradec	10
Dibër	12
QKD	5
Të tjera Drejtori brenda DP	pjesa e mbetur

## PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA GJATË VITIT 2025

Gjatë analizës së praktikave të trajtuara, janë konstatuar problematika të përsëritura në lidhje me performancën dhe korrespondencën e drejtorive vendore si:

- **Mosrespektim i afateve të kthimit të përgjigjeve** nga drejtoritë vendore, përkundrejt kërkesave për informacion/dokumentacion të Sektorit të Apelimit;
- **Përgjigje të paplota**, të paargumentuara ligjërisht dhe pa dokumentacionin përkatës;
- **Moszbatim** të akteve ligjore e nënligjore në trajtimin e aplikimeve.

## **REKOMANDIME PËR PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA**

- Përmirësimi i qarkullimit të informacionit dhe dokumentacionit ndërmjet nivelit qendror dhe drejtorive vendore.
- Krijimi i një sistemi monitorimi për ndjekjen e respektimit të afateve në kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes.
- Krijimi dhe hartimi i mekanizmave të brendshëm monitorues për zbatimin në kohë dhe me korrektësi të rekomandimeve të Drejtorisë së të Apelimit dhe Bashkëqeverisjes.
- Në rastet e përsëritura të mosveprimit nga drejtoritë vendore, të merren masa administrative në përputhje me nenin 64 të ligjit 111/2018 “Për kadastrën” si dhe me aktet e tjera ligjore në zbatim.
- Në rastet kur paraqitet e nevojshme, të ngrihen grupe pune të posaçme për sigurimin dhe administrimin e dokumentacionit pranë drejtorive vendore nga Sektori i Apelimit.
- Rritja e bashkëpunimit institucional ndërmjet Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes dhe drejtorive vendore, përmes organizimit të trajnimeve periodike dhe shkëmbimit të praktikave më të mira profesionale.
- Rishikimi i strukturës organizative të brendshme, me fokus në forcimin e kapaciteteve njerëzore, rritjen e stafit specialist dhe zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale.
- Digjitalizimi i proceseve të administrimit dhe ndjekjes së ankesave, me qëllim rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe reduktimin e vonesave procedurale.
- Rritja e informimit të qytetarëve mbi procedurat e ankimit dhe të drejtat e tyre, përmes publikimit të udhëzuesve informues dhe ofrimit të asistencës administrative më të aksesueshme.

Në referencë me rolin kyç që ka kjo drejtori në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e shërbimeve publike, ajo përballlet me sfida të rëndësishme që lidhen me mungesën e standardizimit të procedurave, duke lënë hapësira për trajtim të ndryshëm të rasteve të ngjashme.

Gjithashtu, evidentohen mangësi në mekanizmat e informimit të qytetarëve mbi të drejtën e ankimit, përfshirë edhe rastet e mosmarrëveshjeve civile. Në këtë kuadër sektori i apelimit luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e informacionit korrekt, të paanshëm dhe të standardizuar për qytetarët, duke i orientuar ata drejt alterantivave ligjore për zgjidhjen e çështjeve pranë organeve kompetente.

**Misioni i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes:**

1. Trajtimi në përputhje me ligjin material dhe atë procedural, brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.A, ankesat e paraqitura nga qytetarët apo institucionet shtetërore, lidhur me veprimet ose mosveprimet e kryera nga Drejtoritë/Zyrat vendore të ASHK në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 20/2020 “Për proceset kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

2. Procesimi nga sistemi i menaxhimit të ankesave, ankesat e regjistruara nga qytetarët në faqen <https://www.shqipëriaqeduam.al> dhe të gjitha rastet për kategoritë e paraqitura në platformën e bashkëqeverisjes, në përputhje me ligjin nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen”;

### **Sektori i Bashkëqeverisjes:**

Objektivi i Sektorit: Procesimi nga Sistemi i Menaxhimit të Ankesave, ankesat e regjistruara nga qytetarët dhe bizneset në faqen <https://www.shqipëriaqeduam.al> dhe sigurimi i menaxhimit në kohë, në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi brenda afateve dhe me përgjegjshmëri të të gjitha rasteve të ardhura nga platforma, adresimin dhe zgjidhjen e problematikave.

- **Viti 2025**

Rezulton se për vitin 2025 janë regjistruar 7580 ankesa në Platformën e Bashkëqeverisjes nga individë dhe 79 ankesa nga biznese, të cilat janë deleguar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje në 18 Drejtoritë Vendore të ASHK-së, 3 Zyrat Vendore të ASHK-së, Drejtorinë e Zonave të Stimuluara, Qendrën e Kadastrës Digjitale dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.

Për kategorinë e ankesave individ janë përfunduar 6563 ankesa dhe zgjidhur 1358 ankesa. Ndërkohë 1017 ankesa vijuan trajtimin në muajin Janar 2026.

Për kategorinë e ankesave biznes janë përfunduar 73 ankesa dhe zgjidhur 25 ankesa.

Në total për kategoritë (individ dhe biznes) çështje të përfunduara për vitin 2025 janë 6636 ankesa.

Në total (individ dhe biznes) çështje të zgjidhura për vitin 2025 janë 1383 ankesa.

Çështjet e zgjidhura sipas tipologjisë, më kryesoret ndahen si më poshtë: Çertifikatë pronësie-506, Legalizim - 301, Vërtetim pozitiv/negativ - 97; Informacion kadastral - 95; PAGESA kadastrale – 56; Oborre në përdorim – 49; Korrigjim dokumentacioni – 41; Kartelë pasurie, Hartë treguese – 37; Dokumentacion kadastral – 36; Regjistrimi i kontratave – 35; Akt trashëgimie – 30; Regjistrim fillestar – 18, Tokë Bujqësore – 12.

Çështje të reja të regjistruara gjatë vitit 2025 janë 6701, nga të cilat 6631 ankesa nga individë janë 6631 dhe 70 ankesa nga biznes.

Raste suksesi për vitin 2025 janë 532 në total, nga të cilat 520 raste suksesi për ankesat e individëve dhe 12 raste suksesi për ankesat e biznesit. Nga totali 532 ankesa, të ndara sipas

drejtorive vendore rastet e suksesit janë: DV ASHK Durrës-Kavajë-Krujë - 87 raste sukseesi; DV ASHK Fier-Mallakastër - 63 raste sukseesi, DV ASHK Kamëz-Vorë - 51 raste sukseesi; DV ASHK Rurale 1 - 45 raste sukseesi; Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së - 47 raste sukseesi; DV ASHK Shkodër-Pukë – 38 raste sukseesi; DV ASHK Tirana Veri - 28 raste sukseesi; DV ASHK Tirana Jug - 25 raste sukseesi, DV ASHK Berat – 22 raste sukseesi; DV ASHK Rurale 2 - 19 raste sukseesi; DV ASHK Vlorë -19 raste sukseesi.

Gjithashtu, për vitin 2025, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së janë trajtuar rreth 600 ankesa në ndërveprim me Drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së (ankesa të ardhura në formë shkresore) si dhe me Drejtoritë vendore të ASHK-së nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të lidhura me: mosmarrje shërbimesh kadastrale, kërkesa për kompensim financiar, ankesa për procesin e legalizimit, ankime administrative, Vërtetim pozitiv/negativ për pasuri të paluajtshme, regjistrim fillestar etj. Në formë shkresore pranë Sektorit të Bashkëqeverisjes janë administruar 27 ankesa të lidhura kryesisht me mos marrje shërbimesh kadastrale nga drejtoritë vendore të ASHK-së.

#### **Ecuria përgjatë vitit 2025 dhe masat e marra:**

- **Ndjekja e ankesave që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së si dhe ndjekja e ankesave të adresuara Drejtorive Vendore të ASHK-së** nëpërmjet komunikimeve javore menjëherë me dërgimin e raportit përmbledhës të ankesave që i adresohen platformës së Bashkëqeverisjes nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje në drejtim të ASHK-së. Komunikimet janë mbajtur me Drejtorët e Drejtorive dhe me pikat e kontaktit të bashkëqeverisjes së këtyre drejtorive. Ky proces është monitoruar në vazhdimësi nga ana e sektorit të bashkëqeverisjes çdo javë dhe sa herë ka lindur nevoja për komunikim me Drejtoritë vendore në varësi të ankesave të qytetarëve dhe bizneseve.
- **Spektori i Bashkëqeverisjes në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së/ ka luajtur një rol rregullator dhe ndërmjetës midis Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Drejtorive Vendore të ASHK-së** për t'i dhënë zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi çdo ankese/çështje që është adresuar në platformën e bashkëqeverisjes.
- **Në bashkëpunim me koordinatorët e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje** në Kryeministri janë zhvilluar takime në vijimësi (Korrik/Shtator 2025 me Drejtoritë vendore të ASHK-së Vlorë, Shkodër, Durrës-Kavajë Krujë, Tirana Veri, Rurale 1, Rurale 2 dhe Kamëz -Vorë, Drejtorët Vendore të ASHK-së dhe pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes lidhur me ecurinë e trajtimit të ankesave të Platformës së Bashkëqeverisjes me fokus në kthimin e përgjigjeve bazuar në ligj ankuesve, përgjigje shteruese për ankesat dhe përgjigje cilësore dhe fokus tek ecuria e procesit të legalizimeve për ankesat e regjistruara në Platformë që i përkasin periudhës së vetëdeklarimit 2005-2006.

#### **Tipologjia e ankesave:**

Ankesat e regjistruara në Platformën e Bashkëqeverisjes, kryesisht lidhen me:

- 1. Shërbime kadastrale** ku përfshihen (aplikime për pajisje me Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese; Vërtetim pozitiv/negativ për pasuri të paluajtshme; aplikim për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore; kërkesë për informacion/dokumentacion; regjistrimi i kontratave; regjistrim i vendimeve të legalizimeve dhe oborreve në përdorim; kërkesa për korrigjim dokumentacioni; regjistrim akti trashëgimie; informacion kadastral; regjistrim i tokave bujqësore; regjistrim fillestar, regjistrim i titujve të tjerë).
- 2. Procesin e legalizimit të objekteve/ndërtimeve informale**, ankesa të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të ankesave të regjistruara në Platformën e Bashkëqeverisjes. Për mbylljen e procedurave të Legalizimeve për ato vetëdeklarime që i përkasin periudhës 2005-2006, janë ndjekur rekomandimet e dhëna në shkresën unifikuese të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, ku citohet se duhet të kenë prioritet vetëdeklarimet/aplikimet për Legalizim që i përkasin viteve 2005-2006. Duke marrë parasysh këtë shkresë, janë udhëzuar Drejtoritë Vendore të ASHK-së për të vijuar punën që nga nxjerrja e urdhrin të punës, verifikimi në terren (matjet në terren) e deri në përmbjlljen e procesit të legalizimit i cili konsiderohet i finalizuar me nxjerrjen e vendimit të Drejtorisë përkatëse për legalizimin e ndërtimit informal në rastet kur plotësohen kriteret e Ligjit Nr.20/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- 3. Regjistrimin e titujve të tjerë që buron nga legjislacioni për çështjet e pronësisë)** Ndërtimet e legalizuara mbi truall në pronësi të të tretëve regjistrohen pa marrëdhënie me truallin, deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për **kompensimin e pronarëve joposedues**, sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin për çështjet e pronësisë. Me miratimin e këtij vendimi, parcela ndërtimore regjistrohet në favor të përfituesit të pasurisë së legalizuar.

Rekomandimet dhe vijimësia e Planit të Punës për vitin 2026:

- Sipas Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm “Për ngritjen dhe organizimin e Njesisë së Trajnimeve në ASHK”, Rregullores “Mbi funksionimin e Njesisë së Trajnimeve..” , në vijueshmëri të kërkesave dhe nevojave të kohës me qëllim rritjen e performancës së punonjësve të ASHK-së dhe unifikimit të procesit të trajnimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë, është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së Urdhri Nr. 1858 datë 31.12.2025 “Programi dhe kalendar i trajnimit për ASHK për vitin 2026” dhe janë ngarkuar për zbatimin e tij të gjitha drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, Drejtoritë vendore të saj, trajnerët e brendshëm si dhe pjesëmarrësist në trajnime. Për Drejtorinë e Apelit dhe Bashkëqeverisjes/stafi i Sektorit të Bashkëqeverisjes do të trajnojnë në muajin Tetor 2026 pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes në 18 Drejtoritë Vendore të ASHK-së, 3 Zyra Vendore të ASHK-së, Drejtoria Zonat e Stimuluara dhe Qendra e Kadastrës Digjitale.

**Temat e trajnimit Tetor 2026:** Trajnimi i pikave të kontaktit të Bashkëqeverisjes pranë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:

- o Ndjekja e ecurisë së trajtimit të ankesave të adresuara Drejtorive Vendore të ASHK-së nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes “Me ty për Shqipërinë që duam” nga qytetarët dhe bizneset me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve, rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së drejtorive vendore të ASHK-së.
- o Koordinimi dhe bashkërendimi i punës dhe korrespondencës midis drejtorive vendore /Pikave të Kontaktit të Bashkëqeverisjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së si dhe Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) në Kryeministri, me qëllim zgjidhjen në kohë të problematikave të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes.
- o Udhëzime mbi mënyrën e trajtimit/shqyrtimit të ankesave, për të konkluduar me përgjigje ezauruese/shteruese, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për Kadastrën dhe Proceset Kalimtare të Pronësisë.

**Më poshtë në mënyrë të detajuar gjendet përmbledhje vjetore dhe progresive e ankesave për vitin 2025:**

**RAPORTIMI VJETOR  
PLATFORMA ‘SHQIPËRIA QË DUAM’  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
PËRMBLEDHJE VJETORE DHE PROGRESIVE E ÇËSHTJEVE  
ANKESA IME 2025**

MINISTRI QYTETARË	Total vjetor akumulativ	Çështje në Platformë e Proces		Çështje Protokoll i Proces		Çështje vjetore në proces Platformë dhe Protokoll në total			Total vjetor për çështjet e përfunduara		Total progresiv për çështjet e përfunduara	
		Afat	Jashtë Afatit	Afat	Jashtë Afatit	Afat	Jashtë Afatit	Proçes total	Zgjidhur	Përfunduar	Zgjidhur	Përfunduar
Kryeministria\ Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	7,580	94	828	9	86	103	914	1,017	1,358	6,563	9,476	42,917

**BIZNESI IM**

BASHKËQEVERISJA ME BIZNESE	Total vjetor akumul ativ	Çështje në Platform ë Proçes		Çështje Protokoll i Proçes		Çështje vjetore në proçes Platformë dhe Protokoll në total			Total vjetor për çështjet e përfunduara		Total progresiv për çështjet e përfunduara	
		Af at	Jas htë Afa tit	Af at	Jas htë Afa tit	Af at	Jas htë Afa tit	Proç es total	Zgjid hur	Përfund uar	Zgjid hur	Përfundu ar
<b>Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)</b>												
Ankesa	77	1	2	0	2	1	4	5	25	72	210	705
Kërkesa	2	0	0	0	1	0	1	1	0	1	49	169
<b>TOTAL ÇËSHTJE</b>	<b>79</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>73</b>	<b>259</b>	<b>874</b>

#### ÇËSHTJET E REJA GJATË VITIT SIPAS INSTITUCIONEVE

Ministritë	Drejtoritë dhe Institucionet e varësisë	Qytetarë	Biznese	Numri i Çështjeve
Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	ASHK Pogradec	41	0	41
	ASHK Kavajë	4	0	4
	ASHK Mat	20	0	20
	ASHK Devoll	2	0	2
	ASHK Malësi e Madhe	10	0	10
	ASHK Berat	10	0	10
	ASHK Bulqizë	8	0	8
	ASHK Dibër	40	0	40
	ASHK Durrës	22	0	22
	ASHK Elbasan	16	0	16
	ASHK Fier	14	0	14
	ASHK Gjirokastër	5	0	5
	ASHK Kamëz – Vorë	367	6	373
	ASHK Korçë	5	0	5
	ASHK Krujë	1	0	1
	ASHK Kuçovë	3	0	3
	ASHK Lezhë	4	0	4
	ASHK Lushnje	70	0	70
	ASHK Mirdite	1	0	1
	ASHK Sarandë	184	1	185
	ASHK Shkodër	24	1	25
	ASHK Tepelene	1	0	1
	ASHK Tirana Jug	287	7	294
	ASHK Tirana Rurale 1	327	2	329
ASHK Tirana Rurale 2	348	8	356	
ASHK Tirana Veri	567	5	572	
ASHK Vlorë	778	6	784	

	ASHK Zonat e Stimuluara	24	4	28
	Drejtoria Qëndrore e ASHK	332	5	337
	Qendra e Kadastrës Digjitale	62	0	62
	Delegat-Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	109	0	109
	Koordinator-Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	96	3	99
	ASHK Durrës-Kavajë-Krujë	674	9	683
	ASHK Elbasan-Librazhd-Gramsh-Peqin	190	4	194
	ASHK Gjirokastrë-Tepelenë-Përmet	167	2	169
	ASHK Lezhë-Mirditë-Kurbin	90	2	92
	ASHK Korçë-Devoll-Kolonjë	179	0	179
	ASHK Berat-Kuçovë-Skrapar	216	0	216
	ASHK Fier-Mallakastër	766	1	767
	ASHK Shkodër-Pukë	475	4	479
	ASHK Kukës-Has-Tropojë	25	0	25
	Pa institucion	67	0	67
<b>Totali</b>		<b>6,631</b>	<b>70</b>	<b>6,701</b>

## ÇËSHTJE TË ZGJIDHURA GJATË VITIT SIPAS TIPOLOGJISË

Ministria	TIPOLOGJITË e çështjeve të zgjidhura	Qytetarë	Biznese	Numri i Çështjeve
Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	Denoncim	2	0	2
	Oborre në përdorim	49	0	49
	Regjistrimi i Kontratave	34	1	35
	Regjistrim/fshirje inskripti	15	1	16
	Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme	96	1	97
	Legalizim	296	5	301
	Çertifikatë pronësie	500	6	506
	Akt administrativ/gjyqësor	7	1	8
	Akt trashëgimie	30	0	30
	Ankim administrativ / apelim	3	0	3
	Aplikim online AV0(zero)	7	1	8
	Dokumentacion kadastral	34	2	36
	Kartele pasurie, Harte treguese	37	0	37
	Informacion kadastral	93	2	95
	Kartelë pasurie	28	1	29
	Korrigjim dokumentacioni	41	0	41
	Pagesa kadastrale	56	0	56
	Regjistrim fillestar	18	0	18
	Shërbimi kadastral	0	4	4
	Toka bujqësore	12	0	12
<b>TOTAL</b>		<b>1,358</b>	<b>25</b>	<b>1,383</b>

## RASTE SUKSESI NE TOTAL

MINISTRIA	INSTITUCIONI	RASTE SUKSESI VJETOR		Total Viti	RASTE SUKSESI PROGRESIV		Total	TIPOLOGJIA
		Qytetare	Biznes		Qytetare	Biznes		
Kryeministria\ Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)	ASHK Pogradec	2	0	2	10	0	10	Regjistrimi i Kontratave, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese, Legalizim, Çertifikatë pronësie
	ASHK Kavajë	1	0	1	16	0	16	Regjistrim/fshirje inskripti, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Legalizim, Çertifikatë pronësie, Aplikime për procedurat e legalizimit
	ASHK Mat	0	0	0	2	0	2	Aplikime për procedurat e legalizimit, Kërkesë për pajisje me çertifikatë pronësie
	ASHK Pukë	0	0	0	1	0	1	Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese
	ASHK Devoll	0	0	0	1	0	1	Oborre në përdorim
	ASHK Librazhd	0	0	0	1	0	1	Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese
	ASHK Malësi e Madhe	2	0	2	2	0	2	Kartele pasurie, Harte treguese
	ASHK Tropoje	0	0	0	1	0	1	Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese
	ASHK Berat	1	0	1	19	0	19	Regjistrim i tokave bujqësore, Regjistrim/fshirje inskripti, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Legalizim, Certificate
	ASHK Dibër	5	0	5	8	0	8	Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Legalizim, Kartelë pasurie, Korrigjim dokumentacioni
ASHK Durrës	3	0	3	75	4	79	Regjistrimi i Kontratave, Regjistrim/fshirje	

								inskripti, Mos shfaqje dokumentacioni ASHK në rubrikën dokumentet e mia, shërbimi E-Albania, Akt trashëgimie, Certificate
<b>ASHK Elbasan</b>	1	0	1	54	2	56	Informacion, Regjistrim i lejeve të ndërtimit, Regjistrimi i Kontratave, Rivlerësim Pasurie, Regjistrim i aktit të trashëgimisë	
<b>ASHK Fier</b>	5	0	5	91	3	94	Fatura e pagesës, Problematikë me aplikimin AV0(zero), shërbimi E-Albania, Leje legalizimi, Regjistrimi i Kontratave, Regjistrim/fshirje inskripti	
<b>ASHK Gjirokastrë</b>	1	0	1	7	0	7	Regjistrim fillestar, Çertifikatë pronësie, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese	
<b>ASHK Kamëz – Vorë</b>	51	0	51	184	6	190	Leje legalizimi, Regjistrimi i Kontratave, Mungesë shërbimi, Rivlerësim Pasurie, Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore	
<b>ASHK Korçë</b>	0	0	0	12	2	14	Oborre në përdorim, Regjistrim/fshirje inskripti, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Informacion kadastral, Çertifikatë pronësie	
<b>ASHK Krujë</b>	0	0	0	8	0	8	Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese	
<b>ASHK Kuçovë</b>	0	0	0	2	1	3	Regjistrim fillestar, Regjistrimi i Kontratave	
<b>ASHK Kukës</b>	0	0	0	3	0	3	Oborre në përdorim, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese	
<b>ASHK Lezhë</b>	0	0	0	10	1	11	Legalizim, Aplikime për regjistrim të	

								akteve administrative/gjyqësore, Kartelë pasurie, Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese
	<b>ASHK Lushnje</b>	9	0	9	44	0	44	Regjistrim i tokave bujqësore, Leje ndërtimi, Regjistrim i aktit të trashëgimisë, Akt administrativ/gjyqësor, Informacion kadastral
	<b>ASHK Mirdite</b>	0	0	0	3	0	3	E-albania, Çertifikatë pronësie
	<b>ASHK Sarandë</b>	14	0	14	39	0	39	Regjistrimi i Kontratave, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Certifikate, Aplikime për procedurat e legalizimit
	<b>ASHK Shkodër</b>	1	0	1	43	2	45	Oborre në përdorim, Regjistrimi i Kontratave, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Certifikate
	<b>ASHK Tepelene</b>	0	0	0	10	0	10	Çertifikatë pronësie, Regjistrimi i Kontratave, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese
	<b>ASHK Tirana Jug</b>	23	2	25	121	8	129	Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore, Kërkesë për korrigjim dokumentacioni, Certifikate, Akt administrativ/gjyqësor, Karte pasurie, Hartë treguese
	<b>ASHK Tirana Rurale 1</b>	44	1	45	115	3	118	Oborre në përdorim, Leje legalizimi, Kërkesë për korrigjim dokumentacioni, Korrigjim dokumentacioni,

								Regjistrim fillestar
<b>ASHK Tirana Rurale 2</b>	18	1	19	112	5	117	Leje legalizimi, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Korrigjim dokumentacioni, Regjistrim fillestar	
<b>ASHK Tirana Veri</b>	27	1	28	154	10	164	Denoncim, Regjistrim i aktit të trashëgimisë, Akt trashëgimie, Informacion kadastral, Regjistrim fillestar	
<b>ASHK Vlorë</b>	18	1	19	84	4	88	Regjistrime Fillestare, Regjistrim/fshirje inskripti, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Aplikim Oborre në përdorim, Aplikim online AV0(zero)	
<b>ASHK Zonat e Stimuluara</b>	3	1	4	5	1	6	Aplikim Ndërtim pa leje, Informacion kadastral, Legalizim	
<b>Drejtoria Qëndrore e ASHK</b>	35	1	36	100	9	109	Ankim administrativ / apelim, Kërkesë për Legalizim të Objektit, Regjistrimi i Kontratave, Informacion kadastral, Shërbimi kadastral	
<b>Koordinator-Kryeministria\ Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)</b>	11	0	11	11	0	11	Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Informacion kadastral, Pagesa kadastrale, Çertifikatë pronësie, Legalizim	
<b>ASHK Durrës-Kavajë-Krujë</b>	86	1	87	116	1	117	Regjistrim/fshirje inskripti, Akt trashëgimie, Aplikim online AV0(zero), Dokumentacion kadastral, Kartelet pasurie, Harte treguese	
<b>ASHK Elbasan-Librazhd-Gramsh-Peqin</b>	12	0	12	23	0	23	Akt trashëgimie, Aplikim online AV0(zero), Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Legalizim,	

								Çertifikatë pronësie
	<b>ASHK Gjirokastrë-Tepelenë-Përmet</b>	4	1	5	9	1	10	Regjistrimi i Kontratave, Akt trashëgimie, Karteles pasurie, Harte treguese, Korrigjim dokumentacioni, Shërbimi kadastral
	<b>ASHK Lezhë-Mirditë-Kurbin</b>	7	2	9	11	2	13	Akt trashëgimie, Dokumentacion kadastral, Shërbimi kadastral, Oborre në përdorim, Legalizim
	<b>ASHK Korçë-Devoll-Kolonjë</b>	10	0	10	13	0	13	Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Akt trashëgimie, Aplikim online AV0(zero), Karteles pasurie, Harte treguese, Legalizim
	<b>ASHK Berat-Kuçovë-Skrapar</b>	22	0	22	25	0	25	Regjistrimi i Kontratave, Informacion kadastral, Oborre në përdorim, Legalizim, Çertifikatë pronësie
	<b>ASHK Fier-Mallakastër</b>	63	0	63	84	1	85	Regjistrim/fshirje inskripti, Toka bujqësore, Informacion kadastral, Kartelë pasurie, Regjistrim fillestar
	<b>ASHK Shkodër-Pukë</b>	38	0	38	74	0	74	Akt administrativ/gjyqësor, Akt trashëgimie, Regjistrim/fshirje inskripti, Informacion kadastral, Korrigjim dokumentacioni
	<b>ASHK Kukës-Has-Tropojë</b>	3	0	3	4	0	4	Oborre në përdorim, Regjistrim/fshirje inskripti, Dokumentacion kadastral, Informacion kadastral
	<b>TOTAL</b>	<b>520</b>	<b>12</b>	<b>532</b>	<b>1,707</b>	<b>66</b>	<b>1,773</b>	

## IX. SHËRBIMET, INVESTIMET DHE BURIMET NJERËZORE

### A. SHËRBIMET DHE INVESTIMET

Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve

Gjatë vitit 2025 Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve, në zbatim të detyrave të tij, është fokusuar në zërin “investime” me qëllim përmbylljen e rikonstruksionit të disa godinave, si vijon:

- o Godina në rrugën ”Jordan Misja”: Përfunduan punimet për rikonstruksionin total për dy katet e fundit të Godinës në rrugën ”Jordan Misja”, kati i pestë dhe i gjashtë, sipas deklaratës së përfundimit të punimeve më datë 04.02.2025 dhe u morën në dorëzim më datë 04.06.2025, nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 551, datë 11.04.2025, sipas aktit të kolaudimit të datës 25.03.2025.
- o Godina e Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë: U morën në dorëzim, më datë 14.02.2025, punimet për rikonstruksionin e brendshëm, për një pjesë të katit përdhe të godinës së Drejtorisë Vendore të ASHK-s Vlorë (ish ADISA), nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.3057, datë 31.12.2024, sipas deklaratës së përfundimit të punimeve më datë 24.10.2024 dhe aktit të kolaudimit të datës 19.12.2024;
- o Godina e Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës: Punimet për rikonstruksionin e Godinës së Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës përfunduan sipas deklaratës së përfundimit të punimeve më datë 17.02.2025 dhe u morën në dorëzim nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 634, datë 12.05.2025, më datë 02.07.2025 sipas aktit të kolaudimit të datës 05.05.2025.

Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme, ka ndjekur me kujdes dhe ka vlerësuar çdo kërkesë të depozituar për mallra dhe shërbime. Ky proces është zhvilluar si pjesë e procedurave të prokurimit të realizuara nga strukturat përkatëse, por edhe si pjesë e përpjekjeve për të plotësuar nevojat e përditshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke garantuar vijimësinë normale të aktivitetit të saj.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë veprime konkrete që përfshijnë shpërndarjen e pajisjeve kompjuterike, orendive dhe materialeve të kancelarisë për strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore, gjithmonë në përputhje me kërkesat e tyre specifike. Po ashtu, sektori ka përgatitur dhe lëshuar autorizimet e nevojshme për lëvizjen e automjeteve, si dhe urdhrat për furnizimin me karburant të automjeteve dhe gjeneratorëve, sipas normativave dhe kërkesave, duke siguruar funksionimin e pandërprerë të shërbimeve.

Sektori i Prokurimeve, në kuadër të hartimit të analizës vjetore të veprimtarisë së punës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për periudhën Janar – Dhjetor 2025 ka kryer dhe ka përmbushur aktivitetet dhe rezultatet e mëposhtme:

#### **Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura për periudhën Janar – Dhjetor 2025:**

- Aktiviteti kryesor për Sektorin e Prokurimeve për vitin 2025 ishte realizimi i procedurave të prokurimit të parashikuara për vitin 2025 dhe, veçanërisht, prokurimi i shërbimit me objekt: "Regjistrimi fillestar i 106 zonave kadastrale".  
Ky proces u realizua brenda objektivave kohore dhe konsistoi në lidhjen e kontratave për lotet përkatëse dhe ngritjen e grupeve të monitorimit dhe zbatimit të kontratave, të cilat

janë në vazhdim deri në qershor–korrik të vitit 2026.  
Gjithashtu, referuar Regjistrin të Parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2025, janë përfunduar procedurat e prokurimit të mbartura nga viti 2024, me objekt:

- Shpenzime për mirmbajtjen e pajisjeve të zyrave (printera-fotokopje), vitit 2024;
- Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi, vitit 2024;
- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të brendshëm për një pjesë të katit përdhe të ASHK-së Vlorë, vitit 2024;
- Kolaudimi i punimeve të përforcimit dhe rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Kukës, vitit 2024;

● **Procedurat e realizuara për vitin 2025**

- Blerje (tonera) bojra për printera dhe fotokopje;
- Blerje pjesë këmbimi, goma dhe bateri për automjete;
- Shërbim për riparimin e automjeteve të ASHK-së;
- Siguracioni i Automjeteve të ASHK-së;
- Dedektim defekti për Automjeteve të ASHK-së;
- Shpenzime për larje Automjeteve të ASHK-së;
- Abonimi në Shtyp;
- Printim Logo e ASHK-së Baner (Flete palosje banera dhe postera);
- Bilet Avioni Udhëtim (blerje bileta udhëtimi ndërkombëtar);
- Regjistrimi Fillestar për 106 ZK (Lotet 1-7).
- Shpenzime për Sigurimin e ndërtesave” dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme;
- Blerje Materiale pastrimi dhe dezinfektimi;
- Mirembajtje gjeneratori;
- Shërbim për zëvendësimin e bomblave të fikjes së zjarrit;
- Shërbime të përkthimit
- Relializimi i Shërbimeve të thirrjeve hyrësë të numrit të gjelbër 0080

● **Procedurat e prokurimit të përealizuara janë ato me objekt si mëposhtë:**

- Shpenzime për festat e fund vitit (Kartolina etj);
- Shpenzime për mirëmbajtjen e kanalizimeve;

- Shpenzime për pritje dhe përcellje;
- Shpenzime për lyerjen e ambienteve ;
- Blerje Aksesorë zyre (grila);
- Blerje Dosje Arkive për ruajtje të përhershëm;
- Dedektim defekti (kondicionerë paisje zyre etj);
- Rikonstruksionin e godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Gjirokastrë;
- Mbikqyrja e punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Gjirokastrë;
- Shërbime te printimit dhe publikimit;
- Shpenzime për materiale elektrike,ngrohje dhe ndricimi;
- Shpenzime për Materiale dhe vegla pune për IT;
- Njoftime në gazetë;
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca;
- Shenzime për kryerje ekspertize për materiale qe do të nxirren jashtë përdorimit;
- Shpenzime për “Sigurimin e kushteve teknike, të ruajtjes në arkiva dhe magazinë”;
- Organizim eventi;
- Kolaudimi i punimeve në ndërtim;
- Shpenzime për libra dhe publikime profesionale;
- Shpenzime për “ Shërbime të pastrimit të jashtëm të Institucionit”;
- Trajnime dhe Seminare;
- Blerje “Materiale për ambientet për pritjen me popullin”;;
- Shërbim për mirëmbajtje sistemi i kamerave;
- Blerje kancelari dhe letër;
- Blerje Karburanti (diesel dhe benzinë);
- Shpenzime për “larje xhamash”;
- Blerje Karta “Chek in dhe bagde”;
- Shpenzim për mirëmbajtjen e rrjeteve, elektrike, informatike dhe telefonike;
- Shpenzime për “qiramarrje mjete transporti”;
- Shpenzim për mirëmbajtjen e Ashensorëve e aparateve dhe veglave te punës;
- Foni ndricim;
- Blerje Pajisje, Server, kompjuter, printer, fotokopje paisje TIK;
- Shpenzime për mirëmbajtjen e orendive dhe mobiljeve të zyrës;

- Të tjera materiale dhe shërbime speciale;
- Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (printera, Fotokopje, kompjuter);
- Blerje materiale për riparimin e raftëve të arkivës;
- Shërbim periodik të depozitave të ujit;
- Blerje materiale të ndryshme për zyrat (brava dyersh, hidraulike, etj ndërtimi vegla pune);
- Blerje Orendi zyre;
- Shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik;
- Shpenzime për dekorime të ndryshme;
- Blerje për këndin e ndihmës së shpejt dhe të tjera;
- Shpenzime për “Shërbime informimi”;
- Shpenzime për skemë evakuimi dhe sinjalistika për mbrojtje nga zjarri;
- Shpenzime për mirëmbajtje pompe uji;
- Shpenzime për Sistemin, nivelim, gjelbërim oborri;
- Blerje pompë dhe materiale pompë;
- Riparim hidroizolimi i tarracës Godina Dora D’istria;
- Mirëmbajtje kondicionerësh;
- Shpenzime për realizim ankandi për aktivet vlerësuar për jashtë përdorimi;
- Shpenzime për transport “Aktive dhe materiale”;
- Shërbime “ Konektivitetit (internet, intranet primare dhe backup)” etj..

Procedurat e mësipërme janë të pa realizuara, pasi nuk ka lindur nevoja për këto punë/mallra apo shërbime.

### **Problematikat e evidentuara dhe të konstatuara**

Gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2025**, proceset e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor duke mos evidentuar problematika esenciale që mund të cenonin mbarëvajtjen e aktivitetit të sektorit.

### **Rekomandimet dhe vijimësia e Planit të Punës për vitin 2026.**

Gjithashtu, Sektori i Prokurimeve edhe për vitin 2026, në fokus të punës së tij, përkrah procedurave të parashikuara në regjistrin e parashikimeve për vitin 2026, ka në fokusin e vet edhe realizimin e procedurave me objekt: “Regjistrimin fillestar për zonat kadastrale”, konkretisht:

- Realizimi në kohë i të gjitha procedurave të parashikuara në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2026.

- Vijimi i procedurave për regjistrimin fillestar të zonave të reja kadastrale, në përputhje të plotë me kërkesat e drejtorisë përkatëse.

## **B. BURIMET NJERËZORE, REKRUTIMET DHE ECURITË DISIPLINORE**

Raporti përfundimtar i sektorit të Burimeve Njerëzore për vitin 2025 pasqyron veprimtarinë e zhvilluar gjatë këtij viti në administrimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Gjatë vitit 2025, sektori i Burimeve Njerëzore ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, me fokus administrimin e marrëdhënieve të punës, menaxhimin e personelit, ndjekjen e procedurave administrative, zhvillimin profesional të punonjësve, si dhe monitorimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Punës dhe aktet e brendshme të institucionit. Ky raport synon të paraqesë në mënyrë të përmbledhur situatën e burimeve njerëzore gjatë vitit 2025, ecurinë e proceseve administrative dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe eficiencës institucionale.

Në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, si dhe akteve të brendshme administrative të institucionit, sektori i Burimeve Njerëzore ka ndjekur procedurat për plotësimin e nevojave të institucionit me personel, në funksion të garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve dhe rritjes së eficiencës administrative.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithashtu dy procedura shpalljeje për rekrutim. Shpallja e parë është realizuar në muajin Qershor 2025 për punonjës me kontratë me afat, në profilin Juridik dhe Gjeodezi, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë dhe Gjeoinformatikë. Nga kjo Shpallje janë rekrutuar gjithsej 24 juristë dhe 15 inxhinierë. Të shpërndarë të gjithë nëpër drejtori të ndryshme sipas nevojave të institucionit.

Shpallja e dytë është zhvilluar në muajin Nëntor 2025 për punonjës me kontratë me afat të pacaktuar, në profilin Juridik dhe Gjeodezi, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë dhe Gjeoinformatikë, për Drejtoritë si më poshtë vijon:

- Në Drejtorinë e ASHK-së, Vlorë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Sarandë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Fier
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Korçë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Berat
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Gjirokastrë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Lushnjë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Lezhë
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Kukës
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Dibër
- Në Drejtorinë e ASHK-së, Shkodër


Kjo procedure vijoi edhe përfundoi në vitin 2026. Nga kjo shpallje u rekrutuan gjithsej 16 punonjës nga të cilët 7 inxhinierë dhe 9 juristë të shpërndarë në funksion të plotësimit të nevojave të institucionit me burime njerëzore.

Gjatë vitit 2025, sektori i Burimeve Njerëzore ka ndjekur administrimin e marrëdhënieve të punës për punonjësit e strukturës dhe punonjësit me kontratë të përkohshme, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Përgjatë këtij viti janë trajtuar procedurat që lidhen me lëvizjet e personelit, emërimet, largimet nga puna me kërkesë të punonjësve (konkretisht janë 89 kërkesa për doreheqje), administrimin e dokumentacionit të personelit, si dhe monitorimin e zbatimit të detyrimeve administrative nga strukturat përkatëse të institucionit.

Në respektim të dispozitave të Kodit të Punës, për vitin 2025 për punonjësit e strukturës dhe ata me kontratë të përkohshme, Drejtoria e Përgjithshme ka dhënë gjithsej 242 masa disiplinore, nga të cilat:

- 67 “Tërheqje vëmendje”,
- 82 “Vërejtje”
- 70 “Vërejtje me shkrim”,
- 20 “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”,
- 3 “Ulje në detyrë”

Në këtë pjesë mund të pasqyrohen statistikat konkrete të vitit 2025 në lidhje me masat disiplinore.



Gjithashtu, gjatë vitit 2025 është vijuar bashkëpunimi ndërmjet strukturave përgjegjëse për trajnimin dhe monitorimin e performancës së punonjësve, me qëllim evidentimin e nevojave për zhvillim profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve administrative të institucionit.

## REKOMANDIME

Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të administrimit të burimeve njerëzore, rekomandohet:

- vijimi i trajnimeve profesionale dhe i programeve të zhvillimit të kapaciteteve administrative;
- forcimi i mekanizmave të monitorimit të performancës së punonjësve;
- përmirësimi i procedurave të administrimit të personelit dhe dokumentacionit përkatës;
- hartimi dhe përditësimi i akteve të brendshme që lidhen me procedurat e rekrutimit, vlerësimit dhe zhvillimit profesional të punonjësve;
- rritja e eficiencës administrative dhe e standardeve të shërbimit institucional.

## **X. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I SISTEMEVE**

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve ka luajtur një rol kyç në garantimin e vazhdimësisë operacionale, sigurisë së informacionit dhe funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve teknologjike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) gjatë vitit 2025.

Nëpërmjet administrimit të sistemeve, menaxhimit të riskut, suportit teknik dhe koordinimit ndërinstytucional, drejtoria ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e Drejtorive Vendore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

Veprimtaria e saj është fokusuar jo vetëm në mirëmbajtjen operacionale të infrastrukturës teknologjike, por edhe në forcimin e sigurisë së informacionit, optimizimin e proceseve të brendshme dhe rritjen e kapaciteteve digjitale institucionale.

Strukturimisht, drejtoria përbëhet nga:

- o Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut
- o Sektori i Asistencës Teknike

### **SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË SISTEMEVE DHE VLERËSIMIT TË RISKUT**

Ky sektor është përgjegjës për administrimin e sistemeve informatike, menaxhimin e përdoruesve, kontrollin e aksesit, vlerësimin e riskut teknologjik dhe koordinimin me institucionet ndërvepruese.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

#### **1. Krijimi dhe administrimi i përdoruesve (userave)**

- Krijimi i përdoruesve të rinj për sistemet operative të ASHK-së.

- Përfshirja e përdoruesve në organigramat përkatëse të drejtorive vendore dhe qendrore.
- Vendosja dhe administrimi i privilegjeve të aksesit sipas rolit institucional dhe profilit të punës.
- Çaktivizimi i përdoruesve në rastet e largimit nga puna ose ndryshimit të funksionit.
- Auditimi periodik i aksesit dhe verifikimi i përputhshmërisë së privilegjeve të përdoruesve.

## **2. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e strukturës institucionale në sistem**

- Krijimi dhe integrimi i institucioneve të reja në sistemet e ASHK-së.
- Administrimi i strukturës hierarkike të moduleve dhe roleve në sistem.
- Përditësimi i strukturave organizative sipas ndryshimeve institucionale.

## **3. Trajnime të specializuara për përdorimin e sistemeve**

- Organizimi i trajnimeve për specialistët e drejtorive vendore dhe qendrore.
- Asistencë për juristë, hartografë, specialistë finance, drejtues dhe profile të tjera administrative.
- Udhëzime praktike për përdorimin korrekt të moduleve të brendshme dhe raportimin e problematikave.
- Rritja e kapaciteteve digjitale për përdorimin e sistemeve elektronike të institucionit.

## **4. Menaxhimi i adresave elektronike (email)**

- Hapja dhe administrimi i adresave zyrtare elektronike për punonjësit.
- Resetimi i fjalëkalimeve dhe rikuperimi i aksesit në rastet e bllokimeve.
- Mbyllja e adresave elektronike për përdoruesit joaktivë.
- Koordinimi me AKSHI për problematikën e platformës zyrtare gov.al.
- Monitorimi i përdorimit korrekt të adresave zyrtare elektronike.

## **5. Menaxhimi i komunikimeve dhe ndërveprimeve ndërinsticionale**

- Administrimi i modulit ASHK–Institucione për komunikimin me bashkitë, gjykatat, ministritë, prokuroritë, tatimet dhe institucione të tjera.
- Verifikimi i dokumenteve dhe certifikatave të pronësisë të dërguara nga institucione të treat.
- Koordinimi i shkëmbimit elektronik të informacionit ndërinsticionale.
- Mbështetje për proceset e ndërveprimit elektronik ndërmjet institucioneve publike.

## **6. Suport për platforma dhe sisteme të tjera**

- Mbështetje teknike për përdoruesit e Platformës së Bashkëqeverisjes.
- Administrimi i FTP serverit për transferimin dhe ndarjen e dokumenteve ndërmjet institucioneve.
- Suport për platformën e legalizimeve dhe sistemet përkatëse.
- Mbështetje teknike për sistemet elektronike të përdorura nga drejtoritë vendore dhe qendrore.

## **7. Menaxhimi i riskut dhe sigurisë së sistemeve**

- Kryerja e auditimeve të brendshme për përdorimin e aksesit në sistem.
- Hartimi i raporteve të sigurisë dhe rekomandimeve për mirëadministrimin e të dhënave.
- Monitorimi dhe analizimi i incidenteve të sigurisë teknologjike.
- Evidentimi i tentativave të aksesit të paautorizuar në sistem.
- Koordinimi me institucionet përgjegjëse për çështjet e sigurisë kibernetike.
- Zbatimi i praktikave për kontrollin dhe menaxhimin e privilegjeve të aksesit.
- Ndjekja e procedurave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit institucional.

## **8. Backup dhe vazhdimësia operacionale**

- Monitorimi i proceseve të backup-eve të sistemeve kritike.
- Verifikimi periodik i ruajtjes dhe integritetit të të dhënave.
- Koordinimi i procedurave për rikuperimin e sistemeve në rast incidentesh.
- Mbështetje për garantimin e vazhdimësisë operacionale të sistemeve institucionale.

## **9. Përdorimi i emailit funksional multifunksional@ashk.gov.al**

Ky email ka shërbyer si pikë qendrore komunikimi për:

- Problematikë e përditshme të sistemit nga të gjitha profilet përdoruese.
- Raportimin e problematikave teknike dhe harduerike nga drejtoritë vendore dhe qendrore.
- Koordinimin e ndërhyrjeve emergjente dhe diagnostikimeve teknike.
- Administrimin e kërkesave për asistencë teknike dhe sistemike.

## **SEKTORI I ASISTENCËS TEKNIKE**

Ky sektor ka mbuluar të gjitha aspektet teknike që garantojnë funksionimin e infrastrukturës digjitale të ASHK-së, me fokus në suportin teknik, administrimin e rrjeteve, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe optimizimin e proceseve teknologjike.

### **1. Suport teknik i përditshëm**

- Ofrimi i asistencës remote për përdoruesit në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- Instalimi dhe konfigurimi i software-ve të nevojshëm.
- Konfigurimi i printerave, skanerave dhe pajisjeve të tjera periferike.
- Konfigurimi i rrjeteve dhe privilegjeve në kompjuter.
- Diagnostikimi dhe zgjidhja e problematikave teknike në kohë reale.
- Përditësimi dhe optimizimi i sistemeve operative.

### **2. Administrimi i rrjetit dhe pajisjeve në drejtoritë vendore**

- Instalimi dhe konfigurimi i rrjeteve kompjuterike në terren.

- Administrimi i pajisjeve të rrjetit dhe infrastrukturës teknologjike.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e një liste të centralizuar IP për të gjitha pajisjet në drejtoritë vendore dhe qendrore.
- Monitorimi i funksionimit të pajisjeve dhe rrjeteve për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve.
- Ndërhyrje teknike në terren për problematika kritike.

### **3. Menaxhimi i inventarit teknologjik**

- Evidentimi dhe inventarizimi i pajisjeve IT.
- Monitorimi i statusit operacional të pajisjeve teknologjike.
- Ndjekja e ciklit të jetës së pajisjeve dhe nevojave për zëvendësim.
- Administrimi i pajisjeve të formatuara dhe të instaluara për përdorim institucional.

### **4. Mirëmbajtje dhe përditësim i faqes zyrtare të ASHK-së**

- Popullimi dhe përditësimi i përmbajtjes në faqen zyrtare.
- Përmirësimi i strukturës dhe organizimit të informacionit.
- Garantimi i funksionimit të vazhdueshëm të web-it institucional.
- Integrimi i përmbajtjeve të reja në kohë reale.
- Monitorimi i performancës dhe aksesueshmërisë së faqes zyrtare.

### **5. Raportim periodik i konsumit të energjisë**

- Hartimi dhe dërgimi i raporteve mujore për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha drejtoritë vendore.
- Evidentimi dhe administrimi i të dhënave të konsumit sipas strukturave përkatëse.

### **6. Monitorim performance dhe eficiencë operative**

- Monitorimi i kohës së reagimit ndaj problematikave teknike.
- Ndjekja e zgjidhjes së incidenteve teknike sipas prioriteteve.
- Raportim mbi disponueshmërinë dhe stabilitetin e sistemeve.
- Analizë e kërkesave më të shpeshta për optimizimin e proceseve të suportit teknik.

## **STATISTIKA PËR VITIN 2025**

- 650+ përdorues të rinj të krijuar në sistem.
- 650+ adresa email të reja të hapura dhe administruara.
- 30+ trajnime dhe asistencë on-site për drejtoritë vendore.
- 3,000+ ndërhyrje teknike remote për kompjuterë, printera dhe rrjete.
- 6,000+ kërkesa të adresuara në multifunksional@ashk.gov.al.
- 700+ pajisje të formatuara dhe instaluara.
- Monitorim i vazhdueshëm i sistemeve dhe rrjeteve institucionale.
- Administrim i aksesit dhe privilegjeve për të gjitha profilet përdoruese të sistemit.

## OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

- Automatizimi i raportimit dhe klasifikimit të problematikave teknike dhe sistemike.
- Implementimi i një platforme të unifikuar për menaxhimin e kërkesave teknike (ticketing system).
- Forcimi i sigurisë së rrjeteve dhe auditimit të aksesit në sistem.
- Rritja e kapaciteteve për trajnime digjitale online.
- Përmirësimi i monitorimit të incidenteve të sigurisë kibernetike.
- Optimizimi i proceseve të backup-it dhe rikuperimit të sistemeve.
- Mbështetje më e strukturuar për institucionet ndërvepruese.
- Modernizimi i proceseve të suportit teknik dhe administrimit të sistemeve.
- Analiza e mundësive për automatizim dhe përdorim të mjeteve inteligjente në proceset operacionale.

Ky raport pasqyron përkushtimin dhe profesionalizmin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm, sigurinë teknologjike dhe mbështetjen e vazhdueshme të proceseve institucionale të ASHK-së, në përputhje me standardet bashkëkohore të administrimit dhe sigurisë së informacionit.

### **XI. EVIDENCA E PROCESIT TË INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË PRONAVE SHETETËRORE**

Drejtorja e Pronave Shtetërore - është krijuar pranë ASHK-së me Urdhrin nr. 147, datë 1.8.2024, të Kryeministrit.

Kjo drejtori është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të inventarizimit dhe përditësimit të listave të inventarëve të pronave shtetërore nga institucionet shtetërore qendrore, si dhe për përditësimin e listave të pronave publike shtetërore të transferuara në pronësi apo përdorim të njësisve të vetëqeverisjes vendore, me qëllim regjistrimin e tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Procesi kryhet në bashkëpunim me institucionet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2025, institucionet shtetërore kanë vijuar procesin e përditësimit të listave të inventarëve dhe regjistrimit të pronave, duke ndarë punën në fasha me nga 30 prona prioritare, të përzgjedhura nga secila ministri dhe institucionet e saj në varësi.

Nga ASHK-ja janë koordinuar strukturat përkatëse në çdo Drejtori Vendore për kryerjen e verifikimeve të gjendjes juridike të pronave, matjeve dhe verifikimeve në terren, si dhe për regjistrimin dhe certifikimin e tyre, në bashkëpunim me institucionet administruese.

DPSH pranë ASHK-së ka bashkëpunuar me strukturat e posaçme të ngritura pranë institucioneve shtetërore, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik kadastral të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie për çdo pasuri.

Me asistencën e Drejtorisë së Pronave Shtetërore, institucionet shtetërore kanë proceduar njëkohësisht me tre kategori procesesh: inventarizim/transferim, përditësim dhe regjistrim. Për miratimin e listës së përditësuar të pronave shtetërore, institucionet kanë plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor të nevojshëm, i cili ka shërbyer për hartimin e projektvendimeve që ASHK-ja ka paraqitur për shqyrtim pranë Kryeministrit.

Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë trajtuar për inventarizim/përditësim dhe regjistrim 260 prona të fashës së dytë prioritare, nga të cilat:

- 36 prona janë çertifikuar pa i'u nënshtruar procesit të përditësimit;
- Për 50 prona, janë konstatuar problematika; dhe
- Për 174 prona, të klasifikuara për përditësim, janë hartuar dhe dërguar për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave 21 projektakte përkatëse, nga të cilat:
  - 10 VKM janë miratuar gjatë vitit 2025, të cilat kanë trajtuar 65 prona dhe janë certifikuar;
  - 7 VKM janë miratuar gjatë 2026, të cilat kanë trajtuar 91 prona dhe janë në proces certifikimi;
  - 4 projekt vendime janë në proces bashkërendimi me ministritë e linjës, dhe trajtojnë 18 prona.

Paralelisht, ka vijuar procesi për inventarizimin dhe përditësimin e pronës shtetërore për prona jashtë fashës prioritare, sipas kërkesave të institucioneve dhe bashkive, bazuar në kërkesat e tyre, rast pas rasti.

Si rezultat janë përditësuar dhe regjistruar gjithsej 108 prona/356 pasuri nëpërmjet miratimit të 33 VKM-ve:

- 17 VKM për Institucione Qendrore, me 50 prona/286 pasuri
- 16 VKM për NJVV-të, me 58 prona/70 pasuri.

Të detajuara këto të dhëna, sipas institucioneve shtetërore, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

## XII. AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE DHE PLANI I RITJES PËR SHQIPËRINË

Prona Jashtë Fashës Prioritare 2025				
INSTITUCIONI	NR VKM te Miratuara	NR PRONAVE MIRATUAR VKM	Nr Pasurive të miratuara me VKM	NR PRONAVE NE PROCES ÇERTIFIKIMI
KM	1	3	3	Çertifikuar
MAS	1	1	2	Çertifikuar
MSHMS	1	1	2	Çertifikuar
MIE	1	10	10	Çertifikuar
MEPJ	1	1	1	Çertifikuar
MEKI	2	2	3	Çertifikuar
MF				
MTM				
MB	1	1	1	Çertifikuar
MBZHR				
MD				Çertifikuar
MM	3	10	223	Çertifikuar
Bashki	16	56	70	Çertifikuar
Te pavarura (FSHZH, KLGJ, etj)	6	21	41	Çertifikuar
<b>Totali</b>	<b>33</b>	<b>106</b>	<b>356</b>	

Në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave dhe Planit të Rritjes për Shqipërinë 2024–2027<sup>2</sup>, Agjencia Shtetërore e Kadastrës kontribuon në përmbushjen e objektivave që lidhen me përmirësimin e klimës së biznesit, garantimin e transparencës institucionale dhe modernizimin e administrimit të tokës. Objektivi kryesor i reformës konsiston në krijimin e një sistemi kadastral eficient, transparent dhe të besueshëm, i cili garanton sigurinë juridike të të drejtave të pronësisë dhe mbështet zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Në funksion të këtij objektivi, ASHK ka ndërmarrë një sërë reformash institucionale që synojnë modernizimin e shërbimeve kadastrale dhe përmirësimin e administrimit të të dhënave të pronësisë. Këto reforma janë konceptuar në përputhje me standardet europiane të qeverisjes publike dhe me kërkesat e procesit të integritetit evropian.

Ndër masat kryesore të ndërmarra në kuadër të reformës përfshihen:

- miratimi i Udhërrëfyesit për Proceset e Digjitalizimit 2025–2028;
- miratimi i Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin e Riskut 2025–2027;
- avancimi i procesit të regjistrimit fillestar në nivel kombëtar;
- digjitalizimi i kartelave të pasurive të paluajtshme dhe i dokumentacionit tekniko-ligjor;
- përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe transparencës institucionale.

Këto ndërhyrje reflektojnë një qasje të integruar të reformës, ku modernizimi i shërbimeve kadastrale shoqërohet me forcimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e kapaciteteve administrative.

## **1. Digjitalizimi i sistemit kadastral**

### **1.1. Udhërrëfyesi për proceset e Digjitalizimit 2025-2028<sup>3</sup>**

Në përputhje me objektivat e Agjendës Kombëtare të Reformave dhe në funksion të udhëheqjes së transformimit digjital të shërbimeve kadastrale, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka miratuar Udhërrëfyesin për Proceset e Digjitalizimit për periudhën 2025–2028. Ky dokument strategjik u formalizua me Urdhrin Nr. 710 të Drejtorit të Përgjithshëm, datë 09.06.2025, si dhe nëpërmjet përfshirjes dhe miratimit të Komitetit Ndërministror.

Procesi i miratimit u realizua në përputhje me afatet e përcaktuara, duke reflektuar angazhimin institucional dhe koordinimin efektiv ndërmjet të gjithë palëve të përfshira. Si rezultat, ky hap u

---

<sup>2</sup> VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”

<sup>3</sup> <https://www.ashk.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Udhërrëfyesi-i-Digjitalizimit-të-Agjencisë-Shtetërore-të-Kadastrës.pdf>

konsiderua i përmbushur plotësisht brenda afatit të planifikuar, duke mundësuar vijimin e mëtejshëm të zbatimit të reformave.

Hartimi i Udhërrëfyesit është mbështetur në një proces të strukturuar konsultimesh teknike me Komitetin Ndërmintor, nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në ekspertizën e brendshme të institucionit. Dokumenti është zhvilluar për të shërbyer si një kornizë themelore për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha proceseve të digjitalizimit në ASHK.

Udhërrëfyesi përcakton vizionin dhe drejtimin strategjik për transformimin digjital të sistemit kadastral, me synimin e ndërtimit të një sistemi modern, të integruar, të saktë dhe transparent, i cili:

- garanton sigurinë ligjore të të drejtave të pronësisë;
- promovon zhvillimin e qëndrueshëm territorial;
- lehtëson aktivitetin ekonomik;
- dhe përaftron praktikat kombëtare me standardet e Bashkimit Evropian.

Në funksion të këtij vizioni, Udhërrëfyesi parashikon një sërë objektivash kryesore, ndër të cilët:

- përfundimi i digjitalizimit të plotë të kartelave të pasurive të paluajtshme, dokumentacionit tekniko-ligjor dhe hartave kadastrale;
- finalizimi i procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë territorin e vendit;
- përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i saktësisë së të dhënave kadastrale.

Zbatimi i Udhërrëfyesit bazohet në një plan të detajuar pune, i cili përcakton qartë aktivitetet, përgjegjësitë institucionale dhe burimet e nevojshme për realizimin e tyre. Çdo fazë përfshin objektiva të matshme dhe pika referimi të mirëpërcaktuara, duke mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të progresit dhe garantimin e llogaridhënies në zbatim.

Afatet kohore janë konceptuar në përputhje me kapacitetet operacionale dhe institucionale, duke synuar përfundimin e proceseve kryesore të digjitalizimit deri në qershor të vitit 2026 dhe krijimin e një trajektoreje të qartë drejt përfundimit të regjistrimit fillestar në shkallë kombëtare deri në vitin 2027.

Zbatimi i këtij dokumenti mbështetet në një bashkëpunim të gjerë ndërinstitutional, ku ASHK dhe strukturat përkatëse luajnë një rol qendror, në koordinim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ndër këta përfshihen Bashkimi Evropian (përmes fondeve IPA), UNOPS, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe aktorë të tjerë.

Nëpërmjet këtij dokumenti strategjik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës riafirmon angazhimin e saj për avancimin e reformave në sektorin kadastral, me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimeve, forcimin e sigurisë juridike të pronësisë dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

## **2. Digjitalizimi i Kartelave të Pasurive të Paluajtshme**

Digjitalizimi i kartelave të pasurive të paluajtshme përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të reformës së administrimit të tokës në Shqipëri dhe një ndër shtyllat kryesore të modernizimit të sistemit kadastral. Ky proces realizohet nga Qendra e Kadastrës Digjitale (QKD)<sup>4</sup> dhe mbështetet në standardet teknike të sistemit ALBSCAD, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon administrimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave kadastrale në Republikën e Shqipërisë.

Procesi i digjitalizimit synon transformimin gradual të regjistrave manualë dhe dokumentacionit fizik në një sistem të integruar elektronik të administrimit të pronës, duke krijuar një bazë të unifikuar dhe të standardizuar të të dhënave kadastrale. Në këtë mënyrë, synohet rritja e aksesueshmërisë, saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit mbi pronësinë, si dhe përmirësimi i eficiencës së proceseve administrative që lidhen me regjistrimin, verifikimin dhe administrimin e të drejtave të pronësisë.

Digjitalizimi i kartelave të pasurive të paluajtshme përfaqëson një ndërhyrje me rëndësi strategjike jo vetëm për modernizimin teknologjik të institucionit, por edhe për garantimin e sigurisë juridike të pronësisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike. Krijimi i një sistemi të centralizuar dhe të digjitalizuar të regjistrimit të pronave kontribuon në reduktimin e problematikave që lidhen me fragmentarizimin e të dhënave, pasaktësitë administrative dhe vështirësitë në aksesimin e dokumentacionit historik.

Në këtë drejtim, progresi i realizuar gjatë viteve 2024–2025 paraqitet i konsiderueshëm dhe evidenton intensifikimin e proceseve të transformimit digjital në sektorin kadastral. Gjatë vitit 2025, niveli i digjitalizimit të kartelave është rritur ndjeshëm, duke kaluar nga 24% në 80% deri në muajin dhjetor, duke reflektuar një rritje prej 56% brenda një periudhe një vjeçare. Në përputhje me objektivat e përcaktuara në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave, pjesa e mbetur prej 20% e kartelave planifikohet të përfundojë brenda muajit qershor 2026, duke mundur përmbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit.

Paralelisht me digjitalizimin e kartelave, është realizuar edhe një progres i konsiderueshëm në skanimin e dokumentacionit mbështetës tekniko-ligjor, i cili përbën një element thelbësor për funksionimin efektiv të sistemit kadastral. Deri në tetor 2024 ishte përfunduar skanimi i 53.5% të referencave, ndërsa gjatë periudhës tetor 2024 – nëntor 2025 u realizua skanimi i 42.6% të referencave të tjera. Procesi u përmbyll plotësisht në dhjetor 2025, duke arritur në 100% të skanimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.

Përfundimi i këtij procesi përfaqëson një moment të rëndësishëm në transformimin institucional të sektorit kadastral, pasi krijon një arkivë të integruar digjitale dhe mundëson ruajtjen më të sigurt, administrimin më eficient dhe aksesin më të shpejtë në dokumentacionin e pronësisë. Për më tepër,

---

<sup>4</sup> Krijuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 15, datë 31.01.2022

digjitalizimi i dokumentacionit redukton ndjeshëm riskun e humbjes, dëmtimit ose degradimit fizik të dokumenteve arkivore, duke kontribuar në ruajtjen afatgjatë të informacionit kadastral.

Në vijim të angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave, digjitalizimi i plotë i kartelave të pasurive të paluajtshme pritet të finalizohet brenda muajit qershor 2026. Ky hap do të mundësojë kalimin përfundimtar drejt një sistemi kombëtar të regjistrimit të pronave tërësisht të digjitalizuar, duke forcuar më tej efikasitetin institucional, transparencën dhe sigurinë juridike të të drejtave pronësore.

### **3. Integritetit Institucional dhe Menaxhimi i Riskut**

#### **3.1 Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut 2025-2027<sup>5</sup>**

Forcimi i integritetit institucional dhe rritja e transparencës administrative përbëjnë elemente thelbësore të reformës së administratës publike dhe të procesit të integritetit evropian. Në këtë kuadër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës miratoi Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Riskut për periudhën 2025–2027, nëpërmjet Urdhrit Nr. 1219, datë 25.11.2025.

Ky dokument përbën një instrument të rëndësishëm strategjik në funksion të forcimit të integritetit institucional dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike.

Hartimi i Planit është realizuar përmes një procesi të gjerë bashkëpunimi ndërinstitutional, me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, pranë Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit dhe asistencës teknike në kuadër të projektit EU4GG (EU for Good Governance). Dokumenti është zhvilluar në përputhje me “Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qëndrore”<sup>6</sup> dhe manualet përkatëse për institucionet e administratës publike, duke garantuar një qasje të standardizuar dhe të bazuar në praktikën më të mirë.

Plani i Integritetit përcakton një kornizë të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të integritetit, me synim sigurimin e ofritit të shërbimeve kadastrale në mënyrë të paanshme, transparente dhe të përgjegjshme. Zbatimi i tij kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e sigurisë juridike të të drejtave të pronësisë dhe në përafrimin e praktikave institucionale me standardet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, Plani parashikon një sërë objektivash kryesorë, të cilët synojnë:

- o forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe parandalimin e korrupsionit;
- o rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale;
- o promovimin e një kulture etike dhe profesionale në administratë;

<sup>5</sup> <https://www.ashk.gov.al/plani-i-integritetit-per-agjencine-shtetërore-te-kadastrës-2/>

<sup>6</sup> Urdhër Nr. 334, datë 07.10.2020 “Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qëndrore”

- o garantimin e trajtimit të barabartë dhe aksesit të qytetarëve në shërbime;
- o forcimin e besimit publik ndaj institucionit.

Procesi i hartimit ka qenë gjithëpërfshirës dhe transparent, duke përfshirë konsultime të brendshme dhe angazhim të gjerë me palët e interesuara të jashtme. Në këtë kuadër janë zhvilluar një sërë aktivitetesh konsultative, ndër të cilat:

- më 29 shtator 2025 është organizuar një takim i hapur për vlerësimin e rreziqeve të integritetit;
- gjatë tetorit 2025 janë zhvilluar dy tryeza konsultimi mbi hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Riskut;
- më 11 nëntor 2025 janë organizuar takime konsultimi publik me përfaqësues të shoqatave profesionale.

Në vijim të këtij procesi, Plani i Integritetit është publikuar për konsultim publik përpara miratimit të tij zyrtar, duke garantuar transparencë dhe përfshirje në vendimmarrje.

Për të siguruar zbatimin efektiv të masave të parashikuara, janë ndërmarrë hapa konkretë në nivel institucional. Në këtë kuadër, është emëruar një Koordinator Integriteti, i cili udhëheq procesin nga pikëpamja teknike, si dhe është hartuar një plan pune i detajuar, që përcakton qartë masat, afatet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Monitorimi i zbatimit të Planit do të realizohet në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë për planet e integritetit në administratën publike, duke garantuar raportim periodik, matje të performancës dhe përputhshmëri me standardet kombëtare.

Në zbatim të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Riskut, për periudhën 2025–2027 janë parashikuar gjithsej 79 masa për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Nga këto, 53 masa i përkasin gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, duke reflektuar një intensitet të lartë të zbatimit në fazën aktuale.

Si rezultat i procesit të ndjekur dhe përmbushjes së kërkesave procedurale dhe substanciale, miratimi i Planit të Integritetit konsiderohet i realizuar plotësisht brenda afatit të planifikuar, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për vijimin e mëtejshëm të reformave në fushën e integritetit dhe transparencës institucionale.

#### **4. Regjistrimi Fillestar**

Procesi i regjistrimit fillestar përbën një nga komponentët më strategjikë dhe strukturorë të reformës së administrimit të tokës në Shqipëri, pasi lidhet drejtpërdrejt me formalizimin e pronësisë, konsolidimin e regjistrimit publik të pasurive të paluajtshme dhe garantimin e sigurisë juridike të të drejtave pronësore. Ky proces përfaqëson një ndër elementet thelbësore të

funksionimit të një sistemi kadastral modern, në të cilin e drejta e pronësisë dokumentohet në mënyrë të plotë, të saktë dhe të verifikueshme.

Në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave, regjistrimi fillestar ka vijuar me ritme të qëndrueshme gjatë periudhës 2024–2025, duke reflektuar një progres gradual, por të konsoliduar në drejtim të zgjerimit të mbulimit kadastral në nivel kombëtar. Në këtë periudhë, mbulimi territorial është rritur nga 90% në vitin 2024 në 91.5% në fund të vitit 2025, çka tregon një avancim të vazhdueshëm të procesit drejt finalizimit të regjistrimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në terma të mbulimit kombëtar, 45 zona kadastrale ishin përfunduar përgjatë periudhës tetor 2024 dhe dhjetor 2025. Aktualisht, regjistrimi fillestar është duke u zbatuar në 151 zona kadastrale. Në kuadër të Agjendës së Reformave, procesi do të shtrihet edhe përgjatë vitit 2026, me objektivin për të përmbyllur procesin e regjistrimit fillestar në 95% të të gjithë zonave kadastrale deri në muajin qershor 2026.

Procesi i regjistrimit fillestar karakterizohet nga një qasje e strukturuar, e cila synon jo vetëm përfshirjen graduale të territorit në regjistrin kadastral, por edhe garantimin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënave të regjistruara. Një element thelbësor i këtij procesi është afishimi publik i të dhënave dhe dokumentacionit përkatës, i cili mundëson verifikimin nga palët e interesuara dhe qytetarët, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e regjistrit kadastral.

Procesi i afishimit shoqërohet me procedura të detajuara të kontrollit të cilësisë dhe verifikimit administrativ, të cilat synojnë identifikimin dhe korigjimin e pasaktësive të mundshme në të dhënat e regjistruara. Ky mekanizëm përfaqëson një komponent të rëndësishëm të sigurisë procedurale në sistemin kadastral, pasi garanton që të dhënat përfundimtare të regjistrit të jenë të sakta, të verifikuara dhe të qëndrueshme në kohë. Në vijim, përfundimi i kësaj faze pritet të mundësojë avancimin drejt formalizimit të plotë të pronësisë dhe forcimit të sigurisë ligjore të të drejtave pronësore në nivel kombëtar.

## **5. Projekti “BE Për të Drejtën e Pronësisë”**

Në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme të Bashkimit Evropian për avancimin e reformave institucionale dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, gjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimi i projektit “BE Për të Drejtën e Pronësisë”, një ndër projektet më të rëndësishme në mbështetje të reformës së administrimit të pronës dhe modernizimit të sistemit kadastral në vend.

Ky projekt, i financuar nga Bashkimi Evropian, synon rritjen e efikasitetit, transparencës dhe besueshmërisë së administrimit të pronës, forcimin e garancive për të drejtën e pronësisë për qytetarët, si edhe përmirësimin e cilësisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve kadastrale. Mbështetja e Bashkimit Evropian në këtë drejtim lidhet ngushtë edhe me objektivat e në procesin e

integritet evropian, ku siguria juridike mbi pronën përbën një element thelbësor për zhvillimin ekonomik, klimën e investimeve dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër, digjitalizimi i hartave kadastrale ka përfaqësuar një nga komponentët më të rëndësishëm të reformës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës gjatë vitit 2025. Ky proces synon transformimin gradual të dokumentacionit ekzistues në letër në një sistem modern dhe të integruar digjital, duke përmirësuar ndjeshëm administrimin, aksesin dhe sigurinë e të dhënave kadastrale.

Për realizimin e këtij objekti, ASHK ka vijuar bashkëpunimin me UNOPS (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve), i cili është autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e proceseve teknike dhe të prokurimit në kuadër të komponentit të projektit për digjitalizimin e hartave kadastrale të mbetura. Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e standardeve teknike, rritjen e transparencës së proceseve dhe garantimin e zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa konkretë dhe të rëndësishëm në funksion të avancimit të procesit të digjitalizimit. Në këtë kuadër, u finalizuan dhe u publikuan dy Kërkesa për Propozime (RFP), konkretisht për “Digjitalizimin e Hartave Kadastrale”, të publikuar në muajin nëntor 2025, si dhe për “Kontrollin e Cilësisë së Shërbimeve të Digjitalizimit”, të publikuar në muajin dhjetor 2025. Për të garantuar një proces transparent dhe konkurrues, u organizuan gjithashtu takime para-ofertuese me operatorët ekonomikë të interesuar, me qëllim sqarimin e kërkesave teknike dhe prezantimin e kontekstit operacional të projektit.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të dy kontratat janë nënshkruar dhe aktualisht ndodhen në fazën e zbatimit. Implementimi i tyre pritet të ndikojë drejtpërdrejt në përshejtimin e procesit të digjitalizimit të hartave kadastrale në shkallë vendi, duke krijuar bazat për një sistem më të unifikuar, të sigurt dhe efikas të administrimit të pronës.

Paralelisht me komponentin teknik, gjatë vitit 2025 është vijuar edhe forcimi i mekanizmave të koordinimit institucional dhe monitorimit të projektit. Në muajin qershor u zhvillua takimi i pestë i Komitetit Drejtues të projektit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në implementimin e projektit. Këto takime kanë shërbyer si platforma të rëndësishme bashkëpunimi dhe dialogu ndër-institucional, duke mundësuar identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave të hasura gjatë zbatimit të projektit, si edhe monitorimin e progresit drejt përmbushjes së objektivave të përbashkëta.

Mbështetja e Bashkimit Evropian nëpërmjet këtij projekti ka luajtur një rol të rëndësishëm në avancimin e reformës së pronës dhe modernizimin e shërbimeve kadastrale në Shqipëri. Ky proces transformues nuk përfaqëson vetëm një përmirësim teknik të proceseve administrative, por një reformë me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e sigurisë juridike mbi pronën, rritjen e besimit të

qytetarëve ndaj institucioneve dhe krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe investimet.